



*QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË
SIGURISË*

VLERËSIMI I SEKTORIT
TË SIGURISË NË REPUBLIKËN E
KOSOVËS

Perspektiva e Shoqërisë Civile

Shtator 2009

PARATHËNIE

Gjatë hulumtimit në projektin për monitorimin dhe planifikimin e sektorit të sigurisë në Republikën e Kosovës, ekipi i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë vërejti se ka mungesë apo fare nuk ekziston literaturë në këtë sferë. Kjo gjendje shtoi brengat tona lidhur me vështirësitë e studiuesve që të bëjnë hulumtim në këtë fushë. Puna e palodhshme për vlerësimin e sektorit të sigurisë nga perspektiva e shoqërisë civile mundësoi një avancim në mbikëqyrjen e këtij sektori dhe në veçanti Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë u shqua për hulumtime specifike për mekanizmat e sigurisë në Kosovë. Në këtë mënyrë, nevoja për përmbledhje edhe të këtyre pak vlerësimeve që janë bërë nga QKSS në një libër të vetëm, do të plotësonte sado pak kërkesat dhe nevojat e studiuesve, studentëve, zyrtarëve dhe palëve të interesuara për funksionimin e sektorit të sigurisë në Kosovë.

Edhe pse kaloj më tepër se një vit nga hyrja në fuqi e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, QKSS ka arritur të bëjë vlerësimin dhe monitorimin e sektorit të sigurisë duke rritur kështu rolin e shoqërisë civile dhe rrjedhimisht fuqizoi kontrollin demokratik mbi institucionet e sigurisë. Botimi për herë të parë i një libri të tillë nga një organizatë e shoqërisë civile do të thotë më shumë se kontribut dhe përkushtim të hulumtuesve dhe stafit të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë në ngritjen e çështjeve lidhur me funksionimin dhe performancën e institucioneve të sigurisë në vigjilje të shtet-ndërtimit. Kjo aq më parë që në këtë fazë të zhvillimit tonë pati vështirësi, neglizhencë por edhe subjektivizëm e që deri në ditët e sotit në riorganizimin dhe formësimin e institucioneve të sigurisë, vërehet ngadalësim dhe jo-profesionalizëm.

Metodologjia e përdorur për të gjitha vlerësimet e përmbledhura në këtë libër përfshinë metodat e hulumtimit cilësorë dhe sasior. Në teknikën e hulumtimit cilësor janë bërë intervista/kontakte me stafin relevant të sferës; është bërë vlerësimi i legjislacionit në fuqi; është vlerësuar literatura ndërkombëtare përkatëse dhe përputhur me nevojat e Kosovës dhe përvoja e ekspertiza individuale e ekspertëve të QKSS-së. Ndërsa, në teknikën e hulumtimit sasior aty ku ka pasur mundësi është mbledhur mendimi i opinionit publik në bazë të mostres përfaqësuese dhe të dhënat statistikore. Të gjitha informacionet e mbledhura nga të dy teknikat e përdorura janë përpunuar për nevojat specifike të vlerësimeve.

Ka qenë qëllim që secili raport dhe vlerësim të ketë një kombinim në mes të shkrimit akademik dhe profesional mirëpo të jetë i kuptuar për të gjitha palët e interesuara.

Për botimin e këtij libri kanë kontribuar disa individ të cilët në varësi të projekteve kanë bërë ekspertizën për vlerësime specifike. Falemenderimi i posaçëm i dedikohet donatorëve serioz të cilët mbështetën aktivitetet, projektet dhe hulumtimet e Qendrës tonë dhe rrjedhimisht ato po përmbledhen në këtë libër. Për kontributin e dhënë në hulumtimin, koncipimin dhe përpilimin e materialeve të Qendrës tonë, në veçanti falemenderoj:

- Prof.Dr. Haxhi FERATI, Ekspert i çështjeve të mbrojtjes dhe sigurisë dhe ligjërues i Lëndëve “Gjeopolitik dhe gjeostrategji” e “Hyrje në politikat e sigurisë”;
- Z. Kosum KOSUMI, Ing. i Aviacionit ushtarak dhe ekspert i planifikimit dhe operacioneve emergjente
- MA Florian QEHAJA, Njohës i politikave të sigurisë me specializim në politikat europiane të sigurisë dhe ligjërues i lëndës “Paqja dhe siguria ndërkombëtare
- MSs.MA Armend MUJA, Njohës i politikave ekonomike, ligjërues i lëndës “Marrëdhënie Ekonomomike Ndërkombëtare”,
- Z. Mentor VRAJOLLI, Jurist, Hulumtues në QKSS

Në pjesën e parë janë botuar shkrimet autoriale të drejtorit të QKSS-së e që kanë të bëjnë me vështrime, analiza, opinione për Policinë e Kosovës, Agjensionin e Inteligjencës, Reduktimin e KFOR-it, Formimin e FSK-së etj., e që ishin njëherit të interesit të përbashkët për sferën e sigurisë.

Në pjesën e dytë është përfshirë themelimi operacionalizimi dhe funksionalizimi demokratik i Forcës së Sigurisë së Kosovës. Për lexuesin ky hulumtim është tejet i rëndësishëm ngase mund të vërehen parimet bazë të mbikëqyrjes demokratike të kësaj force dhe të ngritjes së gatishmërisë vepruese të saj.

Në pjesën e tretë botohet “Vlerësimi i Rëndësisë së Këshillit të Sigurisë së Kosovës” si një ndër shtyllat kryesore të sektorit të sigurisë siç është konceptuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Është dhënë një kontribut në ngritjen e rëndësisë dhe nevojës së konsolidimit dhe operacionalizimit adekuat të Këshillit.

Në pjesë e katërt përfshihet për herë të parë publikimi nga qendra jonë i cili ka të bëjë me gjendjen aktuale në Kompanitë Private të Sigurisë duke u bazuar në gjetjet dhe mendimin e individëve, grupeve të fokusit, profesionistëve dhe zyrtarëve përgjegjës të kësaj lëmie.

Pjesa e pestë përfshin gjendjen e emergjencave dhe mbrojtjes civile në Republikën e Kosovës në vitin 2008 dhe hulumtimin cilësor dhe shumë të rëndësishëm për gjendjen e emergjencave në vitin 2009 me rekomandimet e duhura dhe masat të cilat duhet ndërmarr për mënjanimin e dobësive.

Ramadan QEHAJA

Drejtor i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

Recensionioni

Një studim që i ka munguar Kosovës

Siguria është nevojë themelore si dhe e drejtë fundamantale e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Ne synojmë ndërtimin e shtetit tonë si një shtet stabil dhe funksional. Stabiliteti i Kosovës mund të garantohet dhe funksionaliteti mund të demonstrohet vetëm me anë të forcimit të institucioneve të sigurisë dhe atyre të drejtësisë.

Kosova tashmë në kushtetutën e saj, e ka përcaktuar strukturën e sektorit të sigurisë dhe këto institucione janë në formim e sipër. Në këtë projekt i është bërë një vlerësim i drejtë të gjitha institucioneve të sigurisë dhe janë evidentuar defektet që po e shoqërojnë këtë proces.

Ndërtimin e sektorit të sigurisë projekti me plot të drejtë e vlerëson si punë të papërfunduar. Institucioniet tona të sigurisë ashtu siç janë ndërtuar apo si do të ndërtohen nuk janë rezultat i një studimi strategjik të sektorit të sigurisë por janë më shumë rezultat i presioneve të theksuara apo kufizimeve politike në të cilat po ballafaqohet Kosova.

Ky projekt, përveç këtij vlerësimi jep edhe disa rekomandime të vlefshme për mënyrën e ndërtimit të sektorit të sigurisë për strukturën e tyre, kompetencat, kapacitetet dhe mënyrën e përdorimit.

Nuk ka asnjë dyshim se sektori i sigurisë në Kosovë, ashtu si është i dizajnuar dhe ashtu siç është duke u ndërtuar dhe funksionuar nuk është i qëndrueshëm dhe duhet t'i përshtatet situatës reale në Kosovë në mënyrë që të kemi një strukturë dhe forca të sigurisë që do t'i përmbushin detyrat në mjedisin e sotshëm dhe të ardhshëm të sigurisë. Këto institucione duhet të zhvillohen në përputhje me burimet e kufizuara që buxheti i Kosovës mund t'i ndajë për këtë qëllim.

Në ndërtimin e një sektori të mirëfilltë të sigurisë duhet të hartohet një strategji kombëtare e sigurisë e cila duhet të vjen si rezultat jo i punës së një grupi punues por si rezultat i një studimi strategjik të sektorit të sigurisë.

Ky studim duhet të ketë disa faza e në veçanti këto:

1. Definimi i ambientit gjeostrategjik dhe identifikimi i rreziqeve dhe kërcënimeve për sigurinë e Kosovës dhe qytetarëve të saj
2. Definimi i strategjisë kombëtare të sigurisë dhe përcaktimi i misionit dhe detyrave të institucioneve të sigurisë
3. Analiza funksionale e institucioneve dhe strukturave tjera të sigurisë. Këtë analize e ka bërë në mënyrë shumë profesionale ky studim i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë
4. Identifikimi i mungesave apo dallimeve në mes kapaciteteve që kanë dhe kapaciteteve që duhet të kenë institucionet e sigurisë
5. Definimi i strukturave, skemave organizative, madhësisë numerike dhe kapaciteteve të nevojshme
6. Llogaritjen e kostos së ngritjes, ndërtimit dhe funksionimit të këtyre institucioneve

Në fund mendoj se ky studim i ka bërë një vlerësim real dhe profesional sektorit të sigurisë. Prandaj, është shumë me rëndësi që ky material të botohet si libër për të qenë në shfrytëzim për të gjithë ata që merren me këtë fushë që është esenciale për Kosovën. Është një studim me vlerë që i ka munguar Kosovës dhe që është i dobishëm dhe shumë i nevojshëm edhe për institucionet tona të sigurisë.

Agim Çeku, ish-Kryeministër i Kosovës
Recensent

SHKRIMET AUTORIALE TË
DREJTORIT TË QKSS-SË,
RAMADAN QEHAJA

KAPITULLI I

REDUKTIMI I KFOR-it FAKTIKISHT KA FILLUAR

Prononcimi dhe konfirmimi zyrtar nga komandanti aktual i KFOR-it se gjatë këtij viti do të pason zvogëlimi i numrit të trupave të NATO-s në Kosovë është një sinjal se deri në fund të këtij viti ky zvogëlim do të jetë mjaft i theksuar. Kjo gjithsesi do të ndodhë si duket, përkundër përgënjeshtimit të deklaratave të eprorëve ushtarak nga sekretari i përgjithshëm i Aleancës Veri-Atlantike se një gjë e tillë nuk do të ndodhë. Ai theksoi se një gjë e tillë ende nuk është diskutuar dhe nuk është marrë kurrfarë vendimi në lidhje me këtë. Një deklaratë e tillë si duket më tepër ka karakter politik, përkatësisht qetësues se sa përgënjeshtrim domethënës. Disa shtete si Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia etj., që kanë participuar në KFOR, paralajmëruan zvogëlim dhe tërheqje të forcave të tyre që tani. Pa mëdyshje se reduktimi i numrit të trupave të KFOR-it do të ndodhë.

Përveç nevojës së angazhimit të NATO-s në Afganistan e gjetiu në luftë kundër terrorizmit, kriza ekonomike e cila është duke u thelluar gjithnjë e më tepër, domosdoshmërisht ka ndikuar dhe do të ndikoj në këtë reduktim. Ndërsa, deklaratat e aty-këtushme se ky reduktim i paralajmëruar po bëhet si rezultat i përmirësimit të situatës së sigurisë në Kosovë dhe rajon në momentin aktual nuk mund të jetë arsytim i mjaftueshëm për një veprim të tillë. Në këtë kontekst duhet theksuar se në aspektin e sigurisë në Republikën e Kosovës, pjesa veriore e saj është pika më neurgjike e cila në momentin e caktuar mund të vlerësohet si burim i destabilitetit të theksuar jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon. Padëgjueshmëria e qytetarëve Serb të Kosovës ndaj Pavarësisë dhe institucioneve të Republikës së Kosovës dhe ekzistimi i strukturave paralele të dirigjuara nga Beogradi zyrtar është po ashtu element i cili do të ndikoj në qëndrueshmërinë politike dhe të sigurisë në vendin tonë. Nëse kësaj i shtohet situata shume e vështirë ekonomike në vend, korrupsioni, trafikimi dhe dobësitë tjera të cilat po e përcjellin shoqërinë tonë e që elementet e ndryshme destabilizues do të tentojnë të shfrytëzojnë, atëherë serioziteti i problemit në aspektin e sigurisë bëhet edhe më i madh. S'do mend se shërbimet e ndryshme inteligjente që veprojnë në Kosovës, sidomos ai Serb, mund të jenë elemente shtytës për destabilizim.

Prandaj reduktimi i paralajmëruar i trupave të KFOR-it është për mendimin tim i përshpejtuar dhe në momentin aktual hap i ngutshëm. Shumë shtete anëtare të NATO-s janë duke e kundërshtuar zvogëlimin e trupave në Kosovë sepse siç thonë, situata e sigurisë atje nuk është e kënaqshme. Sidoqoftë edhe nëse ndodh ky reduktim i paralajmëruar i prezencës së NATO-s në Kosovë, siç edhe ka filluar, një numër rreth 5000 trupash do të mbeten edhe më tej në vendin tonë. Në këtë kontekst ne që merremi me analiza të çështjeve të sigurisë, jo rastësisht dhe jo për të kritikuar kemi kërkuar që të përshpejtohet fillimi i formimit të FSK-së dhe Shërbimit të Inteligjencës. Një kërkesë të tillë e kanë pasur edhe shumë analist tjerë, shoqëria civile por edhe opozita. Në fakt vonesat në momentin aktual kur kemi të bëjmë me forcat dhe mjetet vetanake të sigurisë, përveç Policisë së Kosovës e cila është e dedikuar për rend, nuk kemi forcë tjetër plotësisht operacionale. Kjo aq më parë që pas shpërbërjes së TMK-së në momentin aktual jemi në fazën fillestare të fillimit të formimit të FSK-së. Kjo do të thotë se operacionalizimi i saj, qoftë ajo mjaft e limituar numerikisht siç është, do të kërkon mjaft kohë. Ndërs Shërbimi i Inteligjencës as që ka filluar së formuari. Ajo çka duhet kuptuar është se që tani duhet të fillojmë të mendojmë të mbështetemi në forcat vetanake të sigurisë. Kjo nënkupton ri-organizim kadrovik, strukturor, operacional etj., të Policisë së Kosovës e cila përkundër rezultateve të pamohueshme ende ka probleme, vështirësi sidomos të karakterit material-teknik të paisjes etj., për të ngritur gatishmërinë vepruese konform kërkesave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Një përshpejtim në ngritjen dhe operacionalizimin siç thamë të FSK-së është më se i domosdoshëm duke nënkuptuar këtu para së gjithash në forcimin e komandave dhe njësiteve qofshin ato edhe te vogla për momentin por që përbëjnë bërthamat e domosdoshme për përforcimin e kësaj komponente mbrojtëse.

Pavarësisht nga vlerësimet dhe deklaratat e ndryshme se rrezikshmëria e sulmit eventual në vendin tonë nga jashtë është e tejkaluar, kujtoj se një vlerësim i tillë është jo i bazuar në fakte dhe metodologjinë e re të destabilizimit të mundshëm. Prandaj çështjeve të sigurisë, mjeteve dhe forcave të saja e jo sikurse deri me tani duhet të trajtohen me prioritet dhe profesionalizëm konform Strategjisë së Sigurisë Nacionale të cilën do të duhej sa më parë të fillojmë të formësojmë.

Këtë shkrim ndoshta do të ishte mirë të përmbyllim me një thënie të Kancelares Gjermane Angela Merkel e cila ditë më parë pati theksuar se Kosovarët duhet të mësohen të mbështeten në forcat e veta. Se sa do të fillojmë të mësohemi që ti përmbahemi këtij parimi mbetet të shihet. Sidoqoftë rrethanat kanë ndryshuar. Mbështetja në forcat dhe qëndrimet tona tani duhet të jenë prioritet.

“Koha Ditore”, Maj 2009

FORCË E SIGURISË APO USHTRI?

Është i mirëseardhur prononcimi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës lidhur me Projekt Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo aq më parë që kemi të bëjmë me një akt më të lartë juridik e politik të vendit tonë. Prandaj, përcjellja e diskutimit publik lidhur me Kushtetutën dhe vërejtjet e shprehura nga ASHAK gjithsesi do të duheshin të mirren parasysh aty ku kjo është e mundur. Duke mos dashur të i komentojë propozimet e ofruara të cilat në esencë janë me vend dhe esenciale, desha vetëm të ndërlihem në propozimin e shtatë i cili është dhënë nga ASHAK e që ka këtë përmbajtje: “ Në zgjedhjet e ofruara me projekt-kushtetutë nuk është reflektuarë qartë dhe saktë Forca Mbrojtëse e Kosovës prandaj propozohet në aktin më të lartë juridik të shtetit, të parashihet që Kosova të ketë ushtrinë e vet”.

Është e vërtetë se do të duhej të precizohej termi USHTRI, sikur që e kanë të gjitha shtetet tjera. Mirëpo, fjala është për atë se në planin e Ahtisaarit nuk është paraparë FORCA MBROJTËSE E as USHTRIA por vetëm FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS. Term paksa i rrallë në terminologjinë e kushtetutave të shteteve tjera. Kjo aq më parë që termi siguri është term i gjerë dhe përfshinë të gjitha lëmitë e sigurisë, mbrojtjes dhe rendit. Para se të diskutohet teksti i propozuar i planit të Ahtisaarit në Vjenë, unë si njohës i kësaj lëmie në një të përditshme kosovare kam dhënë përparësitë dhe dobësitë e tekstit të propozuar. Përvec meje, nuk më kujtohet se ndokush të ketë dhënë vërejtje me shkrim e as Akademia e jonë e mirënjohur. Me rastin e diskutimeve të cilat janë zhvilluar në atë periudhë kohore, sic thashë, në Vjenë askush nga ekspertët vendorë të sigurisë nuk është ftuar. Kam pritur nëse jo dikush tjetër, atëher do të jetë i ftuar z. Naim Maloku, si kryetarë i atëhershëm i Komisionit parlamentarë për siguri i Kuvendit të Kosovës.

Një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Vërejtjet, sygjerimet dhe propozimet lidhur me çështjet e sigurisë atje i dhanë disa anëtarë të grupit të atëhershëm politik strategjik për negociatë, kryesisht njerëz jokompetent (historianë, gjeograf, gjuhëtarë etj) dhe propozimi i parashtruar sipas variantës së parë të Ahtisaarit mbeti pa asnjë germ i pandryshuar.

Unë e kuptoj pse thuhet FSK e kjo ka të bëjë me rezistencën e vazhdueshme dhe kategorike sidomos të Serbisë që Kosova mos të ketë ushtrinë e vet. Prandaj është dashur të gjindet një term si ky. Sidoqoftë, ne do të formojmë këtë Forcë të Sigurisë si dhe Ministrinë e Mbrojtjes, përkatësisht të Forcës së Sigurisë, e cila edhe pse mjaft e limituar, do t'i ketë, elementet e një ushtrie. Në këtë drejtim do të duhej të punohej shumë dhe me ekspert të mirëfilltë për t'ia vuar themelet ashtu sic do të duhej. Ju si Akademi e nderuar, nuk më kujtohet të keni dhënë ndonjë propozim lidhur me këtë në fazën e bisedimeve dhe mundësive eventuale për vërejtje dhe sygjerime. Në këtë moment, propozimi i juaj është shumë i vonuar dhe nuk mund të futet fjala USHTRI sepse del nga suazat e planit të Ahtisaarit. Kam vërejtur se edhe në diskutimet publike nëpër komuna lidhur me tekstin e projekt-propozimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjithkund kjo çështje shtrohet nga qytetarët, por spjegimet janë joadekuate, gjysmake dhe joprofesionale dhe shpeshherë qytetarët ndahen të paknaqur më përgjegjen që e marrin. Kjo edhe nga shkakun se në grupin për hartimin e projekt-kushtetutës nuk ka (së paku nuk më është njohur) të kycur ndonjë ekspert i sigurisë. Mos për asgjë tjetër, atëherë për të dhënë përgjegje adekuate qytetarëve të cilët kërkojnë spjegime.

Dhe së fundi e cmoj propozimin e ASHAK por është paksa i vonuar.

“Kosova Sot”, Mars 2008

A KA JUSTIFIKIM PËR MOSSHTRIRJE TË PUSHTETIT NË PJESËN VERIORE TË MITROVICËS

Askush deri më sot qoftë nga qeveritarët qoftë nga analistët e ndryshëm nuk dhanë ndonjë propozim konkret si, në çfarë mënyre, me cilat forca dhe mjete mund të riintegrohet pjesa veriore e Kosovës në rrjedhat e tërësishme konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në cilësimin e kësaj zone, nga disa analistë vendorë e ndërkombëtarë si zonë e mundshme e konfliktit të ngrirë me një rrezikshmëri të lartë të eskalimit të situatës politike e të sigurisë, sikur pati reaksione mjaft të ashpra nga një pjesë e lidhshmit tonë se ajo zonë nuk mund të quhet zonë e konfliktit të ngrirë duke spjeguar këtë me integritetin territorial të Kosovës të cilin e mundëson kushtetuta.

Mirëpo, duke u bazuar në gjendjen faktike atje, përkatësisht me konsolidimin e mëtejme të strukturave paralele serbe të sigurisë, veprimin të kimit të organizuar dhe me mundësinë e destabilizimit të mëtejme, siç thamë, të kësaj pjesë të territorit, atëherë nuk mund të themi se nuk ka elemente të konfliktit të ngrirë. Përkundrazi. Lidhur me këtë nga këndvështrimi i mundësisë së radikalizimit të mëtejme të veprimeve të Serbisë për të bërë ndarjen e kësaj pjesë edhe më faktike, do theksuar se:

Së pari, rrezikshmërinë e veprimin eventual të Serbisë për të mbështetur hapur me forca dhe mjete të dhunshme, strukturat paralele të sigurisë, nuk mund të mohohet krejtësisht;

Së dyti, është e vërtetë se NATO nëpërmjet KFOR-it e kontrollon këtë pjesë të territorit dhe se një veprim i tillë i dhunshëm i Serbisë kishte me qenë ballafaqim me forcat e NATO's e që në fakt implikimet do të ishin shumë të mëdha. Kjo aq më parë që Serbia është anëtare e programit të NATO-s Partneritet për Paqe.

Së treti, bazuar në faktin se disa shtete anëtare të NATO's nuk e kanë njohur Kosovën si shtet, atëherë mund të vihet në pikpyetje edhe uniteti në vet Aleancën sidomos në politikbërje dhe vendimarrje në raport me veprimet në pjesën veriore të territorit të Kosovës të cilin e kontrollon Beogradi zyrtarë. Në vecanti shtrohet brenga që kjo do të ndikojë në situatën në terren ku disa prej këtyre shteteve mund të i përgjigjen

Ministrive të tyre të Mbrojtjes në vend të rrespektimit të komandave nga NATO (rasti konkret lidhur këtë është gjatë trazirave të marsit 2004).

S'do mend se status quoja e cila po dominon në atë pjesë të territorit tanë që nëntë vite, nuk mund të qëndrojë më. Durimit, si tek popullata shumicë, e cila është e ballafaquar me probleme shumë të rënda socio-ekonomike, ashtu edhe tek organet shtetërore kosovare, sikur po i vjen fundi. Disa veprime të një numri të komunitetit serb në pjesën veriore të Mitrovicës ditëve të fundit siç ishte rasti i ndërprerjes së kryerjes së projektit për furnizim të popullatës shqiptare me ujë të pijshëm, përlëshja e para disa ditëve në mes të të rinjëve shqiptarë e serb tek tre rrokaqiejtë, moslejimi i shqiptarëve të adaptojnë apo ndërtojnë shtëpitë e tyre etj, janë paralajmërim i bollshëm që situata atje, edhe për shkak të moskontrollimit të pikave kufitare, shumë lehtë mund të del jashtë kontrollit. Për këtë është më se e nevojshme që ky status quo të cilën po e toleron dhe mban para së gjithash faktori ndërkombëtarë, duhet urgjentisht të merr fund. Apelet për mirëkuptim, qetësi dhe durim si duket nuk do të bëjnë punë. Kujtoj se Qeveria e Kosovës që tani duhet të jetë shumë më e zëshme duke kërkuar kthim të kësaj pjese të territorit nën juridiksionin e vet dhe atë në bashkëpunim të ngushtë me KFOR-in dhe EULEX-in. Kjo nënkupton para së gjithash prezentimin e planit konkret qeveritarë me cilat forma dhe metoda politike të zbus padëgjueshmërinë qytetare që po mbretëron atje dhe si të i qaset fillimit të vurjes nën kontroll të kësaj pjese por edhe të forcave dhe mjeteve të sigurisë (para së gjithash të policisë vendore) të cilat do të duheshin të angazhoheshin për të bllokuar dhe pamundësuar veprimin e strukturave paralele të sigurisë konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kuptohet se kundërshtarët e kësaj qasje qeveritare të propozuar në këtë shkrim autorial do të "argumentonin" këtë veprim si të dëmshëm sidomos për faktin gjëja se do të iritohej Beogradi zyrtarë dhe nevojës së pranimit të mëtejme të shtetësisë së Kosovës nga një numër ende i madh i shteteve e jo vetëm atyre arabe. Por në anën tjetër, përveç ofenzivës së paskrupulltë diplomatike të Serbisë, konsideroj se kjo brishtësi politike dhe e sigurisë e cila po mbretëron në Kosovë, para së gjithash, me situatën e krijuar në veri të vendit, ka bërë që përveç tjerash të ndikojë në hamendje të disa shteteve për pranim të shtetësisë së Kosovës. Nëse deri më tani kemi qenë të detyruar ndoshta të jemi tepër të dëgjueshëm dhe të

kujdesshëm ndaj faktorit ndërkombëtarë, tani pas aprovimit të kushtetutës, situata do të duhej të ketë ndryshuar.

Kjo aq më parë që gjithnjë e më tepër populli po kërkon fillimin e zbatimit të saj në praktikë. Kjo nuk do të thotë se ne nuk duhet të bashkëpunojmë me bashkësinë ndërkombëtare. Por një qasje dhe vendosshmëri më e theksuar e jona shtetërore për nevojën e zbatimit të kushtetushmërisë sigurisht se nuk do të mundet apriori të hudhet poshtë nga kushdoqoftë. Përkundrazi, ajo do të çmohej. Kjo aq më parë që sidomos problemet siç thamë sociale që e kanë kapluar një pjesë mjaft të madhe të popullatës, korrupsioni, joligjshmëria, krimi i organizuar, mospuna, apatia por edhe të krijimit të përshtypjes në paaftësinë e shtetit në shtrirjen e pushtetit në tërë territorin e Kosovës, sikur paralajmërojnë një paknaqësi dhe tentativë që ato të shprehen nga popullata jo vetëm me protesta e greva por ekziston mundësia që ato të eskalojnë edhe në forma më të ashpra. Kjo do të ishte ajo më e keqja që mund të na ndodh e që përveç tjerash, reperkusionet në planin e sigurisë do të ishin shumë të mëdha.

Në këtë situatë sidomos lënia anash apo pritja se dikush tjetër do të na rregullojë ose zbut problemin e pjesës veriore të vendit tonë është e pajustificueshme.

“Koha Ditore”, Shkurt 2008

ÇËSHTJET KADROVIKE NË POLICI JANË ME PRIORITET

Policia e Kosovës është njëra ndër institucionet e vetme në sektorin e sigurisë që duhet të i nënshtrohet procesit të reformimit krahas kërkesave të brendshme dhe duke pasur parasysh procesin e reformimit që po kalojnë policitë e shteteve të rajonit.

Thënia popullore “ra kjo vdekje dhe u pamë” konsiston edhe në rastin konkret të fundit që ndodhi në Policinë e Kosovës dhe që rrjedhimisht shpalos nevojën për reformim të këtij institucioni të sigurisë. Në këtë mënyrë vlen të bëhet një analizë e mirëfilltë jo vetëm nga analistët dhe ekspertët por edhe nga vet institucionet përkatëse. Për rastin e vjedhjes së provave materiale nga ndërtesa e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës është folur shumë dhe nuk ka arsye që të përshkruajmë dhe

diskutojmë për detajet në lidhje me këtë rast. Mirëpo që në fillim duhet të theksohet se thjesht një gjë e tillë nuk ka guxuar të ndodh.

Pasi që e kemi fjalën për nevojën e një analize të mirëfilltë të gjendjes së tërësishme në policinë e Kosovës në shumë aspekte atëherë ky shkrim ka për qëllim të inicioj disa aspekte të rëndësishme dhe të ipen përgjigje të mundshme në pyetjen se a mund të jemi të kënaqur me politikën e deritanishme kadrovike të këtij institucioni të sigurisë? Përgjigja do të ishte domosdoshmërisht e paknaqshme. Pikësëpari problemet nuk fillojnë tash mirëpo ato datojnë që më herët. Kjo nga shkakun se në periudhën e pasluftës kur filloi së formuari policia (atëherë SHPK) nuk pati kritere të mirëfillta të rekrutimit të rinjve në të përveç kriterit të përfaqësimit të gjinisë femërore dhe etnike. Zyrtarët e UNMIK-ut të angazhuar në plotësimin e strukturës policore, në bashkëpunim me menaxhmentin e atëhershëm vendor, nuk ishin të prirë që të bëjnë një verifikim të së kaluarës të cdo kandidati duke kërkuar sidomos më tepër sic thonin atëherë “zhdërvjellësi” për policët e ardhshëm në kryerjen e detyrave që i presin. Ndërsa për aspektin edukativo-arsimorë pati raste të pranimit edhe me diploma të falsikuara e kështu me rradhë. Pra, ana kuantitative ishte përmbushur por jo edhe ajo kualitative në jo pak raste.

Opinionit tonë i kujtohet edhe marrëveshja “dy-palëshe” për plotësimin e policisë me pjestarë që i takonin LDK-së si lëvizje dhe PDK-së, duke e gjetur kështu një “gjuhë” të përbashkët në këtë drejtim.

S’do mend se përveç faktorit të verifikimit të së kaluarës së cdo kandidati dhe atij moral, ai i përkatësisë partiake u inkorporua në rradhët e këtij institucioni. Në këtë mënyrë u krijuan kushtet për anime, moskryerje të detyrës me nder e që bënë që një numër i policëve të shquhet me dukuri negative duke lënë mbresa jo të mira në popullatë. Në anën tjetër, faktori material, përkatësisht pagat tejet të ulëta bënë që efektshmëria e policëve të mos jetë në nivelin e duhur. Njëkohësisht është rritur probabiliteti i korruptimit të policit. Për më shumë, kur kemi të bëjmë me faktorin njeri – përkatësisht me politikën kadrovike në polici, duhet theksuar posaçërisht që asnjë qeveri e sidomos kjo aktuale (përkundër mundësive kushtetutare) nuk është marrë ose u morrën në mënyrë jo të duhur me këtë çështje. Kjo nga shkakun se politika e “status quos” në polici përjashtoi ndryshimet thelbësore në aspektin kadrovik nga lartë-poshtë.

Duhet poashtu përkujtuar opinion se Ministria e Punëve të Brendshme funksionon tash që katër vite me rradhë, dhe përvec rasteve të rralla, ndërrime dhe ristrukturime të mirëfillta në polici nuk pati. Mendoj se një pjesë e pjestarëve të Policisë së Kosovës janë në nivel të detyrës, të përkushtuar dhe të gatshëm që me profesionalizëm t'i kryejë detyrat e parashtruara. Mirëpo edhe lëvizjet përkatësisht transferet e disa eprorëve të lartë nga një pozitë në tjetrën nganjëherë bënë të paqartë profesionalizmin në komandim dhe kontroll të njërive dhe departamenteve të Policisë së Kosovës.

Cështja e cila pati dhe do të ketë ndikim në gjendjen kadorvike e morale është gradimi i individëve jo në bazë të nivelit të shkollimit, kryerjes me sukses të detyrës paraprake etj, por kryesisht në baza të nepotizmit, klaneve dhe grupeve të ndryshme karrieriste. Si duket Ligji për Policinë i aprovuar së voni nuk zbatohet, sic thuhet, për shkak të kostos së lartë financiare, përvec pjesës e cila ka të bëjë me menaxhmentin e lartë që parashihen emërit nga Këshilli për Emërime të Larta i Qeverisë së Kosovës. Në këtë mënyrë lihet hapësirë për politizimin në përzgjedhjen dhe emërimin e eprorëve në pozita të larta të Policisë së Kosovës.

Konsideroj se duhet një veprim i shpejtë drejt përmirësimit të gjendjes qoftë ky veprim edhe i dhimshëm. Kjo aq më parë kur të merret parasysh se policia e Kosovës aktualisht është forca kryesore e rendit dhe sigurisë publike. Në momentin kur kemi një zbrastësi për shkak të shpërbërjes së TMK-së dhe mos mundësisë së funksionalizimit të FSK-së dhe të Agjencionit Kosovar të Inteligjencës, shtrohet domosdoja e ndërmarrjes së hapave të guximshëm në drejtim të fillimit të konsolidimit të gjendjes në Policinë e Kosovës. Ky institucion është gati se një ndër të vetmit që duhet të i nënshtrohet procesit të reformimit krahas kërkesave të brendshme dhe duke pasur parasysh procesin e reformimit që po kalojnë policitë e shteteve të rajonit. Reformimi sa më i shpejtë i Policisë së Kosovës do të forconte gatishmërinë vepruese të saj në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe rrjedhimisht do ti shmangte implikimet politike e grupore në të.

“Koha Ditore”, Maj 2009

AGJENSIONI I INTELIGJENCËS SË KOSOVËS POTHUAJSE I HARRUAR

Kjo e vështirëson ose e pamundëson marrjen e vendimeve adekuate që me forca, mjete dhe metoda adekuate të parandalohen aktivitetet armiqësore të drejtuara kundër Republikës së Kosovës nga brenda dhe nga jashtë.

Me 21 Maj 2008 në Kuvendin e Kosovës është aprovuar Ligji për Agjencionin e Kosovës për Inteligjencë i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë më vonë. Që prej atëherë e deri në ditët e sotme u bënë më tepër se një vit. Para tre muajsh Presidenti dhe Kryeministri i vendit e emëruan Drejtorin e këtij Agjencioni i cili për shkak të mos-emërimit të zëvendësit të tij dhe inspektorit të përgjithshëm mbeti i vetmuar dhe i penguar për fillimin e sendërtimit të strukturës së Agjencionit.

S'do mend se ky emërim i Drejtorit me shumë vonesë si duket është bërë para së gjithash për shkak të presioneve dhe kërkesave të opozitës dhe shoqërisë civile, sesa të ketë ekzistuar gatishmëria e formimit për shkak të nevojës së ekzistimit të tij. Heshtja e deritanishme dhe mos-bërja e ditur edhe të dy emrave të këtij Agjencioni (Zëvendësit dhe Inspektorit) nuk ka si të trajtohen ndryshe përveç si tendencë për caktimin e njerëzve “të besueshëm” nga lidërshipi aktual shtetëror. Përndryshe, ndonjë brengë për organizimin e aktivitetit të zbulimit, kundërzbulimit, kërcënimeve nga brenda dhe jashtë vendit, krimin e organizuar, veprimet terroriste, sabotazh etj., që kanë të bëjnë me sigurinë e popullit të Kosovës sikur nuk u ka dhe nuk u ekziston. Kjo sepse për një vonesë të tillë një vjeçare të mos fillimit të formimit të këtij institucioni të rëndësishëm, nuk mund të ketë justifikim. Po të kishte përgjegjësi, jo vetëm që pas një viti do të kishim stafin drejtues-menaxhues të këtij institucioni por edhe një organizim dhe mbulim të aktivitetit nëpër shtatë qendrat tona më të mëdha komunale prej nga do të vinin informacionet relevante, qofshin ato edhe të pakta, të zbulimit të hershëm të aktiviteteve të mundshme armiqësore kundër Republikës së Kosovës.

Kur të merret parasysh momenti aktual në të cilën gjendet Kosova për shkak të mospranimin të Pavarësisë së saj edhe nga një numër mjaft i madh i shteteve, aktiviteti skajshmërisht destruktiv i strukturave paralele Serbe, ndarjen e pjesës veriore të Kosovës, krimin të organizuar, korrupsionit të theksuar etj., dhe mos organizimi dhe mos gatishmëria që

këto dukuri të luftohen me mjete policore e juridike, atëherë ndërlikueshmëria e problemit bëhet edhe më i theksuar. Kuptohet se mos mundësia e mbledhjes, analizimit dhe shpërndarjes së informatave relevante kreut shtetëror të vendit, për shkak të mos-formimit të AKI-së, është në pikën më të ulët të mundshme. Kjo e vështirëson ose e pamundëson marrjen e vendimeve adekuate që me forca, mjete dhe metoda adekuate të parandalohen aktivitetet armiqësore të drejtuara kundër Republikës së Kosovës nga brenda dhe nga jashtë.

Nëse i referohemi Kreut IV, Nenit 12.2. të Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë se “Shpalljet e vendeve të lira të punës në AKI i nënshtrohen konkurrencës së hapur dhe publikohen në shumë gazeta ditore që shpërndahen në Kosovë, me përshtkrim të kërkesave të përgjithshme për pozitat në pajtim me ligjin në fuqi” atëherë mund të konkludojmë se ky Agjencion nuk do të filloj së formuari edhe për një vit tjetër. Shkakun qëndron në faktin e lartë-përmendur se për të ardhur deri të zbatueshmëria e legjislacionit të punësimit për punonjësit e AKI-së, duhet formuar kreun udhëheqës i cili domosdoshmërisht do të duhej të bëjnë platformën vjetore të politikës së inteligjencës, rregulloren e organizimit të brendshëm të miratuar nga Kryeministri, shpalljen e konkursit e shumë punë dhe aktivitete tjera.

Prandaj vonesa në formimin e tij nuk do të jetë 1 vjeçare por së paku 2 vjeçare, sepse me vet faktin e emërimit të drejtorit nuk mund të konsiderojmë se ky Agjencion ka filluar së vepruari. Në këtë mënyrë dhe me këtë vonesë kaq të madhe edhe po që se vjen deri të formësimi i këtij Agjencioni, atëherë për shkak të grumbullimit të problemeve dhe dukurive negative në vend, domosdoshmërisht aj do të detyrohet të shkoj pas ngjarjeve e jo të veproj si preventivë për pamundësimin, ndërprerjen apo pengimin e tyre.

Ajo që është tejet brengosëse pa dyshim se duhet theksuar mosmundësinë e ofrimit të bashkëpunimit, koordinimit të aktiviteteve dhe mbështetjes për Inteligjencë institucioneve qeveritare të vendit tonë. Bashkëpunimi më i theksuar do të duhej të organizohej me MPB-në, me theks të posaçëm në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe institucioneve tjera. Sikurse të ishte i organizuar ky Agjencion, qoftë edhe në fazën fillestare, supozohet se vështirë do të ndodhte vjedhja e provave materiale të krimit të organizuar në ndërtesën e policisë së Kosovës. Kur

është fjala për transparencë edhe Mbikëqyrje Parlamentare në formësimin dhe aktivitetin e këtij institucioni, atëherë ajo sikur nuk ekziston ose së paku opinioni nuk është i njoftuar. Në Nenin 35 të ligjit në fjalë përcaktohet se “mbikëqyrja e AKI-së kryhet nga komisioni mbikëqyrës parlamentar mandati i të cilit përshkruhet me këtë ligj. Përbërja e tij përcaktohet me rregulloren e punës së Kuvendit të Kosovës”. Me të njëjtin ligj është paraparë që kryetari i komisionit mbikëqyrës parlamentar nuk duhet të jetë anëtar i partisë politike apo koalicionit qeverisës që është në pushtet. Ky komision lere më që nuk është formuar por edhe ndonjë aktivitet në këtë drejtim nuk vërehet. Si duket kjo mos-bërje asgjë për formësimin dhe kontrollin e këtij Agjencioni, sikur dikujt po i konvenon. Por një gjë është më se e qartë. Ky Agjencion nuk është çështje private e ndonjë personi, grupacioni apo partie politike. Ai i takon shtetit dhe popullit të Kosovës dhe askujt tjetër. Herët a vonë kjo do të kuptohet edhe do të epet përgjegjësi për ngecje të karakterit kryesisht subjektiv në formësimin e këtij institucionit shumë të rëndësishëm.

“Koha Ditore”, Maj 2009

A I NGJASON FSK USHTRISË APO JO?

Vite me radhë jemi marrë me çështje të mbrojtjes civile. Edhe pse FSK-së i takojnë detyrat e mbrojtjes civile de gatishmërisë emergjente, kjo nuk do të thotë se ajo nuk mund të kryej edhe detyra të karakterit ushtarak.

Janë tri thekse të deklaratave të rëndësishme që i dha Komandanti i Krahut Jugor të NATO's, Gjenerali Mark Fitzgerald para dy ditësh në selinë e KFOR-it në Prishtinë.

E para: Deklarata ka të bëjë me faktin se tani më është aprovuar vendimi për fillimin e reduktimit të forcave të KFOR-it të cilat, sipas tij, deri në vitin 2012 do të mund të numërojnë vetëm 2500 trupa. Kuptohet se kjo nuk ishte ndonjë befasi për ne, sepse një reduktim të tillë kemi mundur ta parashohim edhe vet ne në analizat tona. Kjo aq më parë kur të merren parasysh kërkesat dhe nevojat për angazhimin e NATO-s në vatrat tjera të krizave në botë, sidomos kur është fjala për luftimin e terrorizmit etj.

E dyta: thuhet se “Problemet që ekzistojnë në Kosovë nuk janë më të natyrës ushtarake por janë të tilla që duhet zgjidhur me forca Policore”. S’do mend se një vlerësim i tillë është i qëlluar por vetëm nëse kjo polici vendore do të ishte e riorganizuar dhe e një niveli të lartë gatishmërie vepruese në kuptim, para së gjithash, të pajisjes së saj me armatim dhe mjete tjera të nevojshme teknike që e bëjnë atë rezistente ndaj sulmeve të ndryshme si dhe i sigurojnë lëvizshmëri të vazhdueshme. Përveç kësaj për të vepruar policia vendore konform nevojave kushtetuese që parashtrihen dhe për të pasur rezultate në fushën e rendit, do të duhej të ishte i siguar ambienti politik i cili mundëson një veprimtari të duhur në tërë territorin e Kosovës. Pasi që kjo deri në ditët e sotit nuk ka mundur të sigurohet në një pjesë të konsiderueshme të territorit të Republikës së Kosovës, atëherë shtrohet pyetja se si është e mundur që pa një prezencë të mirëfilltë dhe adekuate të forcave të KFOR-it, të arrihet operacionalizimi i plotë. S’do mend se një analizë më e thellë mund të vij në përfundim se prezenca e KFOR-it jo edhe e vogël është më se e domosdoshme edhe në muajt dhe vitet në vijim. Sido qoftë kjo prezencë e KFOR-it do të duhej të sigurohej varësisht prej situatës dhe rrethimit në të cilin gjendemi në raport me Serbin dhe politikës së vazhdueshme de-stabilizuese të saj si duket edhe për një kohë të gjatë do të zbatohet me tërë vrazhdësinë e saj.

E treta: Deklarata e Gjeneralit Fitzgerald vë theksin e posaçëm or të bindur opinionin se FSK-ja nuk është ushtri duke thënë “FSK-ja natyrisht që kontribuon në sigurinë e përgjithshme të vendit, por ky nuk është zëvendësim”. FSK është, siç thekson ai, forcë për të kryer detyra jo-ushtarake. Kjo deklaratë si duket ka më shumë karakter politik se sa ushtarak, vetëm e vetëm për të “bindur” kundërshtarët e kësaj force, e para së gjithash Beogradin zyrtar, se ajo nuk paraqet ndonjë rrezikshmëri për shtetet fqinjë e para së gjithash për Serbinë. Në fakt edhe lidershipi serb këtë shumë mirë e ka të qartë por qëllimisht “rrezikshmërinë” nga kjo forcë në vazhdimësi e thekson, bile edhe në KS të OKB-së duke kërkuar që ajo të mos ekzistoj. Prandaj është dashur që një epror i lartë i NATO-s të theksoj posaçërisht duke e quajtur atë forcë jo për detyra ushtarake edhe pse në Kushtetutën e Republike të Kosovës në mënyrë decisive kështu nuk theksohet. Kjo ngase detyrat ushtarake mund të kryhen edhe me armatim të lehtë me të cilin ajo do të jetë e armatosur. Detyrat e mbrojtjes civile dhe gatishmërisë emergjente i kryejnë edhe ushtritë e vendeve tjera. Në anën tjetër Kushtetuta e Republikës së

Kosovës le hapësirë për kryerjen e atyre detyrave nga FSK-ja të cilat nuk mund ti kryej policia.

Me vet faktin se formësimi i njësiteve dhe reparteve të FSK-së kryhet nga oficerët e caktuar të KFOR-it, asocon në përgatitje edhe për detyra ushtarake. Edhe kritikantët të cilat nganjëherë i drejtohen NATO-s nga disa zyrtar të lartë Serb, për implikim në formësimin e FSK-së s Vite me radhë jemi marrë me çështje të mbrojtjes civile. Edhe pse FSK-së i takojnë detyrat e mbrojtjes civile de gatishmërisë emergjente, kjo nuk do të thotë se ajo nuk mund të kryej edhe detyra të karakterit ushtarak. i duket po i shtyjnë eprorët e lartë të kësaj aleance të theksojnë vetëm rolin e saj për kryerjen e detyrave për mbrojtje civile e jo edhe të atyre të karakterit ushtarak nëse për këtë shtohet nevoja. Konsideroj se arsyetimet e tepruara në këtë drejtim sikur po bëhen kontra-produktive te popullata Kosovare. Kjo aq më parë që Republikës së Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran i takon, sikur të gjitha shteteve tjera të kenë forca mbrojtëse. Tjetër është që ne si shtet në tranzicion kemi pranuar që për shkak të kontributit rajonal në planin e sigurisë të kemi një forcë të sigurisë të tipit të FSK-së. Vite me radhë jemi marrë me çështje të mbrojtjes civile. Edhe pse FSK-së i takojnë detyrat e mbrojtjes civile de gatishmërisë emergjente, kjo nuk do të thotë se ajo nuk mund të kryej edhe detyra të karakterit ushtarak. Kjo sidomos tani kur pason zvogëlimi drastik i NATO-s në Kosovë. Sido që të jetë, kërkesat tona në këtë drejtim duket të jenë më të zëshme dhe më të theksuara. Jo për të rrezikuar dikë por për të filluar që ti marrim kompetencat e sigurisë së tërësishme në tërë vendin në mënyrë graduale. Hezitimet në këtë drejtim nuk kontribuojnë në ngritjen e një sigurie të mirëfilltë. Pa fillimin e pjesëmarrjes aktive të vendorëve, deshi dikush apo jo në zbatim konkret të çështjeve të sigurisë, kjo lëmi do të karakterizohet me mangësi.

“Koha Ditore”, Qershor 2009

KOSOVA DHE SIGURIA RAJONALE

S'do mend se pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, çështjes së krijimit të një mjedisi adekuat të sigurisë ju kushtua vëmendja e posaçme, kuptohet në bashkëpunim të ngushtë me faktorin ndërkombëtar. Kjo aq më parë kur të merret parasysh pozita gjeografike dhe gjeostrategjike e Kosovës në Ballkanin perëndimor, përkatësisht të një territori i cili ishte dhe do të mbetet si urë lidhëse në mes shteteve në rajon e më gjerë.

Me të drejtë vëmendja e posaçme iu kushtua krijimit të një kornize juridike për strukturën e ardhshme të sigurisë së Kosovës. Edhe pse në mënyrë të shpejtuar, por domosdoshmërisht në Kuvendin e Kosovës u aprovuan ligjet më të rëndësishme të cilat rregullojnë ndërtimin e një strukture të re të sigurisë si dhe të riorganizimit të institucionit ekzistues e që ka të bëjë me Policinë e Kosovës.

Konsideroj se në mënyrë të qartë, gjatë koncipimit dhe aprovimit të ligjeve për forcat e sigurisë, ju kushtuan kujdes mbikëqyrjes dhe kontrollit civil demokratik konform standardeve të shteteve Perëndimore. Pra, kur kemi të bëjmë me anën ligjore të rregullimit të kësaj lëmije shumë të rëndësishme u arritën rezultate të konsiderueshme.

Duke u bazuar në faktin se kërcënimet dhe rrezikshmëritë të cilat i kanosen Kosovës janë të përbashkëta edhe për shumicën e vendeve të rajonit atëherë edhe ballafaqimi me to dhe kundërvënja këtyre rreziqeve, duhet të jetë në një mënyrë e përbashkët me shtetet e rajonit. Kjo s'ka si të jetë ndryshe kur të merret parasysh terrorizmi dhe mënyrat e të shprehurit të tij, krimi i organizuar, korrupsioni, fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri etj.

Kur është fjala për Policinë e Kosovës, përkundër dobësive të brendshme, lëshimeve të ndryshme, mospajses së duhur etj., ajo sikur edhe policitë tjera të rajonit është duke vepruar në një gatishmëri të kënaqshme në parandalimin e dukurive negative me të cilat po ballafaqohet shoqëria jonë, por ato mund të jenë të përbashkëta edhe për disa shtete fqinjë. Si një polici relativisht e re dhe pa përvojë të madhe ajo vëmendje të posaçme i ka kushtuar dhe do të kushtoj menaxhimit të integruar të kufirit. Kjo aq më parë se si rezultat i porozitetit mjaft të

theksuar të kufirit në kuptim të mundësisë së kryerjes të kimit të organizuar, trafikimeve të ndryshme, veprave kriminale etj., ishin dhe ende mbeten si dukuri shqetësuese. Për këtë ishim të detyruar të përpilojmë dhe të aprovojmë një strategji kombëtare të menaxhimit të integruar të kufirit. Në këtë mënyrë ne, ashtu të shprehëm, në lëvizje e sipër jemi duke e formësuar dhe ndërtuar Policinë Kufitare si forcë krejtësisht të re për kryerjen e detyrave që kanë të bëjë me stabilitetin e brendshëm dhe atë rajonal. Për këtë rast duhet të veçoj se përveç me Serbinë, bashkëpunimin ndërkuftar me vendet fqinjë (Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë) është në nivel të kërkesave për Stabilizim Asocim të Ballkanit Perëndimor.

Njëkohësisht ne si Republikë e Kosovës në këtë fazë të tranzicionit ju kemi qasur, edhe pse me vonësë mjaft të madhe edhe formimit të strukturave tjera të sigurisë. Fjala është para së gjithash për formimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës konform standardeve të NATO-s dhe Planit të Ahtisarit. Kuptohet se ne kemi pranuar të formojmë këtë forcë mjaft të limituar numerikisht me një armatim të lehtë dhe me disa elemente ushtarake por kryesisht për kryerjen e detyrave të sigurisë së brendshme dhe të Gatishmërisë Emergjente. Kjo forcë me këtë përmbajtje kurrsesi nuk mund të rrezikoj dikë në rajon e më së paku Serbin. Në këtë mënyrë ne si shtet i ri në ndërtim e sipër, konkretisht kemi filluar të kontribuojmë në sigurinë rajonale.

Nuk e përmenda edhe një element tejet të rëndësishëm sepse ai ende nuk ka filluar së formuari e ky është Agjensioni Kosovar i Inteligjencës i cili në kontekstin e tërësishëm të sigurisë së brendshme dhe asaj rajonale ka rëndësi të rendit të parë. Kur them këtë atëherë mendoj në atë se ky Agjencion përveç tjerash do të merret me organizimin e aktivitetit të zbulimit, kundërzbulimit, kërcënimeve nga brenda dhe jashtë vendit, veprimeve eventuale terroriste, sabotazhet etj. Prandaj konsideroj se një përshpejtim në fillimin e formimit të këtij Agjencionit duhet të ndërmerret në mënyrë që ai ti kryej detyrat e parashtruara sipas ligjit.

Përkundër rezultateve që i përmenda ne si Shoqëri Civile, nuk mund të jemi të kënaqur me të arriturat e deritanishme në sferën e sigurisë, sepse kemi mundur të kemi rezultate më të mëdha. Askush nuk mund të gjejë justifikim për vonësën, siç thash, në formimin e FSK-së dhe të AKI-së. Shkaku është në subjektivizmin tonë, dhe tentativën e lidërshiptit që

institucionet e sigurisë të i identifikojnë me partinë apo personalitetin konkret në pushtet. Kjo vlen edhe për mos-fillimin e riorganizimit substancial të Policisë së Kosovës si imperativ i kohës e jo të krijohet dhe të mbahet një gjendje, ashtu ta quaj, të status-kuosë kur është fjala për nevojën e ngritjes së gatishmërisë vepruese të saj.

Nganjëherë krijohet përshtypja se ne si shoqëri sikur mendojmë që dikush tjetër duhet të krijoj forca dhe mjete të sigurisë (UNMIK-u, KFOR-i e tash EULEX-i) e jo ne vet. Një herë e përgjithmonë duhet të fillojmë të veprojmë si krijues dhe ndërtues të forcave dhe mjeteve të sigurisë së Kosovës duke kontribuar kështu edhe në sigurinë rajonale.

Pra kur është fjala për anën ligjore siç theksova, kemi rezultate, por kur vlerësojmë anën praktike të formësimit të institucioneve të sigurisë, atëherë sikur kemi ngecje mos-angazhim, bile edhe neglizhencë.

Në përmbyllje të këtij vështrimi duhet theksuar edhe disa gjëra:

- 1) Përveç forcave dhe mjeteve të sigurisë për çka u bë fjalë, ne në mënyrë të përshtypshme duhet të fillojmë me Hartimin e Strategjisë së Sigurisë së Kosovës, duke i kyçur në këtë aktivitet të gjitha subjektet e shoqërisë, pra edhe të Shoqërisë civile. Tentativat për të përshkruar strategjinë e ndonjë shteti duhet që në start të ndërpritet sepse kjo nuk na shkon në favor të sukseseve të duhura të cilat na nevojiten në të ardhmen në këtë lëmi.
- 2) Kur është fjala për përgatitjet e tërësishme në planin e sigurisë nacionale, kam përshtypjen se ende nuk është kuptuar sa duhet roli i shoqërisë civile dhe të ekspertëve në këtë proces, bile shoqëria civile edhe ekspertët sikur shikohen me një nënçmim dhe si të imponuar e që mundet të punohet dhe të veprohet pa ndikimin e tyre.
- 3) Zërat të cilat nganjëherë dëgjohen se me vet prezencën e NATO-s në Kosovë shoqëria Kosovare do të anëtarësohet me ndonjë automatizëm në NATO nuk janë me vend. Përkundrazi ne që tani duhet të mendojmë dhe të veprojmë si dhe në çfarë mënyre duhet të i qasemi anëtarësimit tonë në Partneritetin për Paqe dhe në një periudhë të mëvonshme edhe në NATO.

- 4) Zhvillimi i marrëdhënieve të forta rajonale duke u bërë që Republika e Kosovës të jetë partner aktiv në luftimin e kërcënimeve rajonale, duhet të jenë synim i jonë permanent dhe detyrë parësore e shoqërisë sonë.

(Ky botim është prezantim nga autori në konferencën rajonale të mbajtur në Prishtinë me 28.05.2009 me temën "Bashkëpunimi rajonal, themel i sigurisë")

SFIDAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR ANËTARËSIM NË NATO

Një ndër detyrat parësore të Republikës së Kosovës është edhe integrimi në sturkturat euro-atlantike. Kjo do të jetë një ndër sfidat e mëdha me të cilën që tani do të ballafaqohemi ne si shtet. Duke pasur parasysh faktin se Kosova pavarësinë e arriti jashtë suazave të Këshillit të Sigurimit ajo edhe për një periudhë kohore nuk do mund të jetë anëtare e OKB-së. Kjo paraqet një ndër sfidat e ardhshme të Republikës së Kosovës për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, pra edhe në NATO.

S'do mend se, sikur shtetet tjera, ashtu edhe Republika e Kosovës së shpejti do të fillojë të ndërtojë një Forcë të arsyeshme mbrojtëse. Përkundër hezitimeve dhe rezervave të disa vendeve ndaj nevojës së posedimit të Forcës Mbrojtëse, sic e dini, sipas planit të Ahtisaarit ne do të kemi një forcë multietnike të sigurisë dhe një organ mbikqyrës për kontroll demokratik-civil, përkatësisht, një Ministri të Mbrojtjes apo të Forcës së Sigurisë.

Ajo që vlen posacërisht të theksohet është se kjo forcë e pajisur me armatim të lehtë dhe e trajnuar nga një mision i vecantë i NATO-s i stacionuar në Kosovë, i ka përparësitë e veta sepse që në start do të fillojë të sëndërtohet sipas standardeve dhe parametrave të NATO-s.

Duke pasur për bazë faktin e lartëcekur, sikur aty këtu verejmë edhe qëndrime se në këtë mënyrë Republika e Kosovës domosdoshmërisht vetvetiu dhe me një automatizëm do të anëtarësohet në NATO. Mirëpo, kjo nuk do të jetë ashtu. Kuptohet se prezenca e NATO-s që nëntë vite këtu në Kosovë la gjurmë të fuqishme jo vetëm tek ngritja dhe zhvillimi i TMK-së por edhe tek lidhshipi në nevojën e ngritjes dhe arritjes së

standardeve të vetmbrojtjes dhe të aftësive operacionale të Forcës së ardhshme mbrojtëse.

Prandaj, edhe ne duhet t'i qasemi synimit që Republika e Kosovës gradualisht të përgatitet për anëtarësim fillimisht në programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s. Esenca e programit të Partneritetit për Paqe në fakt nënkupton ngritjen graduale të standardeve të Forcës së Sigurisë deri në arritjen e një gatishmërie të lartë operacionale. Në këtë mënyrë ne si shtet:

- do të rrisim stabilitetin
- do të pakësojmë kërcënimet dhe,
- do të ndërtojmë marrëdhënie partneriteti me vendet anëtare të NATO-s pavarësisht nga fakti se, për shkak të limiteve buxhetore, FSK do të jetë numerikisht e vogël.

Zërat të cilët dëgjohen nganjëherë se Forca e jonë mbrojtëse do të vëhet nën komandën e KFOR-it, nuk qëndrojnë. Pasi të arrijmë të anëtarësohemi në Partneritet për Paqe, atëherë do të krijohen kushtet për t'i transferuar disa detyra të cilat i kryjnë komandat dhe njësitet e KFOR-it tek Forca e Sigurisë. Partneriteti për Paqe nuk nënkupton vetëm kaq. Ajo ka të bëjë edhe me aspekte tjera politike sic janë: arritja e qeverisje së mirë, tejkalimin e ndarjeve në mes komuniteteve, zhvillimin e ekonomik, luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, etj.

Marrë në tërësi, ne si shoqëri në tranzicion që tani (pas aprovimit të bazës ligjore për Forcën tonë Mbrojtëse) duhet të bëjmë një program së paku dyvjeçar të mirëfilltë të aktiviteteve për anëtarësim në Partneritet për Paqe të NATO-s duke ia filluar nga:

- planifikimi dhe politika e mbrojtjes
- marrëdhëniet civilo-ushtarake
- arsimimi dhe trajnimi
- mënyrat e menaxhimit të krizave dhe
- planifikimet për emergjencat civile

Nëse arrijmë që këto politika të brendshme ti përmbushim me sukses atëherë ne që në samitin e ardhshëm të NATO-s mund të parashtrijmë kërkesën për anëtarësim në Partneritet për Paqe.

Ne aspektin gjeopolitik, anëtarësimi i Kosovës në Partneritet për Paqe është më se i nevojshëm. Kjo për faktin se që në Samitin e NATO-s në Riga, të mbajtur në nëntorë të vitit 2006, edhe tri shtetet e fundit të Ballkanit Perëndimorë morrën ftesën për anëtarësim: Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina. Prandaj në rajon vetëm Kosova ende mbetet jashtë këtij programi.

Vet prezenca e mëtejme e forcave të NATO-s në vendin tonë, për integrimin tonë të ardhshëm në Aleancën Veriatlantike, është element i rëndësishëm dhe lehtësues. Në këtë drejtim, na presin detyra dhe punë shumë të rëndësishme sikur në të gjitha lëmitë tjera, pra edhe në sferën e mbrojtjes.

Detyrat të cilat në presin kane të bëjnë me anëtarësimin tonë fillimisht në Partneritetin për Paqe të NATO-s për shkak të rëndësisë që ky aktivitet ka për aderim të mëvonshëm në NATO.

Republika e Kosovës si aspiruese për tu bërë anëtare e NATO-s duhet të zhvillojë dhe ndërtojë një sistem politik demokratik që funksionon në të mirë të të gjithë qytetarëve të saj e posacërisht në të mirë të minoriteteve;

- të ketë ekonomi të tregut
- t'i ketë të zgjidhura të gjitha mosmarrëveshjet eventuale me vendet fqinje
- të ketë aftësi për zgjidhje paqësore të mosmarrëveshjeve dhe konflikteve eventuale
- të ketë aftësi mbrojtëse përkatësisht ushtarake të nevojshme për Aleancën Veriatlantike dhe
- funksionimin e marrëdhënieve civilo-ushtarake në përputhje me standardet demokratike

Këto dhe çështje tjera duhet të përfshihen më vonë në Planin e Veprimit për anëtarësim të vendit tonë në NATO i cili do të pason pas një periudhe kohore. Mirëpo, vet pjesmarrja në planin e veprimit për anëtarësim nuk nënkupton domosdoshmërisht edhe anëtarësim. Por ai plan i mundësonë vendit tonë t'i orientojë përgatitjet që ato të jenë sa më efektive karshi kërkesave politike, ekonomike, ligjore, të mbrojtjes dhe sigurisë së tërësishme.

Në aspektin politiko-diplomatik vlen të theksohet se krahas vështirësive për anëtarësim të vendit tonë në organizata tjera, e njëjta gjë mund të

vlejë edhe për në NATO. Edhe pse procesi i deritanishëm i njohjes së Kosovës si shtet i pavarur mund të quhet i sukseshëm sepse një gjë të tillë e bënë shtetet më të fuqishme të botës në krye me SHBA, disa shtete ende hezitojnë dhe në parim kanë kundërshtuar pavarësinë e Kosovës. Fjala është sidomos për ato shtete të cilat e kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës në BE e të cilat janë edhe anëtare të NATO-s. Edhe pse ky është një proces politik dhe tentimi për të bindur këto shtete do të vazhdojë, pengesat e mundshme të tyre për anëtarësim të Kosovës në NATO mund të jenë prezente. Në këtë rast, duhet përmendur kundërshtimet e vazhdueshme të Greqisë, Rumanisë, Spanjës e Sllovakisë që janë anëtare të barabarta të NATO-s. Mirëpo, një angazhim i Republikës së Kosovës në aspektin diplomatik si dhe me ndihmën e shteteve që kanë influencë në NATO shpresojmë se këto vështirësi do të tejkalohen.

Konferencë e organizuar nga Instituti "Universum", Mars 2008, Prishtinë

PROLONGIMI EVENTUAL I FORMIMIT TË FSK – I DËMSHËM

Vizita e kryesuesit të Komiteti Ushtarak të NATO-s, gjeneralit Rej me bashkëpunorë që para dy ditësh ja bëri Kosovës, përkatësisht KFOR-it, ishte e një rëndësie të posaçme. Kuptohet se me atë rast u shqyrtua situata e sigurisë në vend dhe gatishmëria vepruese e KFOR-it. U dhanë garancat për ruajtjen e tërësisë territoriale të Kosovës dhe të moslejimit të eskalimit të situatës së sigurisë. Kjo aq më parë që prej 15 Qershorit do të hyjë në fuqi Kushtetuta e re e Republikës së Kosovës e cila, përvec të tjerash, nënkupton shtrirjen e funksionimit të qeverisjes së vendit nga institucionet vendore në tërë territorin e Kosovës. Lidhur me këtë, vlen të citohet edhe pjesa e deklaratës së gjeneralit Rej kur thotë: "Është esenciale që qytësia të mbretërojë në Kosovë vecanarisht në këtë kohë të rëndësishme. KFOR-i do të mbetet këtu dhe do të jetë i gatshëm të përgjigjet". Sigurisht se në këtë situatë, KFOR-i do të kryjë dhe detyra tjera të rendit nëse për këtë do të shtrohet nevoja. Përfocimet ushtarake të NATO-s të paralajmëruara për fund të muajit maj këtu në Kosovë, duhet përsëritur. Aq më parë që po hyjmë, sic thamë, në një fazë mjaft delikate kur organet shtetërore të Kosovës duhet të i kryejnë detyrat e veta në tërë territorin e saj.

Mirëpo, ajo që bie në sy, sidomos për ata të cilët posacërisht mirren me çështjet të sigurisë, është se kreu i Komitetit Ushtarak të NATO-s, kur është fjala për fillimin e formimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, sikur paralajmëroi një prolongim në formimin e saj, edhe ashtu të redukuar sic ishte paraparë sipas planit të Ahtisaarit. Në këtë rast, ai vecoi rëndësinë e SHPK-së për të operuar, sic tha, me KFOR-in dhe policinë e UNMIK-ut. Kujtoj se, nëse bëhet një analizë e mirëfilltë e kësaj deklarate, sidomos nga aspekti i mosqartësisë së nevojës së formimit të ngutshëm të kësaj force të sigurisë së Kosovës, atëherë ka vend edhe për brengosje. Kjo aq më parë që ne ju kemi qasur përmbushjes së planit të Ahtisaarit dhe se edhe kjo forcë do të duhej të filloj të formohet që nga 15 Qershori e assesi të bëhet ndonjë prolongim në këtë drejtim.

S'do mend se përvec që i kemi aprovuar në Kuvendin e Kosovës, dy ligje bazike që kanë të bëjnë me formimin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë, dhe atij të formimit të FSK-së, bazuar në rrethanat e reja të krijuara me rezistencën e paparë serbe (ruse) kundër pavarësisë së Kosovës, rrethimit në të cilin për një kohë të gjatë do të gjendemi sidomos në raport me Serbinë, situatën politike dhe të sigurisë jo fort të favorshme në Maqedoni, nevojës së reduktimit të forcave të NATO-s në Kosovë në një të ardhme të afërt, etj atëherë domosdoja e formimit të kësaj force sa vjen e shtohet. Kur kësaj i shtohet edhe situata e krijuar me nevojën e shpërbërjes së TMK-së dhe transformimit të një pjese të saj në FSK, problemet e formimit të paraparë të kësaj force duhet të i qasemi me vëmendje dhe vendosshmëri të posacme.

Nëse deri më tani kemi bërë lëshime të njëpasnjëshme në situata të ndryshme që nga viti 1999 e këndeje ndaj faktorit ndërkombëtarë, pas pavarësisë së Kosovës janë krijuar rrethana të reja dhe se lëshime përkatësisht koncesione sikur në rastin e prolongimit eventual të formimit të FSK-së, nuk guxojmë të lejojmë. Lidhur me këtë ndoshta edhe Këshilli i Sigurisë së Kosovës do të duhej të debatonte dhe të nxjerr konkluzionet e duhura për një qasje më të theksuar ndaj nevojës së fillimit të formimit të FSK-së. Kërkesën për t'ju përmbajt afateve të caktuara, duhet me vendosshmëri adresuar që tani. Kjo edhe nga shkakut se për një gjë të tillë lidhësi ynë përgjegjës në e ka para popullit të vet. Edhe atë jo vetëm kur kemi të bëjmë me FSK-në por me çështjet e

tërësishme të sigurisë së vendit sepse pas 15 Qershorit përgjegjësitë në këtë lëmi bien mbi vendorët.

“Koha Ditore”, Maj 2008

THEMELIMI
OPERACIONALIZIMI DHE
FUNKSIONIMI DEMOKRATIK I
FORCËS SË SIGURISË SË
KOSOVËS

K A P I T U L L I I I

1. Hyrje¹

Bazuar në momentin aktual dhe shumë të ndjeshëm në të cilin gjendet Republika e Kosovës pas pavarësisë së saj, çështjet e sigurisë domosdoshmërisht shtohen si prioritare. Në fakt, periudhën passtatusore po e karakterizojnë dhe po e bëjnë mjaftë të ndjeshme r rethanat, kërcënimet dhe rrezikshmëritë e shumta. Një ndër to është edhe situata shumë e vështirë ekonomiko-sociale e një pjese mjaft të madhe të popullatës. Në këtë kontekst duhet theksuar edhe vështiresitë dhe problemet tjera që kanë të bëjnë me korrupsionin, nepotizmin, krimin e organizuar etj.

Pozita qendrore të cilën e zë Republika e Kosovës në hapësirën ballkanike, në aspektin gjeografik e gjeopolitik mund t'i krijojë mundësi trafikeve ilegale dhe aktiviteteve terroriste. Në këtë mënyrë ndërtimi i një ambienti të qetë dhe të sigurtë për të gjithë komunitetet të cilët jetojnë në Kosovë është detyrë shumë e rëndësishme. Poashtu, është tejet e rëndësishme që strukturat përkatësisht institucionet e sigurisë, duhet të jenë plotësisht nën kontrollin demokratik, duke pamundësuar asnjë lloj zbrastësie e cila do të mund të kontribonte në brishtësinë e tyre.

Edhe përkundër nevojës së prezencës së NATO-s në Kosovë dhe mirënjohës, është e qartë se shumica e kosovarëve dëshirojnë të kenë forcën e tyre mbrojtëse. Ekziston besimi se bashkësia ndërkombëtare do të ndihmojë në të gjitha aspektet në ngritjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) sidomos duke dhënë mbështetje në aspektin financiar dhe pajisjeve adekuate të standardizuara. Forca e Sigurisë së Kosovës është dhe duhet te trajtohet si pjesë e identitetit shtetëror pavarësisht se ky institucion mund të jetë numerikisht i reduktuar, i kufizuar dhe kushtëzuar me mundësitë tona ekonomike. Në fakt, forcat e armatosura justifikohen parimisht si domosdoshmëri për siguri të çdo vendi,² pra edhe të vendit tonë.

¹ Ky dokument i politikave është shkruar nga Gjen. Ramadan Qebaja, Prof. Ass Haxhi Ferati, Kosum Kosumi dhe MA Florian Qebaja

² Buzan Berry, *People, States and Fear, An Agenda for International Security Studies in the Post-Cold War Era*, f.272, Londër, Britani e Madhe

FSK në bashkëpunim të ngushtë me policinë e Kosovës, forcat e NATO-s të stacionuara në Kosovë dhe strukturat tjera të sigurisë do t'i kryej detyrat të cilat nuk mund t'i kryej policia dhe strukturat tjera, duke mbrojtur kështu tërësinë territoriale dhe rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. Gjithsesi kontributi i kësaj force do të konsistojë në mbështetjen e përpjekjeve për vendosjen e paqes dhe sigurisë në botë. Detyrë parësore e saj duhet të jetë edhe lufta kundër akteve të mundshme terroriste. Realisht, vetë koncipimi i kësaj force do të duhej të ishte asisoj që me sukses të i kundërvihet rreziqeve të jashtme e të brendshme duke nënkuptuar këtu edhe angazhimin në rast të katastrofave natyrore të cilat mund të i kanosen vendit tonë por edhe ndonjë rajoni të botës.

Roli i FSK-së do të konsiderohet edhe më i madh ngase ajo do të jetë bartëse e integriteteve Euroatlantike. Aspiratat e Republikës së Kosovës për integrim në NATO do të jetësohen me ngritjen e kapaciteteve ndërvepruese të FSK-së konform standardeve të NATO-s. Fillimisht, është thelbësore që Republika e Kosovës t'i iniciojë procedurat për pranim në programin Partneritet për Paqe ngase deri më tani vetëm vendi ynë nuk është pjesë e këtij programi të rëndësishëm. Partneriteti për Paqe do ta forconte edhe më të j bashkëpunimin ndërinstitucional në mes FSK-së dhe NATO-s.

Bazuar në rrethanat e reja, ne mendojmë se shoqëria civile do të duhej të inkorporohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në ngritjen e kësaj force, duke i eliminuar stereotipat e vjetra të cilat çështjet ushtarake por e dhe ato të sigurisë së tërësishme i kanë trajtuar si kompetencë krejtësisht të rezervuar vetëm të qeveritarëve. Ky dokument i pari i këtij lloji, por jo edhe i përkryer nga qendra e jonë, ka për qëllim të sensibilizojë dhe krijojë mundësinë e shprehjes së mendimeve të ndryshme edhe nga këndvështrimi i shoqërisë civile duke begatuar këtë sferë tejet të rëndësishme.

QKSS, në formësimin e këtij dokumenti³ ka përdorur metoda hulumtuese gjithëpërfshirëse. Këtu hynë përvoja e eksperteve të qendrës sonë, përdorimi i legjislacionit aktual ne fuqi, referencat më

³ Edhe pse është bërë rishikimi i sistemit të sigurisë në vitin 2005/2006, nevoja dhe rrethanat e reja të krijuara pas pavarësisë së Kosovës, kërkojnë një rishikim të përmirësuar dhe më të avansuar.

bashkëkohore për funksionimin demokratik të sektorit të sigurisë nga institutet dhe qendrat ndërkombëtare, në veçanti Qendrës së Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF).

Dokumenti në vazhdim parasheh në mënyrë gjithëpërfshirëse aspekte të themelimit, operacionalizimit e funksionimit demokratik të FSK-së. Fillimisht, për qëllime të këtij dokumenti të politikave është bërë një vlerësim sado i shkurtër por shumë domethënës lidhur me dimensionin teorik të kontrollit demokratik të institucioneve të sigurisë. Kjo për lexuesin është shumë e rëndësishme ngase paraqitet domethënia e themelimit të institucioneve të sigurisë në bazë të parimeve të mbikëqyrjes demokratike.

Në vazhdim, do të vlerësohet procesi i shpërbërjes së TMK-së dhe domosdoshmëria e inkorporimit të prestarëve të saj në FSK. Pastaj, funksionimi i aspektit politik të FSK-së do të zë vend të rëndësishëm. Kjo përfshin rolin e Ministrisë së FSK-së si dhe rolin e NATO-s në këtë drejtim. Në mënyrë narrative ceket edhe struktura e Ministrisë dhe detyrat. Pjesa tjetër parasheh operacionalizimin dhe funksionimi demokratik të FSK-së. Këtu hyjnë strukturimi, kriteret e selektimit, pajisjet e infrastruktura, armatimi dhe përbërja rezervë e FSK-së. Kjo pjesë posaçërisht do të vlerësojë edhe aspektin buxhetor të FSK-së, bashkëpunimin ndërkombëtarë dhe përgjegjësitë shtesë. Rëndësi të veçantë i është dhënë mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave të njeriut në FSK, integritet të minoriteteve dhe barazisë gjinore. Një pjesë e posaçme do t'i trajtojë këto sfera. Dhe së fundi, konkluzionet lidhur me këtë dokument të politikave.

2. Kontrolli Demokratik i Institucioneve të Sigurisë⁴

Kjo pjesë do të prek shumë shkurt dimensionin teorik të funksionimit demokratik të institucioneve të sigurisë që duhet të merren në konsideratë gjatë dhe pas themelimit të FSK-së.

⁴ Për qëllimin e këtij dokumenti vlen të theksohet se institucionet e sigurisë nuk nënkuptojnë vetëm ushtrinë. Ato përfshijnë të gjitha institucione të sigurisë publike apo jo-publike që kanë kapacitet të përdorin forcën siç janë: policia, xhandarmëria, rojet kufitare etj.

Pas përfundimit të luftës së ftohtë u shfaq domosdoshmëria për kontroll demokratik të Forcave të Armatosura (FA) kështu që reformimi dhe ndërtimi i sektorit të sigurisë është duke ndodhur në bazë të metodave bashkëkohore. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij dokumenti të politikave, është një mundësi imanente për vlerësimin e aspektit teorik më të ri për funksionimin demokratik të FA. Pyetja mund të shtrohet: Si mund ta përkufizojmë Kontrollin Demokratik të FA?

Realisht, përgjigjja më e qartë del nga DCAF ku kontrolli demokratik nënkupton normat dhe standardet që qeverisin marrëdhëniet ndërmjet FA dhe shoqërisë që kësajohi FA janë nën udhëheqjen e autoriteteve të zgjedhura në mënyrë demokratike dhe që i nënshtrohen mbikqyrjes së mediave dhe shoqërisë civile.⁵

Përkufizimi tjetër është i ngjajshëm me të parin mirëpo më i ngushtë. “Kontrolli civil i forcave të armatosura është një doktrinë në ushtri dhe shkenca politike që paraqet një përgjegjësi të skajshme për vendim-marrjen strategjike të vendit që është në dorë të udhëheqësisë politike civile se sa të oficerëve profesional ushtarak”.⁶ Për ta thjeshtëzuar, FA i nënshtrohen mbikqyrjes civile dhe akterëve të tjerë të shoqërisë.

Ekzistojnë shumë aspekte që në praktikë përkufizojnë shfaqjen e kontrollit demokratik të FA. Megjithatë, për këtë dokument të politikave ne vlerësuam që është e domosdoshme të përmenden posaçërisht së paku pesë dimensione të kontrollit demokratik bashkëkohorë të FA:

- E para, udhëheqësia civile e Ministrisë së Mbrojtjes si dhe kontrolli demokratik nga Qeveria luan rol të rëndësishëm. Shumica e shteteve demokratike parashohin në dokumentët e tyre legal se FA i nënshtrohen kontrollit të Qeverisë
- E dyta, përmirësimet e marrëdhënive ushtarako-civile shpjen deri te dominimi i mbikqyrjes civile dhe kontrollit mbi FA.⁷ Duke i zhvilluar marrëdhëniet ushtarako-civile, FA i nënshtrohen kontrollit demokratik. P.sh. aktivitetet e

⁵ DCAF, *Kontrolli Demokratik i Forcave të Armatosura*, f.1, Maj 2008. Gjenevë

⁶ Shih në detaje “*Soldiers and the State – The theory and politics of civil-military relationships*”, Samuel Huntington apo http://en.wikipedia.org/wiki/Civilian_control_of_the_military

⁷ Aty, f.2

përbashkëta që ndërmerrren ndërmjet FA dhe civilëve janë konsideruar si shumë të frytshme dhe janë shtyllë e fortë mbikqyrjes civile

- E treta, ndërtimi i kapaciteteve për komisionet parlamentare për siguri dhe mbrojtje si dhe zgjerimi i kompetencave i këtyrë komisioneve ngritën nivelin e kontrollit demokratik të FA.⁸
- E katërta, mbulimi nga mediat dhe kritikantët lidhur me rolin e FA përbënë një pjesë të rëndësishme të kontrollit demokratik.⁹ Poashtu, roli i shoqërisë civile (OJQ-të, “Think Tanks”) duhet veçanërisht të potencohet
- Dhe së fundi, e pesta ka të bëjë me ndikimin e organizatave rajonale (BE, OSBE, NATO) në reformimin dhe ndërtimin e sektorit të sigurisë. Veçanërisht në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimorë, ndikimi i organizatave ndërkombëtare është konsideruar si një mbikqyrje e jashtme e institucioneve të sigurisë.¹⁰

Funksionimi demokratik i FSK-së është shprehimisht i paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin mbi FSK-në.¹¹ Infrastruktura e tanishme ligjore lejon përfshirjen e parimeve të lartëcekura që janë thelbësore për arritjen e objektivave të parapara për FSK-në. Në këtë mënyrë, këto parime duhet të merren në konsideratë gjatë themelimit të institucioneve të reja të sigurisë në Kosovë.

⁸ Dhe kjo është një ndër shtyllat kryesore të mbikqyrjes demokratike

⁹ Rasti më i ri është ai i kritikave të mediave lidhur me mosefektivitetin e ushtrisë së Shqipërisë për parandalimin e eksploziveve në Gerdec, në afërsi të kryeqytetit Tiranë

¹⁰ Shkurtimisht, vlen të theksohet se reformimi i sektorit të sigurisë bëhet nën të ashtuquajturën politikat e kushtëzimeve të BE-së dhe Këshillit të Evropës. Po ashtu, reformimi i sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë të ndërmarr nëpërmjet programit Partneritet për Paqe të NATO-s që i ka prerogativat e politikave kushtëzuese

¹¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli XI, Sektori i Sigurisë, Neni. 125/4 “Kontrolli civil dhe demokratik mbi institucionet e sigurisë duhet të garantohet”. Ligji mbi FSK-në, Parimet e Përgjithshme, “Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ushrojë kontrol demokratik, civil e transparent mbi FSK-në dhe poashtu duhet t’i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës”.

3. Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) – Procesi i shpërbërjes me dinjitet

Për qëllime të këtij dokumenti, vlen të theksohet se TMK-ja është pajtuar tërësisht me mandatin e vet që e kishte, përmbushja e misionit në tërësi, operimit në mënyrë të përgjegjshme, disiplinore e profesionale dhe financimit në mënyrë transparente.¹² Në këtë mënyrë, TMK-ja ka bërë shumë në shërbim të gjithë qytetarëve dhe në të gjitha rastet kur është paraqitur nevoja ka vepruar edhe jashtë mandatit të saj kësajsoj i konsideruar si një element kyç i shoqërisë dhe politikës kosovare.

Edhe përkundër fakteve të lartcekura, nga ana e bashkësisë ndërkombëtare nuk ka pasur gatishmëri që TMK-ja në mënyrë automatike të transferohet ushtri. Prandaj edhe me Pakon e Ahtisarit është paraparë të ndodhë shpërbërja e saj në mënyrë të dinjitetshme.¹³

Marrë për bazë të gjitha këto, shpërbërja e TMK-së duhet të bëhet me kujdes dhe me dinjitet dhe nën përkujdesjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kjo do të jetë një sfidë e madhe edhe për Qeverinë por edhe bashkësinë ndërkombëtare e që duhet të ndodhë brenda një viti, prej momentit të hyrjes së Kushtetutës së Kosovës në fuqi.

Mënyra më e mirë, e lehtë dhe më e përshtatshme do të ishte që në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të themelohej një zyre e cila do të merrej drejtë për së drejti me pjesëtarët e TMK-së të cilët nuk i kalojnë kriteret e selektimit për kalim në FSK. Për këtë duhet domosdoshmërisht sa më shpejt të përgatitet korniza ligjore për përkujdesjen dhe riintegrimin e këtyre pjesëtarëve. Do të krijoheshin mekanizmat që reflektojnë kontributin e tyre të dhënë gjatë këtyre viteve sa kanë shërbyer me dinjitet në TMK.

Duke pasur parasysh që pjesëtarët e tashëm të TMK-së për momentin kanë një punë të garantuar në TMK, pjesa e cila nuk do të mund ti kalojë kriteret e selektimit do mbetet pa vend pune. Prandaj shteti i Kosovës duhet të gjejë forma dhe mundësi t'i trajtojë këta pjesëtarë në mënyrën më të duhur. Në këtë mënyrë, Qeveria e Kosovës përveç rregullativës ligjore, së bashku me NATO-n duhet të bënë përgatitjen e programeve

¹² Në veçanti vlen të theksohet përmbushja e sukseshme e standardit 8 dhe lëvdatat që morri TMK-ja nga faktori vendorë e ndërkombëtarë

¹³ Shih, Propozimi i Pakos së Ahtisaarit

për risistemimin dhe riintegrimin e pjesëtarëve të TMK-së në pozita dhe vende adekuate.¹⁴ Ajo, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare duhet të gjejë forma dhe mundësi për integrimin e tyre në jetën civile.¹⁵

4. Krijimi i Ministrisë dhe ngritja e FSK-së

4.1 Roli i Qeverisë së Kosovës

Ashtu si edhe Qeveritë e vendeve tjera demokrate, Kushtetuta e Kosovës parasheh që Qeveria e Kosovës të ketë kontroll demokratik mbi FSK-në.¹⁶ Në këtë mënyrë, vlen të potencohet miratimi i Ligjit për Ministrinë e FSK-në ku duhet të udhëhiqet nga autoriteti civil. Andaj, barra më e madhe në tërë këtë drejtim do të bie mbi institucionet e Kosovës të cilat duhet që këtë tërë këtë proces ta fillojnë me themelimin e Ministrisë së FSK-së. Në këtë fazë do të duhej të emërohej Ministri i FSK-së dhe plotësimi e Ministrisë me stafin udhëheqës dhe atij komandues, e të cilët do të ishin bartësit kryesor të kësaj faze të tranzicionit, jo edhe aq të lehtë. Ndërmarrja e hapave të shpejtë e të mirëfilltë për themelimin e Ministrisë është e rëndësishme duke llogaritur në atë se establishmenti politik e determinon edhe operacionalizimin praktik të FSK-së.

4.2 Roli i NATO-s

Roli i Aleancës Veriatlantike do të jetë shumë i rëndësishëm dhe vendimtar së bashku me Qeverinë e Kosovës. Më konkretisht, roli i NATO-s do të jetë gjithëpërfshirës që nga momenti i formimit të

¹⁴ Ose masat e pensionimit të parakohshëm për ata pjesëtarë që i plotësojnë kushtet për këtë pako.

¹⁵ Ka pasur dhe ka propozime të ndryshme që kjo apo ajo organizatë do të merrej me shqyrtimin e nevojave të këtyre pjesëtarëve siç është IOM-i, UNDP-ja apo dikush tjetër por nga e kaluara e afërt ekziston një përvojë jo edhe aq e mirë në këtë aspekt edhe përkundër premtimeve dhe mjeteve që janë ndarë rezultatet kanë qenë të disfavorshme për ata pjesëtarë që kanë pasur nevojë për përkrahje, prandaj mendohet që siç edhe u cek më lartë, institucionet kosovare të jenë bartëse së bashku me NATO-n por edhe organizata joqeveritare të angazhuara në këtë sferë.

¹⁶ Nuk ka vetëm qeveria rol mbikqyrës mbi FSK-në. Duhet përmendur faktin se Presidenti i Republikës së Kosovës është Komandant Suprem i Forcave të Armatosura. Poashtu edhe Kuvendi i Kosovës ka rol thelbësorë sidomos në aspektin e mbikqyrjes parlamentare demokratike nëpërmjet komisionit përkatës.

Ministrisë së FSK-së dhe themelimit të FSK-së. NATO duhet të sigurohet që kapacitet mbrojtëse të Kosovës t'i adaptohen ndërveprueshmërisë së saj dhe të kontribuojnë në sigurinë rajonale.¹⁷ Sipas vlerësimeve, NATO do të hartoj dokumentin/librin e bardhë kurse autoritetet kosovare do të jepnin sugjerime.¹⁸ Mirëpo, mund të shtrohet pyetja se cilat janë mundësitë alternative nëse nuk do të kishte ndonjë marrëveshje konkrete nga ana e Aleancës për krijimin e Ministrisë dhe ngritjen e FSK-së duke pasur parasysh që jo të gjitha shtetet anëtare të NATO-s e kanë njohur shtetin e Kosovës?¹⁹

Mënyra më e mirë do të ishte që shtetet që deri më tani e kanë njohur Kosovën veç e veç të jenë bartëse të këtyre proceseve e sidomos në aspektin e trajnimit në fusha të ndryshme por edhe furnizimit të FSK-së me pajisje adekuate dhe të standardizuara të NATO-s. Secila nga to do të ishte mirë të jetë përgjegjëse në ndarjen e aspekteve për ngritjen e FSK-së në këtë periudhë të tranzicionit.

Pavarësisht prej mbështetjes së anëtarëve të NATO-s dhe rëndësisë që ka ky proces, barra më e madhe duhet të bie mbi qeverinë. Ajo duhet të jetë shumë më aktive e mos të merret ky proces si i kryer nga Aleanca apo shtetet veç e veç të NATO-s.

4.3. Struktura e Ministrisë së FSK-së (MFSK)

Pas hyrjes së Kushtetutës së Kosovës në fuqi Qeveria e Kosovës në grupin e projekteve me prioritet duhet ta fusë edhe projektin e themelimit të Ministrisë së FSK-së e cila mundë të përfitojë mjaftë nga përvoja e formimit të ministrive ekzistuese. Mirëpo, në krahasim me ministrinë tjera kjo do duhej t'i kishte specifikat e veta. Me vendosshmëri duhet të fillon organizimi i Ministrisë dhe plotësimi i saj me personel në bazë të strukturës që do parashihet apo ndoshta që

¹⁷ Grupi Ndërkombëtarë i Krizave, "Ushtri për Kosovën", nr.174, faqe 32, Bruksel, Prishtinë, 2006

¹⁸ Qehaja Florian, Intervistë me Jamie Shea, Drejtor për planifikim të politikave në NATO, Qershor 2007, Bruksel

¹⁹ Në momentin e shkrimit të këtij dokumenti pavarësinë e Kosovës nuk e kanë pranuar këto shtetet anëtare të NATO-s: Spanja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Portugalia.

është duke u paraparë në mes Qeverisë së Kosovës dhe NATO-s. Krijimi i Ministrisë së FSK-së është shumë i rëndësishëm ngase kontrollohet dhe monitorohet FSK në mënyrë demokratike. Për t'i ndërtuar themelet e këtij institucioni të mbikëqyrjes është shumë e nevojshme ngritja sa më e shpejt e kapaciteteve në mënyrë që ato të jenë në gjendje të kryejnë detyrat, përgjegjësitë dhe rolin që ka në bazë të Ligjit.²⁰

Në këtë fazë një lehtësim i madh për Qeverinë e Kosovës është paraardhësi i Ministrisë – Zyra e Koordinatorit të TMK-së në një mënyrë, ngjajshëm me paraardhësin e FSK-së që është TMK. Në një afat kohor të kufizuar duhet të kalohet shumica e kompetencave nga ZK TMK tek Ministria e FSK-s. Prandaj në këtë fazë të formimit të Ministrisë do të ishte shumë me rëndësi plotësimi dhe ruajtja e aftësive dhe kapaciteteve të fituara me vite e sidomos përforcimit të mëtutjeshëm në faza.

Siç u cek edhe më lartë, pasi që demokracia presupozon epërsinë e civilëve në komandim, edhe në rastin e krijimit të kësaj Ministrie, Qeveria e Kosovës duhet të ketë kujdes që të plotësohet ky standard. Por patjetër se duhet të ketë një ndërveprim ndërmjet civilëve dhe ushtarakëve në ngritjen dhe funksionalizimin e saj e sidomos është shumë i rëndësishëm fakti që e tëra kjo duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë dhe me ndihmën e NATO-s.

Struktura e Ministrisë së FSK-së do duhej të ishte një strukturë e cila i plotëson nevojat e përgjithshme të një institucioni funksional dhe në shërbim të FSK-së. Ajo duhet të përmbajë elemente nga të cilat lirohet FSK siç janë: politikat dhe planet, personeli, bashkëpunimin ndërkombëtar, resurset (buxhetin, prokurimin dhe infrastrukturën), bashkëpunimin civilo – ushtarak, intelegjencën, planifikimin e operacioneve dhe trajnimit, zhvillimin e doktrinave dhe koncepteve, politikat e planifikimit logjistik por edhe të sistemit të IT dhe komunikimit.

Gjithashtu, në kudër të Ministrisë së FSK-së do të duhej të ishin edhe inspektorati i përgjithshëm i FSK-së, auditivi i brendshëm, zyra

²⁰ Shih Ligjin mbi Ministrinë e FSK-së

ligjore, marrdhëniet me publikun, të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore.²¹

5. Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK)

Sipas Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit, FSK-ja do të jetë një forcë e sigurisë me një mision më tepër civil e më vonë me përgjegjësi të shtuara në aspektin e sigurisë. Një forcë e vogël në numër të mjaftueshëm për nevojat e vendit, profesionale, operacionale, multietnike, në shërbim të gjithë qytetarëve dhe financiarisht e përbalueshme por edhe e përkrahur nga vendet e NATO –s (FSK-ja do të përbëhet prej jo më shumë se 2500 pjesëtarë aktiv dhe 800 pjesëtarë rezervë).²²

FSK duhet të jetë një forcë moderne e sigurisë, e arsimuar dhe e motivuar, e aftësuar dhe e trajnuar profesionalisht për përmbushjen e misionit por edhe në përmbushjen e përgjegjësi shtesë, sidomos në misionet paqeruajtëse. FSK-ja do të jetë një faktor shumë i rëndësishëm për sigurinë e vendit por edhe ate rajonale. Tani pasi ekziston kornizat ligjore çdo gjë është e qartë për Qeverinë dhe ajo duhet të ndërmerr hapat e mëturjeshëm në fillimin e realizimit të këtyre projekteve madhore në mënyrë që mos të kemi vonesa sipas planeve të parapara kohore.

Projekti i fillimit të ngritjes së FSK-se do të bëhet në faza në bazë të prioriteteve dhe do të duhet të fillonte me hyrjen e Kushtetutës së Kosovës në fuqi. Do të shkonte paralelisht ngritja e FSK-së dhe shuarja e TMK-së në një periudhë jo më shumë se një vit. Ngritja e FSK-së të bëhet sipas standardeve më të larta të NATO-s në një periudhë prej 3 deri në 5 vite ku Kosova pas kësaj periudhe do të ketë një forcë shumë profesionale dhe me përgjegjësi shtesë në aspektin e sigurisë.

Kjo fazë e tranzicionit për Kosovën do të jetë edhe më e favorshme duke marrë parasysh se në vendin tonë detyrat e sigurisë është duke i realizuar edhe janë në kompetencë të plotë të KFOR-it. Vet prania e ushtrive të vendeve të cilat janë pjesë e NATO-s janë edhe një element i fortë për ngritjen e FSK-së me sukses gjatë këtyre fazave. Në të gjitha

²¹ Edhe pse do të duhet të bëhet një vlerësim më i detajuar për rolin e secilit segment të Ministrisë, në këtë dokument kemi parë si të arsyeshme që së paku vetëm t'i cekim

²² Shih Ligjin mbi FSK-në

fazat e realizimit të këtij procesi NATO dhe prania ndërkombëtare civile do të jenë direkt të lidhur dhe duke dhënë kontributin e tyre për mbështetje të FSK-së në këtë proces shumë të rëndësishëm.

5.1 Struktura

Struktura e FSK-së të jetë një strukturë e cila përmban në vete të gjitha elementet e një force funksionale, të ndërveprueshme me strukturat tjera të sigurisë me të cilat do të bashkëveprojnë në operacionet e ndryshme. Numri i komandave dhe njësive tjera vartëse do të përcaktohej në bazë të misionit që ka FSK.

Struktura e paraparë e personelit në FSK të jep një mundësi shumë të kufizuar të krijimit të kushteve më efektive për drejtimin, komandimin dhe kontrollin dhe në përcaktimin e numrit të komandave dhe numrit të pjesëtarëve në njësi për realizimin e misionit me përpikëshmëri. Prandaj, duhet të shkohet nga ajo që në FSK të kemi shumë më shumë ushtar në numër kurse personel të kufizuar me grada (oficer dhe nënoficer).

Mënyra më e mirë do të ishte që FSK të ndërtohet sipas standardeve të NATO-s me komanda dhe shtabe të vogla dhe të kufizuara në numër me oficer komandues e shtabor me grada të larta.

Sic është cekur edhe më lartë, shumë aspekte të planifikimit do të duhej të kalonin nën kompetencat e Ministrisë së FSK-së dhe kështu ShP i FSK-së do të ishte më efikas në komandim dhe kontroll të komandave e njësive në aspektin operacional.

Në fazën fillestare përqendrimi më i madh do duhej të ishte në mbështetjen, ruajtjen e kapaciteteve dhe ngritjen e aftësive operacionale të fituara për kohë të gjatë në TMK e sidomos forcimit të mëtutjeshëm me personel dhe pajisje adekuate të njësisë për mbrojtje civile, xhenios, logjistikës dhe trajnimit. Në fazën tjetër, mbështetje e plotë duhet t'i ipet ngritjes së Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSh) dhe Njësisë Ajrore. Kjo për faktin se ka kosto të lartë dhe kërkon kohë.

5.2 Kriteret e selektimit për pjesëtarët e FSK-së

Duhet të vendosen strukturat dhe proceset e nevojshme për të zbatuar kushtet e shërbimit në FSK në bazë të Ligjit për FSK-n dhe në bazë të standardeve të përcaktuara me NATO-n. Përparësi do të kishin pjesëtarët e TMK-së të cilët do të kalonin këto kritere sepse me vite të tëra janë trajnuar dhe aftësuar për këtë, duhet t'i ruajmë shkathtësitë e tyre të fituara gjatë viteve të kaluara në TMK. Por kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që FSK-ja nuk do të jetë e hapur për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim etnie a feje.

Kjo fazë e rekrutimit të pjesëtarëve të FSK-së do duhej të fillonte menjëherë në bashkëpunim me praninë ndërkombëtare ushtarake të NATO-s, fillimisht me përzgjedhjen e stafit të lartë udhëheqës dhe komandues.

Fillimisht duhet të realizohet testimi i të gjithë efektivit të TMK-së për kalim në FSK sipas planit dhe kriterëve të përcaktuara e të cilat do të ishin të njëjta për të gjithë pa dallime dhe duke shfrytëzuar metodat më të avancuara dhe kriteret e përafërta me ato të ushtrive të NATO-s. Vlerësimi do të bëhej nga ekspertët e përbashkët, i cili do të bazohej në kriteret e përcaktuara të selektimit për kalim apo pranim në FSK. Ngecje në këtë drejtim nuk do të duhej të ketë.

Rekrutimi i pjesëtarëve të rinj të cilët vullnetarisht dëshirojnë t'i bashkëngjiten FSK-së do të realizohet sipas planit, ku përveç kriterëve të selektimit do të përgatitet edhe plan-programi i trajnimit individual bazik dhe pas përfundimit me sukses të këtij trajnimi t'u ofrohet kontratë ushtarit profesionist në FSK.

5.3 Trajnimi dhe ngritja e aftësive operacionale

Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare disa aftësi operacionale gradualisht do të barteshin nga TMK-ja tek FSK-ja dhe përfundimisht pas një viti të gjitha këto aftësi do të kalojnë tek FSK-ja. Por pavarësisht prej shpërbërjes së TMK-së gjatë kësaj periudhe një pjesë e TMK-së do të duhej të mbetej edhe më tutje për emergjencat civile nën autoritetin e NATO-s dhe Qeverisë së Kosovës deri në kalimin e plotë të aftësive operacionale në FSK dhe marrja e përgjegjësisë shtesë në aspektet e sigurisë.

Faza e trajnimit do të duhej të fillonte me ngritjen e parë të njësisve sipas prioriteteve të cekura më lartë, duke filluar me trajnimet bazike e deri te ato të nivelit më të lartë. Të përgatiten planet për ngritjen e nivelit të shkathtësive themelore e deri te ato më të larta duke marrë për bazë Procedurat Standarde Operative (PSO) të NATO-s, me qëllim të bërjes së FSK-së sa më shpejt operacionale, funksionale dhe të gatshme për detyra dhe përgjegjësi shtesë nga aspektet e sigurisë me qëllim të integritetit të saj në strukturat Euro Atlantike

Komanda e tanishme e Trajnimit dhe Doktrinës (KTD) me pak ndryshime do të duhej të jetë bartëse e të gjitha aspekteve të trajnimit dhe edukimit për pjesëtarët e FSK-së. Kushtet, profesionalizimi, përvoja dhe aftësitë e arritura deri më tani por edhe bashkëpunimi me KFOR-in, IOM-in dhe shumë shtete që e kanë ndihmuar këtë institucion janë shembull dhe për këtë duhet edhe më tutje të vazhdohet trajnimi dhe edukimi i pjesëtarëve të FSK-së në KTD.

Në arritjen e aftësive nuk do të duhej të ngutemi dhe të ndërmerren hapa të gabuar sepse në FSK është më se e nevojshme të arrijmë aftësi sipas standardeve më të larta profesionale. Kjo aq më parë që deri në arritjen e këtij niveli të dëshiruar në këtë fazë të tranzicionit është KFOR-i ai i cili do të mbuloj këtë boshllëk të sigurisë edhe pse sipas vlerësimeve tona zvogëlimi gradual i tij do të pritët të ndodhë së shpejti.

5.4 Përbërja rezervë

Varianti më i mirë do të ishte që pjesëtarët rezervë të caktohen dhe koncentrohen nga komandat rajonale të FSK-së. Këto komanda do të merreshin me çështjet e rezervës aktive, duke filluar nga personeli, komanda dhe kontrolli, strukturimi, stërvitjet, gatishmëria operacionale, aktivizimi i tyre etj.

Rezerva aktive do ishte në përkrahje të plotësimit të njësisë dhe komandave në rastet e plotësimit të njësisve me personel ne aspektet e mbrojtjes civile dhe çështjet tjera operacionale të tjera. Për arritjen dhe mbajtjen e aftësive operacionale do të duhej që së paku dy herë brenda vitit rezervistët të ftohen në ushtrime të parapara sipas planit.

5.5 Infrastruktura dhe pajisjet

Do të duhej të përgatitej një plan i detajizuar në bazë të vlerësimit dhe me qëllim të zhvillimit të procesit për vendosjen e njësive të reja të FSK-së, zhvillimit të kushteve adekuate për fillimin e realizimit të detyrave sipas misioneve që do të kenë. Fillimisht FSK-ja do të shfrytëzonte infrastrukturën dhe pajisjet me të cilat disponon TMK-ja dhe kështu do t'i ruante aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme në përmbushjen e misionit dhe detyrave të caktuara.

Poashtu, duhet të përcaktohen prioritetet e vendosjes së njësive në lokacionet ekzistuese apo të reja duke filluar nga ShP i FSK-së, KTD, Logjistika, BRSh, BMC e deri te njësitë tjera mbështetëse të operacioneve. Po ashtu edhe tri vendlokacionet apo tri qendrat kryesore të komandave rajonale e që do të jenë përgjegjëse për stërvitje dhe aktivizimin e pjesëtarëve rezervë të FSK-se kur e kërkon nevoja.

FSK-ja do të ketë një kufizim të pajisjes me armatim i cili kryesisht do të jetë armatim i lehtë, gjithmonë duke interpretuar dispozitat e ligjit në fuqi. Pritet që kontributin më të madh në pajimin me armatim do ta dhënë shtetet anëtare të NATO-s. Por, megjithatë do të ketë nevojë për një standardizim në mënyrë që të bëhet zgjidhja më e mirë dhe më e përshtatshme për FSK-n.²³

Do të ketë nevojë për një bashkëpunim të plotë me ushtritë e vendeve të NATO-s gjatë kryerjes së stërvitjeve, përdorimit dhe mirëmbajtjes së armatimit.

5.6 Buxheti

Politikat e ndryshimeve që do të pasojnë do të kërkojnë që të ndryshojë edhe politika buxhetore e vendit për rritjen e buxhetit në çështjet e sigurisë por gjithnjë duke u bazuar në limetet që janë të përcaktuara nga ana bashkësisë ndërkombëtare. Kuptohet se edhe vështësitë ekonomike të vendit dhe buxheti i limituar do ta kufizojnë në masë të madhe edhe

²³ Vlen të citohet deklarata e Presidentit Amerikan Xhorxh Bush për furnizim me armatim Republikën e Kosovës. Shih <http://lajme.dervina.com/archive/6003-2549:677/Presidenti-Bush-autorizon-dergimin-e-armeve-ne-Kosove.htm>

ndarjen e buxhetit për FSK-n dhe kështu do të vështirësohet edhe arritja e procesit të filluar.

Duhet të shfrytëzohet buxheti aktual i propozuar për TMK-n i cili në bazë të buxhetit të përgjithshëm të vendit është diku rreth 2.4%.²⁴ Buxheti në të ardhmen, me fillimin e implementimit të këtij procesi në bazë të vlerësimeve të bëra do të duhej të ishte rreth 50 mil. Euro kurse në fazat e më vonshme duhet t'i nënshtrohet rivlerësimeve të përgjithshme. Mirëpo duhet të mirret parasysh fakti se buxheti duhet të jetë rreth 2% të GDP i cili përkufizim është i caktuar nga institucionet e sigurisë ndërkombëtare.²⁵

Fillimisht, buxheti do të përdorej më së shumti në ngritjen e FSK-së, sigurimin e funksionimit të aktiviteteve të FSK-së, ngritjen e aftësive operacionale të komandave dhe njësisve me prioritet, përmirësimin e infrastrukturës, modernizimit dhe pajisjeve. Pritet që nga vendet e NATO-s të cilat kanë shprehur gatishmëri për krijimin e Ministrisë dhe ngritjen e FSK-së do të ketë ndihma të konsiderueshme në trajnim, pajisje e armatim dhe kështu në masë të madhe do të plotësoheshin nevojat për këtë proces.

5.7 Përgjegjësitë shtesë

Përveç përgjegjësisve që i ka bazuar në ligjin në fuqi, FSK mund të përkrahë KFOR-in, policinë dhe mekanizmat tjerë të sigurisë në kontrollimin e trazirave si dhe zbatimin jashtë vendit në koordinim me NATO-n dhe organizatat tjera ndërkombëtare. Në favor të këtyre angazhimeve shkon edhe paragrafi 5.4 i nenit 5 ku thuhet se FSK-ja do të dizajnohet dhe përgatitet për përmbushjen e funksioneve të tjera të sigurisë, të cilat janë të papërshtatshme për policinë apo organizatat tjera të zbatimit të ligjit. Marrja e përgjegjësisve shtesë do të varet (përcaktohet dhe autorizohet) nga prezenca e faktorit civil e ushtarak ndërkombëtar në Kosovë pas vlerësimit që do të bëhet nga ana e tyre lidhur me gatishmërinë dhe aftësitë operacionale të FSK-së për detyra shtesë.

²⁴ Buxheti i tanishëm i TMK-së është rreth 18 milion euro

²⁵ Për detaje lidhur me përqindjen e GDP-së së shteteve të NATO-s në sferën e mborjtjes, shih www.nato.int

5.8 Zbarkimi i trupave të FSK-së jashtë vendit

Hapësira territoriale e veprimit të FSK-së është brenda territorit të Republikës së Kosovës. Megjithatë, një ndër mandatet fillestare të FSK-së konsistojnë në pjesëmarrje në misione ndërkombëtare paqëruajtëse. “Anëtarët e FSK-së janë të autorizuar të zbarkojnë jashtë kur t’i ipet mandati nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe me pajtimin e vendit pritës, apo me marrjen e ftesës nga organizatat ndërkombëtare ...”²⁶

Me gjithë faktin se aktualisht Kuvendi i Republikës së Kosovës mund t’i jap mandatin FSK-së për paqëruajtje jashtë vendit, një Ligj i veçantë mbi zbarkimin e trupave të FSK-së duhet të hartohet dhe miratohet. Ky ligj do ta specifikonte kontributin e mundshëm të Republikës së Kosovës për vendosjen e paqës dhe sigurisë në botë dhe garantimin e sigurisë së njeriut. Trupat e FSK-së të zbarkuara në hapësirat e konflikteve mund t’i përgjigjen çështjeve të menaxhimit të katastrofave, luftimit të terrorizmit ndërkombëtarë dhe parandalimit të konflikteve ndëretnike e ndërreligjioze. Në momentin që trupat e FSK-së ftohen nga organizatat ndërkombëtare siç janë Kombet e Bashkuara (KB), NATO dhe BE, ato duhet të jenë në gjendje që t’i përgjigjen ftesës shpejtë në momentin që e marrin mandatin nga Kuvendi.

5.9 Bashkëpunimi ndërkombëtarë i FSK-së

Atashetë e Sigurisë (Mbrojtjes)

Ligji mbi FSK-në parasheh që Ministri i FSK-së duhet të veprojë si përfaqësues në çështjet që lidhen me bashkëpunimin ndërmjet FSK dhe shteteve tjera megjithatë ai ose ajo mund ta delegojnë këtë funksion.²⁷ Mënyra më e mirë për delegimin e detyrave për bashkëpunim ndërkombëtarë janë atashetë. Diplomacia kosovare duhet të konsolidohet me atashetë të sigurisë (mbrojtjes) të përzgjedhur nga komisionet e përbashkëta të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së FSK-së.²⁸ Atashetë e sigurisë do të ngrisin bashkëpunimin

²⁶ Shih Ligji mbi FSK-në, Neni 2.1

²⁷ Ligji mbi FSK-në, Neni 8.1.C

²⁸ Departamenti për bashkëpunim ndërkombëtarë në Ministrinë e FSK-së duhet të kordinojë përzgjedhjen e atashëve me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Kriteret për përzgjedhje duhet të vendosen në përputhje me ligjet vendore e ndërkombëtare.

ndërkombëtarë të FSK-së me ushtritë dhe institucionet tjera të sigurisë posaçërisht me ato të vendeve më të mëdha. Duke pasur parasyh që roli i atashëve po lëviz prej çështjeve thjesht ushtarake në çështje të përgjithshme të sigurisë, atashetë kosovarë do të merren me çështje të përgjithshme të sigurisë. Detyrat kryesore të atashëve do të ishin:²⁹

- Ndërlidhja me vendin ku është caktuar për çështje të sigurisë
- Inicon bashkëpunim ndërmjet vendit përkatës dhe FSK-së
- Vepron si këshilltarë për çështje të sigurisë i Ambasadorit dhe stafit të Ambasadës

Në mënyrë që të shmangen ngarkesat buxhetore për diplomacinë kosovare, një atashë mund të zgjidhet për të i mbikqyrur dhe menaxhuar çështjet e sigurisë në deri në tre shtete që gjeografikisht janë afër njëra me tjetrën³⁰

6. Përbërja multietnike, të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore në FSK

6.1 Përbërja multietnike e FSK-së

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin mbi FSK-në, përbërja multietnike e këtij institucioni të sigurisë është thelbësore. Në secilin vend demokratik, strukturat e sigurisë dhe mbrojtjes duhet të reflektojnë përbërjen multietnike të shoqërisë në mënyrë që të jenë në gjendje ta përmbushin misionin e tyre.³¹ Në këtë mënyrë, menaxhmenti i FSK-së duhet të përmbahet nga çdo akt i dikriminimit në baza racore, etnike apo fetare. Shumëllojlojshmëria gjuhësore e fetare e FSK-së mund t'a afektojë interoperabilitetin e mirëfilltë. Ministria e FSK-së së

Megjithatë, atashetë e sigurisë nuk duhet të jenë domosdoshmërishtë oficer karriere. Atashetë kosovar mund të jenë personat që janë civil dhe posedojnë njohuri të gjera të çështjeve të sigurisë në Kosovë dhe vendin përkatës, apo oficerët e përbërjes rezervë që kanë poashtu njohuri të gjera të çështjeve të sigurisë

²⁹ Hulumtimi gjeti disa prej detyrave të përshtatshme të shkruar në DCAF, *Atashetë e Mbrojtjes*, f.2, Korrik 2007, Gjenevë

³⁰ Aty, f.6, Kjo praktikë do të ishte zgjidhje e mirë për kapacitetet fillestare të diplomacisë kosovare

³¹ Sfondi i DCAF, *Forcat e Armatosura Multietnike*, f.1, Mars 2006, Gjenevë

bashku me ndihmën e akterëve relevantë ka përgjegjësi të inicojë programe speciale për integrimin e Komuniteteve.

Më konkretisht, duhet t'i përfshijë në njësite përqindjen proporcionale të komuniteteve që pasyqrojnë përbërjen e përgjithshme multietnike në Kosovë.

6.2 Mbrojtja e të drejtave të njeriut në FSK

Të drejtat e njeriut janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe me Konventa Ndërkombëtare. Edhe në FSK të drejtat e njeriut duhet të mbrohen veçanarisht duke pasur parasyh ndjeshmërinë e institucioneve të sigurisë. Megjithatë, pyetja mund të shtrohet: A duhet të themelohet një autoritet ku anëtarët e FSK-së mund të ankohen nëse ndodh shkelja e të drejtave të njeriut? Për qëllimin e këtij dokumenti, ia vlen të përmendet se vendet e tjera kanë themeluar një strukturë të quajtur *ombdusperson* ushtarak si një mekanizëm i pavarur nga struktura komanduese ushtarake që ushtron mbikqyrje të sektorit të mbrojtjes dhe adreson ankesat lidhur me sjelljet abuzive dhe të pakëndshme në ushtri.³²

Duke pasur parasyh ngarkesat e përgjithshme buxhetore të Buxhetit të Kosovës dhe personelit të limituar të FSK-së, themelimi i një mekanizmi të tillë në Kosovë nuk është i domosdoshëm dhe nuk duhet të kërkohet. Megjithatë, themelimi i një njësije (departamenti) në Ministrinë e FSK-së që do të duhej të adresonte çështjet e ankesave lidhur me të drejtat e njeriut në FSK, është i pashmangshëm. Njësija (departamenti) do të duhej domosdoshmërisht të ndërlihej me Institucionin e Ombduspersonit. Kjo do ta fuqizonte rëndësinë e institucionit të Ombduspersonit dhe qartazi do t'a ngris mbikqyrjen demokratike të FSK-së.

6.3 Barazia gjinore në FSK

Vëmendje e veçantë duhet t'i ipet pjesmarrjes së gruas në FSK. Ndryshimi i natyrës së funksionimit të FA nënkupton që roli që duhet të përmbushët tek institucionet e sigurisë duhet të ndryshojë kështu që të supozosh që secili burrë do të bëhet automatikisht "ushtarë i mirë" është

³² Sfondi i DCAF, Ombduspersonit ushtarak, f.1, Mars 2006, Gjenevë

e metë.³³ Përfaqësimi global i grave në FA është në rritje e sipër në sajë të presioneve të shoqërisë civile si dhe standardeve të vendosura nga qeveritë demokratike si dhe organizatave ndërkombëtare siç është NATO.

Është vështirë të predikohet dhe propozohet përqindja e saktë e femrave në FSK.³⁴ Megjithatë, duke pasur parasyh përvojën e shteteve të NATO-s, pjesa dërmuese e femrave në FSK mund të angazhohen në shërbimet mbështetëse të FSK-së, (logjistika, prokurimi, trajnimet, administrata) dhe të tjerat mund të koncentrohen në sektorët tjerë të FSK-së. kjo është një ndër standardet që duhet të vendoset nga strukturat e FSK-së që nga faza fillestare e rekrutimit.

7. Konkluzionet

Ngritja e Forcës së Sigurisë së Kosovës konform praktikave më të reja për funksionimin e mirëfilltë të forcave mbrojtëse paraqet një ndër detyrat parësore. FSK duhet të themelohet në bazë të parimeve të mbikqyrjes demokratike, transparencës dhe llogaridhënies Rëndësia e FSK-së do të jetë po aq e madhe sa edhe ngritja e institucioneve tjera të rëndësishme në Kosovë. Qeveria e Kosovës duhet që t'i kushtojë vëmendje procesit të përgjithshëm të shpërbërjes së TMK-së duke ndihmuar seriozisht në riintegrimin dhe përkujdesjen e pjestarëve të këtij institucioni.

Roli i NATO-s është thelbësorë jo vetëm për arsye se parashihet me legjislacionin në fuqi. Prania e NATO-s do të ndihmojë në arritjen e aspiratave të vendit për integritet Euroatlantike. Sidomos duhet t'i kushtohet rëndësi pranimit të Republikës së Kosovës në programin Partneritet për Paqe duke bërë kërkesë që Kosova të anëtarësohet në samitin jubilar (përvjetori i 60-të i formimit të Aleancës), në vitin 2009.

³³ UNDP, *Mbizotërimet gjinore në praktikë*, f.169, http://www.undp.org/women/docs/RBEC_GM_manual.pdf

³⁴ Duhet të ndërmerret anketim i gjerë dhe analiza lidhur me përqindjen e pjesëmarrjes së femrave në FSK. Ministria e FSK-së apo shoqëria civile mund të kontribuojnë në të ardhmen në këtë drejtim, duke u bazuar në standarde të NATO-s

Edhe pse ky kërkim shkencorë vlerëson se numri mjaft i vogël i pjestarëve të FSK-së paraqet vështirësi në operacionalizim dhe veprimtari, krijimi i shtabeve dhe komandave të vogla paraqet zgjidhjen më të mirë. Një standardizim i pajisjeve dhe armatimit duhet të ndodhë konform standardeve më bashkëkohore.

Përgjegjësitë e FSK-së nuk do të duhej të kufizoheshin vetëm në ato që i janë lejuar fillimisht. Rëndësia e këtij institucioni lejon hapësirë që domosdoshmërisht t'i vjen në ndihmë pranisë ushtarake ndërkombëtare, policisë e institucioneve tjera. Në veçanti, kontributi i trupave të FSK-së për vendosjen e paqes dhe sigurisë botërore është i pashmangshëm.

Dhe së fundi, duhet t'i kushtohet vëmendje mbrojtjes së lirisë e të drejtave të njeriut, integritimit proporcional të minoriteteve dhe bazarazisë gjinore. Gjithsesi që pjestarët e FSK-së duhet t'i nënshtrohen gjykatave të pavarura civile. Këto edhe përbëjnë një ndër parakushtet thelbësore për ngritjen e mirëfilltë të një institucioni të sigurisë.

Bibliografia

- Buzan Berry, *People, States and Fear, An Agenda for International Security Studies in the Post-Cold War Era*, Publikimi i dytë, Londër, 1991, Britani e Madhe
- DCAF Sfondi - *Kontrolli Demokratik i Forcave të Armatosura*, Maj 2008. Gjenevë
- DCAF, *Atashetë e Mbrojtjes*, Korrik 2007, Gjenevë
- DCAF, *Forcat e Armatosura Multietnike*, Mars 2006, Gjenevë
- DCAF, *Ombuspersoni ushtarak*, Mars 2006, Gjenevë
- Grupi Ndërkombëtarë i Krizave, *“Ushtri për Kosovën”*, nr.174, Bruksel, Prishtinë, 2006
- Huntington Samuel, *Soldiers and the State – The theory and politics of civil-military relationships*
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji mbi Forcat e Sigurisë së Kosovës
- Ligji mbi Ministrinë e Forcave së Sigurisë së Kosovës
- Propozimi gjithpërfshirës i përfaqësuesit të Kombeve të Bashkuara për Kosovë, Marti Ahtisaari,
- Qehaja Florian, *Intervistë me Jamie Shea, Drejtor për planifikim të politikave në NATO*, për temën e Masterit *“Vlerëso në mënyrë kritike rolin e institucioneve evropiane të sigurisë në Ballkanin Perëndimorë që nga fillimi i shekullit XXI?”*, Qershor 2007, Bruksel
- UNDP, *Mbizotërimet gjinore në praktikë*, f.169,
http://ëëë.undp.org/ëomen/docs/RBEC_GM_manual.pdf
- ëëë.nato.int
- <http://lajme.dervina.com/archive/6003-2549:677/Presidenti-Bush-autorizon-dergimin-e-armeve-ne-Kosove.htm>

VLERËSIMI I RËNDËSISË SË
KËSHILLIT TË SIGURISË SË
KOSOVËS NË SEKTORIN E
SIGURISË

K A P I T U L L I I I I

1. Hyrje³⁵

Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK) padyshim së është një ndër shtyllat kryesore në sektorin e sigurisë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës i jep asaj prerogrativën e një institucioni bosht për bërjen e politikave dhe këshillime për çështje të sigurisë. Vlen të theksohet, se shtetet tjera kryesisht në legjislacionet e tyre e kanë paraparë Këshillin e Sigurisë si “Këshilli i Sigurisë Kombëtare” apo “Këshilli Kombëtarë i Sigurisë” kurse në rastin e Kosovës në bazë të planit të dërguarit të Kombeve të Bashkuara për zgjidhjen e statusit, presidentit Ahtisaari,³⁶ është përshkruar si Këshilli i Sigurisë së Kosovës.³⁷

Duke pasur parasysh rrezikshmëritë e shumta dhe kërcënimet, domosdoja e formimit të KSK-së shtrohet çdo ditë e më shumë. Si një ndër rrezikshmëritë e fundit që i kanosen Kosovës janë, prania e vazhdueshme e strukturave paralele e sidomos situata kohë pas kohë e tensionuar në veri të lumit Ibër. Poashtu, krimi i organizuar, moszhvillimi ekonomik dhe kërcënimet e shumëta nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri janë indikatorë që shtrojnë nevojën e konsolidimit të institucioneve të sigurisë në Kosovë.

Në bazë të ligjit për themelimin e KSK-së, roli i saj është këshillues, diskutues, vlerësues dhe rekomandues sa i përket çështjeve të sigurisë në Kosovë,³⁸ përveç gjendjes emergjente që ka rol ekzekutiv.³⁹ Ligji në përgjithësi parashih aspektet të kompetencave dhe detyrave të KSK-së. Për ta thjeshtuar, legjislacioni në fuqi identifikon KSK-në si një institucion të rëndësishëm. Lirisht mund të thuhet se KSK është një mekanizëm i planifikimit dhe parashikimit strategjik në aspektin e sigurisë së vendit.

³⁵ Ky vlerësim është shkruar nga MA Florian Qehaja

³⁶ E adaptuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës

³⁷ Kjo sigurisht për faktin se Kosova nuk është shtet-komb mirëpo është shtet i qytetarëve të saj, ku përfshihen të gjitha komunitetet.

³⁸ Shih *Ligjin për KSK-në*, Neni 1.1, 1.2 dhe 1.3

³⁹ Ibid, Neni 12, “*Cjatë gjendjes së jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë së Kosovës ushtron autoritet dhe përgjegjësi ekzekutive në emër të Qeverisë ...*”

Njëra ndër detyrat themelore dhe të menjëhershme të KSK-së janë hartimi i strategjisë së sigurisë së Kosovës e që është për momentin aktual shumë i domosdoshëm. Kjo strategji do t'i parashihte të gjitha aspektet e identifikimit të rreziqeve dhe kërcënimeve në Kosovë, duke u bazuar në rrethana aktuale dhe në parashikime të hershme. Hartimi sa më shpejt i strategjisë do të ndihmonte në politikat planifikuese të institucioneve të sigurisë në Kosovë.

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) e ka parë si shumë të domosdoshme hartimin e këtij vlerësimi të shkurtë por domethënës, duke kontribuar me një dokument lidhur me funksionimin e mirëfilltë të këtij institucioni dhe duke ngritur rëndësinë dhe nevojën për konsolidimin e KSK-së. Kjo më shumë për faktin se deri më tani shumë pak është bërë në senzibilizimin e rëndësisë së këtij institucioni.⁴⁰ Për hartimin e këtij vlerësimi është përdorur metodologjia si vijon: legjislacioni aktual në fuqi, literaturë bashkëkohore përkatëse si dhe përvoja e ekspertëve të QKSS-së.

Ky dokument fillimisht shpjegon rolin në përgjithësi të Këshillit të Sigurisë duke u bazuar në disa raste - shtete. Pjesa tjetër vlerëson kërcënimet dhe rreziqet e në veçanti hartimi i strategjisë së sigurisë së Kosovës. Pastaj, ky hulumtim një pjesë të posaçme i kushton lehtësive në koordinim me rastin e konsolidimit të KSK-së dhe nevojës së hartimit të ligjit për klasifikimin e informacioneve. Dhe së fundi, konkluzionet.

2. Funksionimi, kompetencat dhe llojet e Këshillave të Sigurisë

Roli i Këshillit të Sigurisë varion nga shteti në shtet. Por duke shiqur në mënyrë më të gjerë, rëndësia e saj është evdiente në shumicën e vendeve. Në mënyrë që të kuptohet roli i KSK-së është parë e arsyeshme që shkurtimisht të vlerësohet roli i Këshillit të Sigurisë në disa shtete si dhe mënyra e funksionimit.

⁴⁰ QKSS ka identifikuar që vetëm DCAF Gjenevë ka organizuar disa punëtori dhe prezentime lidhur me rolin e Këshillit të Sigurisë. Ky hulumtim nuk mund të gjente ndonjë angazhim të institucioneve tjera.

Fillimisht, vlen të theksohet se si model i funksionimit të mirëfilltë të Këshillit të Sigurisë është ai i SHBA-ve. Ajo është një ndër institucionet e para të tilla në botë e themeluar në vitin 1947 e cila udhëhiqet nga Presidenti i SHBA-ve.⁴¹ Roli i saj është që të këshillojë, mbështesë dhe ndihmojë Presidentin e SHBA-së në çështjet e sigurisë, mbrojtjes kombëtare dhe politikës së jashtme.⁴² Mirëpo roli i Këshillit të Sigurisë në SHBA ndryshon varësisht nga presidenti që është në pushtet apo rrethanat. Mirëpo, së fundmi, një ndër kontributin më të madh, Këshilli i Sigurisë në SHBA e ka dhënë në hartimin e strategjisë kombëtare të sigurisë në vitin 2002, pas sulmeve terroriste të 11 Shtatorit 2001 si dhe hartimit të strategjive tjera pasuese.⁴³ Kjo strategji është hartuar me kontributin e Këshillit të Sigurisë të SHBA-së që ndërroi qasjen e SHBA-ve sa i përket sigurisë kombëtare, duke u bazuar në kërcënimet dhe rrezikshmëritë e reja. Ky Këshill në SHBA edhe si “organ i cili merret me botën”.⁴⁴

Përveç Këshillit të Sigurisë së SHBA-ve, një rol të rëndësishëm kanë edhe Këshillat e Sigurisë së Turqisë dhe Izraelit. Ato mbledhen shumë shpesh dhe diskutojnë lidhur me sigurinë kombëtare përkatëse. Në shtetet tjera funksionojnë Këshillat e Sigurisë, mirëpo roli dhe rëndësia e tyre varion nga sistemi i qeverisjes.

Në vendet me sistem presidencial, realisht presidenti udhëheq me Këshillin e Sigurisë dhe se roli i tyre në të shumtën e rasteve është më i theksuar.⁴⁵ Në vendet me sistem parlamentar janë dy lloj i shteteve: në njërin udhëheq presidenti kurse në llojet tjera udhëheq kryeministri apo ndonjë ministër. Duke pasur parasysh rrethanat e reja, disa Këshille të Sigurisë iu kanë përshtatur më shumë konceptit të “sigurisë njerëzore” duke e zgjeruar aktivitetin këshilldhënës dhe rekomandues në një dimension më të gjerë e jo vetëm në korniza të ngushta të sigurisë nacionale.

⁴¹ Shih http://en.wikipedia.org/wiki/United_States_National_Security_Council

⁴² Aty http://en.wikipedia.org/wiki/United_States_National_Security_Council

⁴³ *The National Security Strategy of the United States of America*, Shtator 2002, <http://www.state.gov/documents/organization/15538.pdf>

⁴⁴ **Rothkopf David**, *Running the World: The Inside Story of the National Security Council and the Architects of American Power*, intervistë në radio, shih <http://www.npr.org/templates/story/story.php?storyId=4725006>

⁴⁵ Rasti i SHBA-ve, Federatës Ruse, Ukrainës etj

Sa i përket vendeve fqinje të Kosovës, vlen të përmendet mënyra e funksionimit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë dhe Serbisë.

Në Republikën e Shqipërisë, Presidenti udhëheq me Këshillin e Sigurisë Kombëtare. Roli i saj është që të diskutojë dhe t'i jap këshilla presidentit si Komandant i Forcave të Armatosura.⁴⁶ Këshilli i Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë thirret nga Presidenti duke parashikuar rendin e ditës paraprakisht dhe se anëtarët me autoritet ekzekutiv janë bartësit e institucioneve të sigurisë dhe ato mbështetëse.

Në rastin e Serbisë, Këshilli i Sigurisë nuk ka mandat vetëm të këshillojë, diskutojë dhe vlerësojë. Ajo ka mandat që t'i koordinojë aktivitetet e të gjitha mekanizmave të sigurisë në Serbi.⁴⁷ Duke shqyrtuar legjislacionin në fuqi në Serbi del se, pavarësisht se Këshilli udhëhiqet nga Presidenti, rendi i ditës shtrohet bashkarisht nga Presidenti dhe Kryeministri i Serbisë. Mirëpo, sekretariati i Këshillit të Sigurisë vepron brenda Zyrës së Presidentit ngase shefi i kabinetit të Presidentit është edhe sekretar i Këshillit.⁴⁸ Përbërja e anëtarëve me autoritet ekzekutiv në Këshillin e Sigurisë së Serbisë është në suaza të ngushta – udhëheqësit e resorëve kyçe të sigurisë janë anëtarë.

Vërehet që KSK në krahasim me dy shtetet fqinje ka një mënyrë tjetër të funksionimit. Ligji parashih që KSK thirret dhe udhëheqet nga Kryeministri. Po ashtu sekretariati i KSK-së është një organ i veçantë i cili i raporton Kryeministrit.⁴⁹ Në krahasim me vendet e rajonit, ndihmë e madhe në konsolidimin e KSK-së do të jetë Qendra e Situatave e cila mbledh informacione nga të gjitha mekanizmat e sigurisë në Kosovë. Mirëpo, në hulumtimet e mëhershme është vërejtur që deri më tani analizimi i informacioneve të sigurisë nga Qendra e Situatave nuk ka ndodhur dhe është jofunksional.⁵⁰ Mosanalizimi i informacioneve do ta vështirësonte aktivitetin e KSK-së.

⁴⁶ Shih *Kompetencat e Presidentit të Republikës së Shqipërisë*

⁴⁷ Shih <http://www.voanews.com/Serbian/archive/2007-05/2007-05-31-voa8.cfm>

⁴⁸ “*Zakon o osnovama uredjenja službe bezbednosti Republike Srbije*” dhjetor 2007, Neni 7,

⁴⁹ *Ligji për KSK-në*, Neni 16, Roli i Sekretariatit,

⁵⁰ QKSS, *Gjendja e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile në Republikën e Kosovës*, Korrik 2008. Mirëpo ka mundësi që në ndërkohë QS të ketë filluar me disa analiza.

Sa i përket përbërjes, prania e ministrave përkatës si anëtarë të përhershëm me autoritet ekzekutiv është shumë domethënëse. Përveç kryeministrit që është udhëheqës i KSK-së, anëtarë me autoritet ekzekutiv janë: Zv. Kryeministri, Ministri për FSK-në, Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe Ministri për Kthim dhe Komunitete.⁵¹ Realisht Ministri për Kthim dhe Komunitete nuk do të duhej të ishte pjesë e KSK-së mirëpo kjo është parashikuar për faktin që së paku njëri nga anëtarët me autoritet ekzekutiv të jetë nga komuniteti pakicë.

Në krahasim me shtetet e rajonit, ekzistojnë një listë e anëtarëve të përhershëm të KSK-së që kanë rol këshilldhënës por jo edhe ekzekutiv. Fjala është kryesisht për Drejtorin e Agjencionit Inteligjent, Komandatin e FSK-së, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, Drejtorin e Departamentit të Menaxhimit të Emergjencave, Sekretarin e KSK-së etj.

Në fakt, autoriteti ekzekutiv i vetëm ministrave konsiston në kontrollin civil të institucioneve të sigurisë. Kjo për faktin se Ministrinë udhëheqën nga civilët dhe se janë të zgjedhurit e popullit.

3. Kërcënimet dhe rrezikshmëritë ndaj Kosovës

Kërcënimet dhe rreziqet në Kosovë janë të shumëllojshme. Mirëpo ende mungon një mekanizëm që i përcepton këto lloje të rreziqeve në baza periodike. Në nivel strategjik, legjislacioni aktual përcakton rolin e KSK-së në diskutimin dhe identifikimin e kërcënimeve dhe rreziqeve ndaj Kosovës. Kuptohet se edhe ndihmesa e mbledhjes së informacioneve dhe vlerësimi i kërcënimeve dhe rreziqeve nga disa organe në Kosovë do ta ndihmonin punën e KSK-së.⁵²

Për ta thjeshtëzuar, duke i pasur parasysh kërcënimet ndaj Kosovës nevoja për konsolidimin e KSK-së është shumë e rëndësishme. Për ta demonstruar domosdoshmërinë e konsolidimit të KSK-së ia vlen që së

⁵¹ *Ligji për KSK-në*, Neni 3.1

⁵² P.sh policia mund të bëjë vlerësime për nevoja të veta lidhur me kërcënimet dhe rrezikshmëritë. Pastaj janë disa organizata ndërkombëtare në Kosovë të cilat nëpërmjet hulumtimeve të opinionin bëjnë vlerësime të tilla. Është rasti i UNDP-së me raportin e “Paralajmërimit të Hershëm”.

paku shkurtimisht të i cekim disa kërcënime dhe rreziqe ndaj Kosovës, që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës.

Cenimi i integritetit territorial të Republikës së Kosovës paraqet një ndër rrezikshmëritë të nivelit të lartë. Aktiviteti i strukturave paralele serbe në veri të lumit Ibër si dhe mungesa e qasjes së institucioneve të Kosovës në 18% të territorit shtron nevojën e analizimit të situatës në baza periodike. Kjo sidomos kur merret parasysh fakti i kontrabandës së gjerë në këtë pjesë të territorit e që po dëmton buxhetin e Kosovës.

Cenimi i sigurisë njerëzore në përgjithësi paraqet një nga rreziqet më të mëdha ndaj qytetarëve të Kosovës. Niveli i lartë i korrupsionit, papunësia e moszhvillimi ekonomik, niveli i lartë i krimit etj, shtrojnë poashtu nevojën e shqyrtimit nga ana e KSK-së.

Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore dhe faktori njeri janë evidente. Rasti i zjarreve sidomos vitet e kaluara, rrëshqitjet e dheut (në Kaçanik), tërmetet, vërshimet, epidemitë e ndryshme paraqesin kërcënime permanent për qytetarët e Kosovës. Rasti i fundit ishte hyrja e substancave kimike shumë të rrezikshme në territorin e Kosovës.

Kërcënimet dhe rreziqet e lartëcekura shtojnë edhe më shumë nevojën e konsolidimit të KSK-së.

4. Strategjia e Sigurisë së Kosovës

Përveç kërcënimeve dhe rreziqeve të lartëcekura, njëra ndër detyrat e para dhe shumë të rëndësishme të KSK-së është hartimi i një dokumenti bashkëkohorë – Strategjisë së Sigurisë së Kosovës. Mungesa e një strategjia të përgjithshme të sigurisë paraqet një ndër hendikepet më të mëdha në sektorin e sigurisë. Apo thënë më shkurt, edhe planifikimet strategjike dhe operative në nivel të institucioneve të sigurisë do të duhej të bazoheshin në një strategji të përgjithshme të sigurisë. Kjo për faktin se strategjia e sigurisë ka hierarki superiore ndaj politikave të tjera të sigurisë, siç janë dokumenti i bardhë, strategjia së sigurisë së brendshme etj., të cilat merren me sigurinë kombëtare në nivel të agjencive apo çështjeve të veçanta.⁵³ Strategjia e sigurisë gjithashtu dallohet prej këtyre

⁵³ DCAF, *National Security Policy*, Backgrounder, Geneva 2005, p.1

politikave duke i parashikuar si rreziqet e brendshme ashtu edhe ato të jashtme.⁵⁴

Në bazë të teorisë dhe praktikës së shteteve, strategjia e sigurisë hartohet në bazë të disa nevojave të shteteve siç janë: trajtimi dhe përshkrimi i rreziqeve dhe kërcënimeve në mënyrë gjithëpërfshirëse, fuzionimi i kontributeve të të gjithë akterëve të sigurisë në një dokument, rritja e bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtarë etj.⁵⁵

KSK e ka kompetencën ekskluzive që të hartojë strategjinë e sigurisë së Kosovës.

Neni 2.1 parasheh që “Këshilli i Sigurisë së Kosovës, në koordinim me Presidentin e Republikës së Kosovës, përgatitë dhe shqyrton Strategjinë e Sigurisë së Kosovës. Strategjia e Sigurisë së Kosovës miratohet nga Qeveria dhe i dorëzohet Kuvendit të Kosovës për miratim përfundimtar”. Përveç kësaj KSK ka kompetencë që të shqyrtojë edhe planet pesëvjeçare apo dhjetvjeçare të punës së Agjensionit Inteligjent të Kosovës, Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës.

Hartimi i strategjisë së sigurisë së Kosovës, përveç tjerash, do të duhej t’i shprehte aspiratat e Kosovës për integritet në BE dhe NATO, gatishmërinë për bashkëpunim rajonal, kontribut në vendosjen e paqës dhe sigurisë në botë nëpërmjet misioneve paqërtuajëse, garantimit të rrespektimit të drejtave të njeriut e në veçanti minoriteteve etj.

5. Koordinimi

Rëndësia e konsolidimit të KSK-së konsiston edhe në një aspekt tjetër shumë të rëndësishëm. Mbledhjet e KSK-së si dhe aktivitetet e përbashkëta planifikuese do ta forconin koordinimin në mes institucioneve të sigurisë. Kjo për arsye se hulumtimet e mëhershme kanë vërejtur që mungon një koordinim në mes këtyre institucioneve, nga lartë poshtë si dhe nga poshtë lartë.⁵⁶

⁵⁴ Aty,

⁵⁵ Aty,

⁵⁶ Për shembull në çështjet e mbrojtjes civile është vërejtur një mungesë e koordinimit. Shih QKSS, *Gjendja e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile në Republikën e Kosovës*, Koordinimi f.6, Korrik 2008

Edhe pse në ligj nuk parashihet shprehimisht, koordinimi i aktiviteteve në mes të mekanizmave të sigurisë nëpërmjet KSK-së paraqet një rëndësi të veçantë.

6. Mbikqyrja parlamentare

Mbikqyrja parlamentare mbi akvitetet e KSK-së duhet të instalohet që në aktivitetet e para si një nga aspektet më të rëndësishme të mbikqyrjes demokratike të institucioneve të sigurisë. KSK është një organ i cili udhëhiqet nga Kryeministri dhe se përbërja e saj është nga rradhët e bartësve të institucioneve kyçe të shtetit. Komisioni përkatës⁵⁷ duhet të organizojë shpesh seanca lidhur me punën e KSK-së. Sidomos, aktivitetet specifike të Sekretariatit të KSK-së mund të jenë nevojshme për Komisionin përkatës.

7. Informacionet e klasifikuara

Operacionalizimin e KSK-së dhe institucioneve tjera të sigurisë do ta vështirësoj mungesa e ligjit mbi informacionet e klasifikuara. Ky ligj është i një rëndësie të veçantë ngase i nivelizon klasifikimet e informacioneve në bazë të rëndësisë. Në këtë mënyrë, duhet urgjentisht hartimi dhe miratimi i këtij ligji. KSK gjatë mbledhjeve tre mujore mund të merr vendime që nuk duhet të bëhen publike për shkak të rrezikut që mund të i kanoset vendit.

Realisht, klasifikimi i informacioneve nuk është vetëm pjesë e njërit institucion të sigurisë mirëpo e tërë administratës publike të Kosovës. Është detyrë e shtetit që për shkak të ruajtjes së interesave nacionale e qytetare disa informacione t'i klasifikojë dhe përhapjen e tyre ta kufizojë në bazë të klasifikimit. Shtetet kanë disa informacione dhe dokumente që qarkullojnë brenda burokracisë së administratës që duhet të mbahen larg syve të publikut dhe implikimeve jo miqësore sepse zbulimi i tyre mund t'i dëmtojë interesat shtetërore.⁵⁸

⁵⁷ Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, Kuvendi i Kosovës

⁵⁸ Reichard Martin, The EU-NATO relationship, A legal and Political Perspective, f.311

Klasifikimi i informacioneve duhet të bëhet në bazë të rëndësisë. Vetëm personat që janë të autorizuar mund të kenë qasje në informacione e klasifikuara. Përveç kërreëve shtetërorë disa persona administrativë mund të kenë qasje në informacione të klasifikuara mirëpo kjo duhet të bëhet vetëm në bazë të verifikimit dhe inspektimit të të kaluarës së individëve dhe kriteret tjera që duhet të caktohen,⁵⁹ gjë që përmendet edhe në ligjin mbi KSK-në Kjo duhet sidomos të jetë kompatible me standardet për Sigurinë e Informacioneve (SI) të NATO-s dhe BE-së

Shtetet e ndryshme kanë klasifikime të ndryshme mirëpo ai më adekuat është klasifikimi si vijon:⁶⁰

- Top Sekret
- Sekret
- Konfidenciale
- Kufizuar

8. Konkluzionet

Këshilli i Sigurisë së Kosovës paraqet një ndër mekanizmat bosht të sigurisë. Rëndësia e tij është po aq e madhe sa të vlerësojë gjendjen e sigurisë në Republikën e Kosovës, të rekomandojë dhe këshillojë institucionet e vendit lidhur me kërcënimet dhe rrezikshmëritë e mundshme.

Mungesa e identifikimit periodik të kërcënimeve dhe rreziqeve në Kosovë shtron domosdon e konsolidimit sa më të shpejtë të KSK-së. Ngecjet në konsolidimin e këtij mekanizmi të rëndësishëm janë të pajustificueshme dhe të dëmshme. Përveç kësaj, hartimi i Strategjisë së Sigurisë së Kosovës nga KSK përbën një imperativ që duhet të ndodhë

⁵⁹ Në teori dhe praktikë kjo quhet “security clearance”. “Security clearance” është statusi qëi ipet individëve të caktuar për të pasur qasje në informacionet e klasifikuara. Shih http://en.wikipedia.org/wiki/Security_clearance

⁶⁰ Manager’s Handbook, Security Policy, f.2

Ky klasifikim mendohet si më adekuati ngase shumica e shteteve e kanë të tillë. Disa shtete përveç këtij klasifikimi e kanë edhe të potencuar se informacionet tjera janë të paklasifikuara dhe si të tillë e shënojnë. Disa shtete edhe nuk e kanë fare klasifikimin KUFIZUAR..

sa më parë. Mungesa e një strategjie gjithpërfshirëse vështirëson planifikimin dhe vendim-marrjen si në nivel më të ulët ashtu edhe në nivel më të lartë.

KSK duhet të shërbejë edhe si një institucion koordinues duke pasur në konsideratë dobësitë e theksuara në koordinimin e institucioneve të sigurisë. Vlerësimet e mëhershme kanë treguar se ka një mungesë të koordinimit nga lartë-poshtë dhe poshtë-lartë. Aktivitetet e përbashkëta të institucioneve të sigurisë në kuadër të Sekretariatit të KSK-së, siç janë: analizimi i informacioneve, identifikimi i rreziqeve, raportimi i përbashkët shpiejnë në drejtim të një koordinimi efikas ndër-institucional.

Dhe së fundi, mungesa e ligjit mbi klasifikimin e informacioneve paraqet një fakt shqetësues. Republika e Kosovës nuk mund të funksionojë si shtet në mungesë të klasifikimit të informacioneve. Disa vendime dhe vlerësime mund të jenë të rrezikshme nëse përhapen dhe kësajoi i dëmtojnë interesat e Kosovës. Klasifikimi i tyre në bazë të rëndësisë është i pashmangshëm.

Bibliografia

- DCAF, National Security Policy, Backgrounder, Geneva 2005
- Ligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës
- Ligji për kompetencat e Presidentit të Republikës së Shqipërisë
- Manager's Handbook, Security Policy
- QKSS, Gjendja e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile në Republikën e Kosovës, Korrik 2008
- Reichard Martin, The EU-NATO relationship, A legal and Political Perspective
- **Rothkopf David**, *Running the Eorld: The Inside Story of the National Security Council and the Architects of American Poer*, intervistë në radio, shih <http://ëëë.npr.org/templates/story/story.php?storyId=4725006>
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare e SHBA-ve
- Zakon o osnovama uredjenja sluzbe bezbednosti Republike Srbije <http://ëëë.voaneës.com/Serbian/archive/2007-05/2007-05-31-voa8.cfm>
- http://en.ëikipedia.org/ëiki/United_States_National_Security_Council
- <http://ëëë.npr.org/templates/story/story.php?storyId=4725006>
- http://en.ëikipedia.org/ëiki/Security_clearance

VLERËSIMI I KOMPANIVE
PRIVATE TË SIGURISË

K A P I T U L L I I V

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE KONSTATIMET KRYESORE

Mbizotërimi i agjendës neolibërale vazhdon të jetë faktor kryesor që e çon përpara zhvillimin e KPS-ve. Ideologjia e tregut dhe nocioni se privatizimi është mjeti më efikas për ofrimin e shërbimeve kanë ndikuar në mënyrën se si veprojnë qeveritë. Supozohet se privatizimi i disa segmenteve të sigurisë është qasje me leverdi. Pas luftës në Kosovë, çarmatimi jo i duhur, prania e armëve si dhe periudha e zgjatur për formimin e strukturave të sigurisë krijuan një ambient të përshtatshëm për ekzistimin e strukturave private të sigurisë. Pas shpërbërjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, disa ish-luftëtarë hyn në tregun e punës, dhe kompanitë private të sigurisë pjesërisht përputheshin me potencialin e tyre për punë. Pengesat për të hyrë në një kompani private të sigurisë ishin të pakta: të gjitha mjetet e nevojshme, përfshirë edhe njësitë relativisht jo të shtrenjta të punës tashmë ishin në dispozicion në tregun e hapur të punës. Kombinimi i faktorëve global sistematik dhe strukturor dhe reagimeve lokale ndaj tyre krijuan kërkesën për kompani private ushtarake po ashtu edhe kërkesën për furnizimin me fuqi punëtore dhe investime kapitale për të përmbushur ato kërkesa.

Siç ishte rasti me vendet e tjera ish-komuniste, institucionet shtetërore të Kosovës së pasluftës dhe tregu ishin të dobëta dhe të çrregulluara. Mes vitit 2000 dhe 2008 u krijua një numër i madh i kompanive private të sigurisë. Infrastruktura e mbikëqyrjes dhe kontrollit ishte e ngadalshme në adresimin e rreziqeve të mundshme, të konkurrencës lojale dhe operacioneve të ligjshme në këtë industri. Ky dokument vlerësues bazohet si në të dhënat cilësore, ashtu edhe në ato sasiore për paraqitjen e një konceptualizimi më gjithëpërfshirës dhe më të strukturuar të industrisë së sigurisë private në Kosovë. Hulumtimi ka filluar në nëntor të vitit 2008 dhe përfshinë: i) anketimin e 1.202 amvisërive, ii) gjashtë diskutime në grupe të fokusuara, iii) më shumë se gjashtëdhjetë intervista me ofruesit kyç të informatave (zyrtarë të qeverisë, deputet të Kuvendit, ekspertë të sigurisë, operatorë privat të sigurisë, udhëheqës të komuniteteve), iv) analizën e të dhënave zyrtare për operatorët privatë të sigurisë dhe v) shqyrtimin e dokumenteve hulumtuese, akademike, si dhe të politikave vendore dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me sigurimin privat. Vlen të përmendet se gjatë zhvillimit të hulumtimit QKSS hasi në

vështirësi për të kontaktuar me disa KPS për shkak të mospërfilljes së tyre ose refuzimit për të kontribuar në këtë hulumtim.

Konstatimet kryesore

Disa prej konstatimeve kryesore të dokumentit të vlerësimit janë:

- Mungesa e mbikëqyrjes, kontrollit dhe rregullimit të mjaftueshëm të kompanive private të sigurisë
- Kontrolli i joefikas i biografive dhe i procedurave të verifikimit të pjesëtarëve të KPS-ve
- Numri i kompanive private dhe pjesëtarëve të tyre është më i madh se sa paraqitet në statistikat zyrtare
- Kompanitë private të sigurisë janë të ndara dhe u mungon koherenca në organizim
- Konkurrenca jolojale dhe pengesat për hyrje në treg
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi jo i mjaftueshëm i informatave nga kompanitë private të sigurisë dhe nga ofruesit publikë të sigurisë
- Shkelja e të drejtave të njeriut brenda kompanive private të sigurisë, nuk respektohet ligji për punësim dhe një pjesë e madhe e aktiviteteve dhe personelit nuk i raportohen aparatit zyrtar
- Përfaqësimi i papërfillshëm i femrave (1-3%)
- Mbikëqyrja shumë e vogël, pothuaj joekzistente nga Kuvendi i Kosovës
- Industrisë i mungojnë mekanizmat e caktuar të rregullimit dhe kontrollit

Qëndrimi dhe perceptimi i kompanive private të sigurisë

- Rreth 73% e të anketuarve vlerësuan se KPS-të kanë rol pozitiv në sigurinë e përgjithshme në Kosovë
- Shumica e kosovarëve janë të kënaqur me punën e KPS-ve
- Megjithatë, pothuaj gjysma (46%) e të anketuarve besojnë se KPS-të nuk kanë personel adekuat dhe nuk i plotësojnë kriteret për tu përfshirë në çështjet e sigurisë
- Kosovarët kanë mendime të ndryshme kur është fjala për lejimin e KPS-ve të mbajnë armë; 46 % e të anketuarve thanë se atyre duhet lejuar këtë gjë, 39% e tyre ishin kundër, ndërsa pjesa tjetër refuzuan të përgjigjen ose nuk patën përgjigje.
- 57% besojnë se KPS-të kontribuojnë në uljen e shkallës së krimeve në Kosovë
- 31 % thanë se ata kanë përjetuar ose kanë parë raste të sjelljes jo të mirë dhe të shkeljes së të drejtave të njeriut nga KPS-të.

Përkundër perceptimit gjithnjë e më të madh për ekzistimin e numrit të tepërt të kompanive private të sigurisë në Kosovë, numri i tyre është proporcionalisht më i ulët se në pjesën tjetër të Evropës. Megjithatë, institucionet shtetërore ballafaqohen me sfida të tmerrshme në rregullimin e kësaj industrie dhe me mungesë të vizionit kur është fjala për iniciativat rreth politikave. Ligji për kompanitë private të sigurisë ka qenë i bllokuar për një kohë të gjatë, ndërsa infrastruktura ekzistuese ligjore nuk i plotësonte kërkesat për qeverisje demokratike dhe llogaridhënie. Iniciativat e kohëve të fundit për përshpejtimin e hartimit dhe eventualisht miratimin e ligjit për sigurimin privat janë premtuese, por u mungon trajtimi i sfidave ekzistuese dhe të ardhshme.

1. Hyrje⁶¹

1.1 Informacione të përgjithshme

Pak kush ka mundur ta imagjinojë një rritje të tillë të sektorit privat të sigurisë në Kosovë. Para disa vitesh nuk mund të paramendohej madje as kërkesa për sigurim të strukturuar privat. Numri i shërbimeve të ofruara sot nga KPS-të fillon nga mbrojtja fizike klasike e pronave private dhe publike, mbrojtja e afërt e VIP-ve, ruajtja e “pronave me rëndësi strategjike” dhe sigurimi i manifestimeve kulturore dhe muzikore. Besohet se kjo industri që është duke u zgjeruar po kontribuon në krijimin e një mjedisi më të sigurt në Kosovë. Prania e KPS-ve në terren në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i ndihmon autoritetet për zbatimin e ligjit në ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë. Çka është me rëndësi, vakuumi i sigurisë që vazhdon të jetë i pranishëm derisa të forcohen mekanizmat e policisë mund të mbulohet nga kompanitë private të sigurisë.

Nga perspektiva e sigurisë vazhdojnë të ekzistojnë rreziqe dhe kërcënime të reja të drejtuara kundër sigurisë njerëzore dhe pronës private. Këto rreziqe nuk do të mund të evitoheshin pa kontributin e qytetarëve dhe akterëve të tjerë. Autoritetet për zbatimin e ligjit hasin në një varg problemesh, dhe thjeshtë nuk mund të përballojnë barrën për ofrimin e pranisë dhe sigurisë për secilën pronë dhe individ. Përpjekjet e institucioneve qeveritare, të shoqërisë civile dhe mediave në përgjithësi për monitorimin dhe vlerësimin e punës dhe veprimtarisë së KPS-ve kanë qenë të rralla dhe të papërfillshme. Disa thonë se rëndësia e industrisë së sigurisë private shpesh është nënvlerësuar.⁶² Komuniteti në përgjithësi dhe disa analistë ende mendojnë se siguria në Kosovë është monopol ekskluzivisht i forcave vendore dhe ndërkombëtare që janë të pranishme në Kosovë. Kjo pjesërisht ndodh për shkak të pamundësisë për tu përshtatur në ndryshimet paradigmatiche në botë.

⁶¹ Ky vlerësim është shkruar nga MA Florian Qehaja, MSc.MA Armend Muja dhe BA Mentor Vrajolli

⁶² Intervistë me Emrush Xhemajlin, deputet i Kuvendit, Komisioni për punë të brendshme dhe siguri i Kuvendit të Kosovës, 16.01.2009

Ky hulumtim vlerëson punën dhe gjendjen e tanishme të sektorit të sigurisë në Kosovë. Strukturat e tjera të sigurisë, siç janë kompanitë private ushtarake dhe detektivët privatë nuk janë të zhvilluar në Kosovë dhe asnjë kompani kosovare e këtij lloji nuk ka marrë pjesë në ndonjë operacion jashtë vendit. Thënë më saktë, ky hulumtim nuk përfshinë vlerësimin e kompanive private ushtarake dhe detektivëve privatë, pasi që ata nuk janë të pranishëm në terren dhe nuk janë të rregulluar me ligj.

Në kapitullin e I-rë shkurtimisht bëhet vlerësimi i dimensionit të përgjithshëm të privatizimit të sigurisë në kontekstin e mjedisit të ri të sigurisë dhe pasqyrës së përgjithshme të KPS-ve në Kosovë. Më pastaj bëhet një analizë të dimensionit ligjor dhe pengesave në miratimin e ligjit për kompanitë private të sigurisë. Në kohën e përfundimit të këtij dokumenti, kjo industri vazhdon të funksionojë në bazë të Rregullores 2000/33 të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Në pjesën e dytë dokumenti vlerëson mjedisin ku veprojnë KPS-të duke përfshirë edhe rregullimin e tregut, kërkesat e tregut, si dhe kontekstin e punësimit dhe analizon format e mikro-menaxhimit, përfshirë trajnimet, organizimin, pajisjet, posedimin e armëve dhe përdorimin e forcës. Kapitulli i tretë përfshinë edhe të dhënat e përpunuara nga anketimi i 1.202 personave për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë private në Kosovë. Përfundimet dhe rekomandimet jepen në pjesën e fundit.

1.2 Metodologjia

Hulumtimi për këtë dokument vlerësues për kompanitë private të sigurisë në Kosovë është bërë gjatë periudhës tremujore prej nëntorit 2008 deri në shkurt 2009. Ekipi përdori një varg burimesh të ndryshme për mbledhjen e informatave të nevojshme për një studim gjithëpërfshirës si për të siguruar një nivel të lartë të saktësisë, ashtu edhe për të mundësuar një analizë të hollësishme të gjendjes. Studimi bazohet në të dhëna cilësore dhe sasiore. Në burimet e të dhënave hyjnë:

- Një anketë e realizuar në mbarë Kosovën në gjuhën shqipe dhe serbe. Kjo anketë u zhvillua në janar të vitit 2009 në të cilën u morën përgjigjet e 1.202 të anketuarve nga mbarë Kosova, duke mbuluar të gjitha grupet kryesore etnike, shoqërore dhe demografike.

- Gjashtë diskutime në grupe të fokusuara – dy në Prishtinë, një në Mitrovicë, një në Ferizaj, një në Graçanicë, një në Prizren dhe një në Gjilan.
- Intervistat e zhvilluara me mbi 60 ofrues kryesorë të informatave nga kompanitë private të sigurisë, zyrtarë qeveritarë, deputetë të Kuvendit, ekspertë të sigurisë dhe udhëheqës të komuniteteve.
- Analiza e të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Policisë së Kosovës.
- Shqyrtimi i dokumenteve hulumtuese dhe akademike vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me kompanitë private të sigurisë

II. PRIVATIZIMI I SIGURISË NË MJEDISIN E RI TË SIGURISË

2.1 Pasqyra e përgjithshme e sektorit të tanishëm të sigurisë në Kosovë

KPS-të në Kosovë kanë filluar të veprojnë pothuaj para një dekade, shumë më vonë se në pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë. Periudha e gjatë e marrëdhënieve të tensionuara me regjimin e Millosheviqit dhe situata e vështirë politike i vështirësuan zhvillimet e përgjithshme shoqërore. Fundi i luftës në Kosovë më 1999 solli ekonominë e tregut dhe demokracinë pluraliste, si dhe praktikën bashkëkohore të sigurisë njerëzore. Me shpejtësi filluan të krijohen iniciativa të sigurisë private në kohën kur strukturat e sapolindura të policisë po përpiqeshin të siguronin rendin dhe ligjin. Shumica e KPS-ve u themeluan nga ish-luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ish-oficerët e Armatës Popullore të Jugosllavisë dhe individë që kishin punuar edhe përpara në çështje të sigurisë.

Krijimi i shpejtë i iniciativave të sigurisë private pjesërisht mund të sqarohet nga shtytja simbiotike për tu përshtatur në kushtet e reja, por në një fushë që ishte në përputhje me potencialin e tyre të punës (sigurinë) dhe shtytja për kërkimin e përfitimeve financiare. Zhvillime të ngjashme u bënë edhe nga ish-luftëtarët në zonat e tjera të luftës në ish- Jugosllavi.

Megjithatë, nuk mund të përjashtohet as fakti se shumë prej iniciativave erdhën nga ndërmarrësit mendjemprehtë të cilët bartën njohuritë e tyre nga Evropa Perëndimore. Gradualisht u zhvilluan dy iniciativa të sigurisë private a) mbrojtja fizike e pronës (rojet dhe pajisjet elektronike) dhe mbrojtja e afërt – sigurimi i individëve. Pengesat për fillimin e punës nga operatorët privatë të sigurisë ishin mjaft të pakta: të gjitha mjetet e nevojshme, përfshirë edhe njësitë relativisht të lira të punës tashmë ishin në dispozicion në treg. Kombinimi i faktorëve global sistematikë dhe strukturorë dhe reagimet lokale ndaj tyre krijuan edhe kërkesën për ekzistimin e kompanive private të sigurisë edhe furnizimin me fuqi punëtore dhe investime kapitale për plotësimin e atyre kërkesave.

Siguria private në Kosovë është duke u zhvilluar çdo ditë e më shumë. Saktësia dhe besueshmëria e fakteve dhe konstatimeve nga çdo iniciativë hulumtuese është e kufizuar për shkak të zhvillimeve dinamike dhe joformaliteteve potenciale në këtë sektor. Në janar të vitit 2009, të dhënat zyrtare tregonin se në Kosovë ekzistonin 48 KPS vendore dhe ndërkombëtare, nga të cilat 44 janë kosovare dhe 4 të tjera ndërkombëtare.⁶³ Më shumë se gjysma e KPS-ve janë me bazë në Prishtinë, një prani e konsiderueshme e KPS-ve janë të regjistruara në rajonin e Prizrenit, Gjilanit dhe Ferizajt.⁶⁴ Pothuaj të gjitha KPS-të janë në pronësi të shqiptarëve të Kosovës, me përjashtim të njëres që gjendet në pjesën veriore të Kosovës dhe që është pronë e një serbi të Kosovës.⁶⁵ Nga të gjitha këto kompani, vetëm njëra (ndërkombëtare) ka leje për mbajtjen e armëve.⁶⁶

Edhe pse të dhënat zyrtare paraqesin një shifër tjetër, ekziston një perceptim i përgjithshëm se disa kompani të sigurisë as nuk janë të regjistruara e as nuk posedojnë licencë për ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Në anën tjetër, mbetet e paqartë se si ndërmarrjet publike i mbulojnë vet nevojat e tyre të sigurisë. Ka raste kur shërbimet e sigurisë mbesin të paregjistruara dhe raste të tjera kur kompanitë publike i kanë

⁶³ SSPIU, (Njësia Hetimore e Ofruesve të Shërbimeve të Sigurisë) Njësi e Policisë së Kosovës për inspektimin e KPS-ve, dhjetor 2008. Megjithatë vlerësohet se 10 kompani nuk janë duke ushtruar veprimtarinë edhe pse i kanë marrë licencat. Ndoshta nuk mund të përballojnë konkurrencën e hapur.

⁶⁴ Shënimet zyrtare, Njësia e Policisë së Kosovës për inspektimin e KPS-ve.

⁶⁵ KPS e quajtur “Soko”

⁶⁶ Henderson

krijuar strukturat e veta të sigurisë dhe i kanë regjistruar ato.⁶⁷ Përveç kësaj, disa KPS, kryesisht ato në veri të Kosovës, ushtrojnë aktivitetin e tyre jashtë kornizës së tanishme ligjore. Sipas raporteve, ato janë të regjistruara dhe licencuara nga autoritetet e Qeverisë së Serbisë.⁶⁸

Këto mangësi e pengojnë zhvillimin normal të industrisë së sigurisë private në Kosovë dhe nuk i kontribuojnë krijimit të iniciativave shumetnike, aty ku ka mundësi.⁶⁹ Megjithatë, ka raste që kompanitë punësojnë punëtorë që u përkasin grupeve të ndryshme etnike. Së paku dy kompani ndërkombëtare dhe një vendore kanë të punësuar roje private të sigurisë nga radhët e komunitetit serb. Një kompani ndërkombëtare që vepron në tërë Kosovën ka qenë shumë e saktë në të dhëna duke argumentuar se 10% e të punësuarve ishin serbë.⁷⁰ Kohëve të fundit, një KPS me bazë në Ferizaj ka punësuar 6 roje të sigurisë nga komuniteti serb për sigurimin e rezidencave private në qendrën turistike të Brezovicës, në pjesën jugore të Kosovës.

Sipas të dhënave zyrtare janë 3750 roje të regjistruar të sigurisë. Megjithatë, as personat përgjegjës nuk e mohojnë faktin se ky numër është më i madh. Në bazë të informatave të marra nga KPS-të, nga shënimet zyrtare dhe po ashtu duke llogaritur praktikat e mundshme (që duhet të sqarohen në pjesët e tjera përkatëse) ne vlerësojmë se mund të ketë rreth 4000 – 4.500 individë të punësuar nga KPS-të. Është pothuaj e pamundur të gjendet numri i saktë i personave të punësuar për një varg arsyesh.

Së pari, disa punëtorë mund të mos jenë deklaruar, duke u munduar të shmangen përgjegjësitë ligjore dhe financiare që përcaktohen në Ligjin për punësim. Kjo vjen si rezultat i mungesës së një mekanizmi të duhur të inspektimit dhe kontrollit, si dhe i mungesës së përgjegjësive shoqërore të KPS-ve. Së dyti, disa individë punësohen vetëm për shërbime afatshkurtra dhe kjo varet nga paqëndrueshmëria dhe kërkesa e tregut. Në zhargonin lokal ky njihet si “punësim i përcaktuar nga tenderët”. Për ta thjeshtuar, ata punësohen për shërbime afatshkurtra dhe pastaj

⁶⁷ Hulumtimi konstatoi rastin e Postës dhe Telekomit të Kosovës

⁶⁸ *Rishikimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme në Kosovë*, Botimi: Kompanitë private të sigurisë, fq. 112, 2006

⁶⁹ *Ibid*,

⁷⁰ Intervistë me Grant Cambridge, Menaxher për Kosovë i “Henderson”

pezullohen nga puna.⁷¹ Së fundi, veprimtaria e përgjithshme e shumë KPS-ve të paregjistruara, e veçanërisht atyre në pjesën veriore të Kosovës mbështet supozimet tona të mëhershme.

KPS-ve në Kosovë u mungon struktura e unifikuar dhe efektive e bashkimit në shoqata. Ato janë rreshtuar në një nga shoqatat ekzistuese të KPS-ve: a) Shoqata e Kompanive Private të Sigurisë në Kosovë (SHKPSK) ose në Shoqatën “AKIS”, e disa nuk janë anëtare të asnjërës prej tyre. Por çka i ka bërë deri më tani KPS-të të mos bashkohen? SHKPSK i bashkon gjashtë kompani private të sigurisë ndërsa AKIS ka përafërsisht trembëdhjetë. Mekanizmat e votimit dhe kryesimit janë rregulluar sipas numrit të përgjithshëm të rojeve që ato punësojnë, gjë që teorikisht i jep KPS-së më shumë fuqi në caktimin e rregullave. Këto praktika parimisht janë ndryshe në AKIS, ku mënyra e përfaqësimit është *secila kompani ka një votë të vetme*, domethënë ka një përfaqësim më të balancuar të interesave.⁷² Megjithatë, kjo mbulon vetëm një pjesë të thelbit. Për më tepër, strukturimi i tanishëm i mekanizmave të bashkëpunimit mund të shpie kah tendencat për mbylljen e sistemit dhe krijon pengesa për hyrje në treg.

Dy KPS-të më të mëdha në Kosovë duket se kanë rreth 60% të tregut dhe punësojnë më shumë se 50 për qind të të gjithë punëtorëve të sigurisë në këtë industri.⁷³ Edhe pse ekipi nuk pati mundësi të gjejë të dhëna të sakta për nivelet e pagesave të punëtorëve të KPS-ve, dëshmitë që nuk janë të besueshme i vlerësojnë ato ndërmjet 100-350 eurosh në muaj.⁷⁴ KPS-të kanë nivele dhe metoda të ndryshme të pagesës. Sipas raportit, KPS-të u ofrojnë klientëve tarifë prej 0.78 – 2.10 euro *në orë*.⁷⁵ Vargu i shërbimeve është i gjerë duke filluar nga sigurimi fizik, mbrojtja e VIP-ve, sigurimi i manifestimeve të rëndësishme, sigurimi i bizneseve, etj.

⁷¹ Për shembull, gjatë kohës kur këngëtari amerikan “50 CENT” organizoi koncertin në Prishtinë, gjatë asaj dite u angazhuan qindra roje të sigurisë për të ofruar mbrojtje fizike për këtë ngjarje të madhe.

⁷² Shoqata “Akis”. Gjatë intervistave që patëm me KPS-të anëtare të “Akis” ata na sqaruan përfitimet nga të qenit pjesë e këtij organi pasi që kompanitë e vogla dhe të mëdha kanë të drejtë të barabartë në votim.

⁷³ Intervistë me Agron Jusufin Drejtor i WDG-së dhe Kryesues i Shoqatës për Kompanitë Private të Sigurisë në Kosovë. Dy KPS-të më të mëdha në Kosovë janë WDG dhe Balkan International Security.

⁷⁴ Kjo dallon varësisht prej kompanisë.

⁷⁵ Këto të dhëna i morëm duke u bazuar në diskutimet në grupe të fokusuar.

Nga perspektiva e sigurisë, KPS-të në Kosovë vërtetë i kontribuojnë një mjedisi të sigurt në Kosovë. Për momentin numri i policëve të Policisë së Kosovës është mbi 8.000 prandaj proporcioni ndërmjet numrit të policëve dhe numrit të rojeve të sigurisë është përafërsisht 2:1.⁷⁶ Praktika ka dëshmuar se numri i rojeve të sigurisë private ka tendencë që t'i afrohet numrit të policëve shtetërorë ndërsa në vendet e Evropës Perëndimore është edhe më i lartë.⁷⁷ Madje, edhe në Kosovë edhe në vendet e tjera të rajonit rritja e përditshme e industrisë së sigurisë private çon drejt një proporcioni të barabartë të numrit të pjesëtarëve (1:1). Kërkesat e tregut domosdoshmërisht e rrisin numrin e rojave të sigurisë private dhe lehtëson barrën financiare të institucioneve private të sigurisë.

Vlen të përmendet se disa kompani të vogla ose prona private ende e shfrytëzojnë mënyrën e vjetër të sigurisë fizike, siç është punësimi i një “personi të moshuar”⁷⁸ ose dikujt tjetër për të qenë i pranishëm dhe për të “frikësuar” plaçkitësit dhe grabitësit. Kjo mënyrë shfrytëzohet për shkak të mentalitetit të njerëzve për të mos ua besuar “të panjohurve” mbrojtjen e pronave të tyre. Situata është edhe më e qartë në shërbimet e mbrojtjes së afërt në të cilat VIP-at zakonisht preferojnë të angazhojnë ndonjë anëtar të familjes së tyre ose ndonjë mik e jo ndonjë truporë nga ndonjë kompani private e sigurisë.

Në Kosovë nuk ka detektivë privatë të autorizuar. Përkundër disa raporteve se disa plane të tilla janë përfshirë në strategjinë legislative të Ministrisë së Punëve të Brendshme,⁷⁹ legjislacioni ekzistues nuk i lejon operacionet e këtyre subjekteve. Duhet të hartohet dhe miratohet Ligji për detektivët privatë, i cili duhet të marrë parasysh gjendjen në terren. Kosova duhet të marrë praktikën më të mira të vendeve të tjera kur është fjala për detektivët privatë – lejen me mbikëqyrje të afërt dhe me procedura të rrepta. Detektivët u ofrojnë hetime private palëve kontraktuese/ përkatëse. Këto shërbime janë të fshehta dhe shumë të ndjeshme.⁸⁰ Disa vende në rajon tashmë kanë filluar të aplikojnë praktika

⁷⁶ Intervistë me Nuredin Ibishin, ekspert për çështje të sigurisë, 07.01.2009.

⁷⁷ Ibid.

⁷⁸ Intervistë me Agim Musliun, South East Security, 12.01.2009.

⁷⁹ Është e qartë se nuk do të ndodh në të ardhmen e afërt.

⁸⁰ Intervistë me Nuredin Ibishin, ekspert për çështje të sigurisë, 07.01.2009.

të tilla ndonëse raportet tregojnë për abuzime të mundshme.⁸¹ Në këtë mënyrë vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet themelimit të ardhshëm të detektivëve privatë.

2.2 Dimensioni ligjor i kompanive private të sigurisë në Kosovë

Privatizimi i sektorit të sigurisë konsiderohet të jetë fenomen i ri në shoqëritë paskomuniste. Si dihet mirëfilli, sektori i sigurisë në sistemin e mëhershëm ka qenë tërësisht monopol i institucioneve shtetërore. Prandaj, edhe rregullimi ligjor i këtij sistemi konsideronte se vetëm institucionet shtetërore duhet të lejoheshin që të ofronin shërbime të sigurisë, duke përjashtuar angazhimin e organizatave civile në këtë aktivitet.⁸² Madje, ndërmarjet shtetërore ishin të obliguara të krijonin struktura të sigurisë për mbrojtjen e pasurisë dhe punëtorëve që punonin në kompani.⁸³

Sa i përket shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe veçanërisht vendeve të ish-Jugosllavisë, rregullimi ligjor i sistemeve është sfiduar nga vështirësitë e mëtejshme të cilat e kanë gjymtuar sektorin e sigurisë. Këto përfshijnë problemet e krimit të organizuar, të ish-luftëtarëve, akterët ushtarak dhe paraushtarak të organizuar mirë të cilët mund t'i përligjinin aktivitetet e tyre nën mbulesën e ofrimit të “shërbimeve të sigurisë” për klientët e tyre.⁸⁴

Siç u tha në hyrje, privatizimi i sektorit të sigurisë u zhvillua me shpejtësi në periudhën menjëherë pas luftës, duke përfshirë pjesë të ndryshme të shoqërisë. Në Kosovë ekzistonte një vakum në periudhën menjëherë pas luftës, duke nënkuptuar kështu se sektori privat i sigurisë nuk ishte i rregulluar dhe si rezultat ishte i pakontrolluar dhe pamonitoruar. Prandaj, deri në vitin 2000 administrata e UNMIK-ut mori masa dhe miratoi aktin e parë për rregullimin e këtij sektori në Kosovë.

⁸¹ Ibid. Megjithatë ky raport nuk mund të dëshmojë këtë me të dhëna të sakta përveç se me mendimin e ekspertit.

⁸² Ramadan Qehaja, Drejtor i QKSS, Kjo është paraparë me Ligjin për vetëmbrojtjen civile.

⁸³ Ibid.

⁸⁴ Rasti më i spikatur në rajon është Serbia. Shih “*Kompanitë private të sigurisë në Serbi – Mike apo armike?*”, Fq.49 – CCMR, Beograd, 2007.

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/33 për licencimin e ofruesve të shërbimeve të sigurisë në Kosovë dhe rregullimin e punonjësve të tyre është një akt dyfaqësh, i cili e ka rregulluar sektorin privat të sigurisë deri në ditën e sotme. Si një Rregullore shumë e shkurtër, ajo më shumë ishte e dedikuar për kontrollimin e angazhimit të ndonjë strukture paraushtarake në këto kompani sesa në rregullimin e funksionimit të duhur të këtij sektori. Ajo rregullonte kushtet e licencimit dhe procesin e licencimit të KPS-ve dhe punonjësve të tyre, në mënyrë që ato të zhvillojnë aktivitetet e tyre. Ajo përcakton se çdo biznes vendor dhe ndërkombëtar që ofron shërbime të sigurisë në Kosovë duhet të licencohet nga Departamenti i UNMIK-ut.⁸⁵

Neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut rregullon proceset e licencimit të KPS-ve, kontrollimin e biografisë (verifikimin) e çdo individit të përfshirë në KPS dhe, që konsiderohet më me rëndësi – ndalimin e posedimit të armëve nga KPS-të vendore si dhe nga kompanitë rajonale, siç janë ato nga vendet e ish-Jugosllavisë dhe vendet fqinje. Vetëm personelit ndërkombëtar i lejohet të posedojë armë.⁸⁶ Fakti se vetëm personelit ndërkombëtar i lejohet të posedojë armë është parë si masë mbrojtëse për të parandaluar armatimin e popullsisë në Kosovë dhe për dekurajimin e krijimit të grupeve të organizuara paraushtarake që do të mund të destabilizonin gjendjen e sigurisë në Kosovë dhe më gjerë. Por në anën tjetër, ajo i jepte përparësi KPS-ve ndërkombëtare si të vetmet kompani që lejohen të posedojnë armë duke pasur kështu kapacitetin të ofrojnë shërbime shumë të rëndësishme, siç janë ofrimi i shërbimeve të sigurisë për bankat dhe transportimin e parave.⁸⁷

Në këtë Rregullore nuk ekziston ndonjë rregull sa i përket truprojave të armatosur dhe kjo rregullohet vetëm përmes Rregullores së UNMIK-ut 2001/7 për autorizimin e armëve në Kosovë, e cila parasheh që një personi që vlerësohet nga Komisioni për Vlerësimin e Kërcënimit (KVK) si i rrezikuar mund t'i jepet Kartela e Autorizimit për Armë (KAA) dhe truprojës së tij nëse kjo i rekomandohet KAA-së nga KVK-

⁸⁵ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/33 për licencimin e ofruesve të shërbimeve të sigurisë në Kosovë dhe rregullimin e personelit të tyre, neni 1.

⁸⁶ Ibid, neni 2.

⁸⁷ Kjo më shumë është konsideruar si monopol.

ja.⁸⁸ Për ta thjeshtuar, Rregulloret e UNMIK-ut 2000/33 dhe 2001/7 nuk i rregullojnë aspektet thelbësore të funksionimit të KPS-ve. Si rezultat i kësaj, vlerësohet se ekziston një nevojë e menjëhershme për rirregullimin e kësaj fushe në kuadër të legjislacionit të ri gjë që do të përmirësonte pozitën e KPS-ve. Përveç kësaj, një rregullore e tillë duhet të rregullojë aspektet e të punësuarve, raportet mes KPS-ve dhe klientëve të tyre, etj.

Në fillim të vitit 2007, MPB-ja themeloi një grup punues për hartimin e Projektligjit për sigurinë private, të kryesuar nga përfaqësuesi i MPB-së, pjesë e të cilit ishin edhe përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës – Komisionit për siguri, përfaqësuesi i OSBE-së dhe po ashtu edhe përfaqësuesit nga shoqatat e KPS-ve. Është sugjeruar që ky ligj të jetë në pajtim me legjislacionin e shteteve anëtare të BE-së, dhe ky grup punues është fokusuar në modelin slloven si vend anëtar i BE-së dhe si shtet i ish- Jugosllavisë, i cili mund të ketë gjendjen në këtë fushë shumë të ngjashme me atë të Kosovës. Ky projektligj i rregullon shërbimet në sektorin privat të sigurisë në përgjithësi; ato që nuk janë pjesë e institucioneve shtetërore. Ai kishte për qëllim të rregullonte procesin e licencimit të KPS-ve, të drejtën për tu licencuar, kushtet për ushtrimin e aktiviteteve, kualifikimet profesionale, strukturimin e KPS-ve, autorizimet, përdorimin e forcës, pajisjet personale dhe posedimin e armëve, bashkëpunimin me policinë, çështjen e kartelave të identifikimit, kushtet minimale për ofrimin e sigurisë, mbikëqyrjen nga inspeksioni, hetimet dhe dëshmitë në lidhje me shkeljet e supozuara të bëra nga KPS-të, si dhe afatet kohore për ruajtjen e të dhënave, dhe në fund dispozitat ndëshkuese.⁸⁹

KPS-të e pranuan këtë projektligj në masë të gjerë, prandaj u konsiderua si bazë e mirë për rregullimin e këtij sektori. Ishte perceptim i përbashkët se përmes rregullimit të hollësishëm të disa dimensioneve me legjislacion sekondar mund të mbushen disa zbrazëti.⁹⁰ Ky draft po ashtu u vlerësua mirë edhe për shkakun se ai parashihte edhe ofrues të tjerë të shërbimeve

⁸⁸ *Rregullorja e UNMIK-ut 2001/7 për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë, neni 2.*

⁸⁹ *Shih Projektligjin për sigurinë private në Kosovë.*

⁹⁰ *Drafti parashikonte legjislacionin sekondar për pjesët kyçe, si përdorimi i forcës, dispozitat ndëshkimore, etj.*

në sektorin privat të sigurisë, siç janë rojet individuale private dhe të tjerët që nuk janë pjesë e institucioneve për zbatimin e ligjit.

Ky projektligj i është nënshtruar ndryshimeve të mëdha duke filluar që nga titulli i tij. Për ta thjeshtuar, titulli “Projektligji për sigurinë private” është modifikuar në “Projektligji për kompanitë private të sigurisë” dhe është pasuar me modifikime në dispozitat e përgjithshme duke zvogëluar kështu grupin e synuar për të rregulluar vetëm KPS-të dhe duke përjashtuar ofruesit e tjerë të sigurisë jashtë fushëveprimit të këtyre kompanive.⁹¹ Këto modifikime themelore dhe mospajtimet në lidhje me çështjen e posedimit të armëve bën që drafti t’i kthehet sponsorit të ligjit (MPB) për rihartimin e tij.⁹²

Ligji duhet të hartohet dhe miratohet nga Kuvendi sa më parë që të jetë e mundur. Rregullimi i kësaj çështjeje me ligj është me rëndësi të veçantë dhe nuk mund të arsyetohen shtyrjet e mëtejshme. Ligji në disa raste duhet të pasohet me legjislacion sekondar, si p.sh: për posedimin e armëve, kodin standard të mirësjelljes në treg dhe të drejtat e të punësuarve.

2.3 Rregullimi i tregut të sigurisë private

Zhvillimi i politikave dhe organet zbatuese duhet të sigurohen që të plotësojnë dhe të sanksionojnë aty ku ka mundësi hapësirat ligjore të cilat pa dashje mund të krijojnë nxitje për të shkaktuar “rreziqe të pakuptueshme” ose krime të cilat do të rrisnin kërkesën për shërbime private të sigurisë. Teorikisht, ekziston një rrezik moral kur është fjala për misionin e kompanive private të sigurisë. Derisa në parim ato synojnë të ofrojnë siguri, është mjaft jo e arsyeshme të synohet arritja e një niveli më të ulët të shkallës së krimit. Prandaj, korniza e politikave duhet të trajtojë këtë çështje me kujdesin më të madh. Në anën tjetër, autoritetet rregulluese dhe monitoruese duhet të sigurohen që individët

⁹¹ *Projektligji për kompanitë private të sigurisë.*

⁹² Intervistë me Emrush Xhemajlin, deputet i Kuvendit të Kosovës, Komisioni për çështje të brendshme dhe siguri, 16.01.2009; Duke marrë parasysh se edhe emri i ligjit është modifikuar bashkë me dispozitat e përgjithshme projektligji duhet t’i kthehet prapa sponsorit.

të mos shfrytëzojnë pa pagesë shërbimet e ofruara nga kompanitë private të sigurisë dhe të përfitojnë nga ndikimi pozitiv i jashtëm që e krijon prania e KPS-ve. Po ashtu, kjo mund të bëhet çështje kundërthënëse – KPS-të me qëllim mund të tolerojnë dhe të mundësojnë grabitjet e bizneseve që janë në pronësi të këtyre shfrytëzuesve të pagesë të shërbimeve.

Ndonëse infrastruktura e tanishme ligjore i përcakton deri në një masë argumentet për dhe kundër që kryesisht kanë të bëjnë me dimensionin e sigurisë, politikave u mungon dimensionin ekonomik. Siç është rasti me transaksionet e tjera ekonomike, edhe sektori privat i sigurisë duhet të ketë blerësin dhe shitësin. Me sa duket, *dora e padukshme* në industrinë e sektorit privat ballafaqohet me një numër mangësish. Që nga nevoja për të siguruar konkurrencë të drejtë, deri te shkëmbimi ekonomik dypalësh, kontratat, evazoni fiskal dhe përgjegjësia shoqërore e korporatave të gjithë kërkojnë intervenimin e *këmbës së padukshme* – organeve zbatuese.

Tregu gjithnjë në rritje i sigurisë private kërkon trajtim të drejtë të të gjithë agjentëve, konkurrencë të drejtë, qasje në informacione dhe, ku është e aplikueshme, tua mundësojë atyre që vazhdimisht të përmirësojnë shërbimet e tyre për konsumatorët. Siç e theksojnë një numër i personave të anketuar, Qeveria duhet të merret seriozisht me korrupsionin në këtë industri, veçanërisht për shkak të ndjeshmërisë së kësaj çështjeje. Kompanitë private të sigurisë kanë raportuar një numër të pengesave administrative me të cilat ata ballafaqohen kur është fjala për regjistrimin dhe licencimin e punëtorëve të tyre, gjë kjo që mund të stimulojë evazionin fiskal. Sipas raporteve, pothuaj asnjë prej kompanive private të sigurisë nuk i përmbushin kushtet e Ligjit për punësim. Me disa përjashtime, kompanitë nuk i binden asnjë parimi bazë të përgjegjësive shoqërore të korporatave. Diskutimet me informuesit kryesorë zbuluan se pjesëtarët e KPS-ve shpesh nuk regjistrohen, atyre nuk u ofrohen kontrata punësimi dhe u mungojnë njohuritë themelore për shkallën e pagesës.

Një numër i kompanive po bëjnë përpjekje që të fitojnë pjesën e tyre në treg, nganjëherë duke ofruar çmime që janë nën nivelin e nevojës për faktorët ose rezultatet e kënaqshme. Kostoja e shërbimeve ka pësuar një ulje të madhe, pjesërisht për shkak të mbingarkesës me fuqi punëtoresh dhe mundësive të rralla. Ekspertët për çështje të sigurisë dhe ofruesit e tjerë kryesorë të informatave kanë nënvizuar mospërputhjet që ekzistojnë

në mes të Ligjit të prokurimit dhe Ligjit për punësim – sipas këtyre të fundit kompanitë me ofertat më të ulëta financiare ka gjasa që të jenë edhe fituese, që vetvetiu i shtyn kompanitë që të konkurrojnë me kushtet që janë nën kushtet e përcaktuara në Ligjin për punësim dhe parimet e përgjegjësishë shoqërore të përshkruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

2.4 Kërkesa e tregut pas shpërbërjes së Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK)

TMK-ja është krijuar në vitin 1999 nga bashkësia ndërkombëtare. Ajo zyrtarisht është themeluar më 21 janar 2000 si subjekt ligjor që bënte pjesë në kuadër të kompetencave të rezervuara të PSSP-së. Zanafilla e TMK-së gjendet në “Marrëveshjen për çmilitarizimin dhe çmobilizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”⁹³, të nënshkruar ndërmjet udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe komandantit të Forcës së NATO-së në Kosovë (KFOR). Një pjesë e madhe e personelit të TMK-së vinin nga radhët e ish-UÇK-së⁹⁴, të cilët, si pjesë e kësaj marrëveshje, u zotuan për dorëzimin e armëve. E krijuar sipas modelit francez të *Sécurité Civile*, TMK-ja e kishte për detyrë të mbrojë popullsinë e Kosovës kundër fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu, si dhe të ndihmojë në rindërtimin e Kosovës. Sipas Pakos së Ahtisarit për zgjidhjen e statusit të Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) duhet të shpërbëhen për t'i hapur rrugën krijimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Derisa procesi i krijimit të forcës së re është duke përparuar, vlerësimet e planifikimit dhe raportet zyrtare tregojnë se deri në 1800 prej gjithsej 2883 pjesëtarëve aktivë të TMK-s mund të kenë nevojë për ndihmë në gjetjen e ndonjë pune tjetër si civilë. Aleanca e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) e ka ngarkuar Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me detyrën që të udhëheq një program të ri-sistemimit të ish-pjesëtarëve të TMK-së. Programi i Ri-sistemimit të pjesëtarëve të

⁹³ Në vitin 1999, ishte llogaritur se ka pasur rreth 22.000 pjesëtarë të UÇK-së.

⁹⁴ Numri i tanishëm i pjesëtarëve të TMK-së që janë ish-pjesëtarë të UÇK-së llogaritet të jetë në 70 %.

TMK-së⁹⁵, i paraparë për ata pjesëtarë të TMK-së të cilëve u duhet mbështetje për të kaluar në mënyrën e jetesës pas TMK-së, është rezultat i punës së tyre. Edhe pse TMK-ja kishte rol të emergjencës civile, ajo ishte e organizuar në formë ushtarake në strukturën e gradimit, organizim dhe uniforma. Duhet theksuar se ndonëse TMK-ja kurrë nuk ishte paraparë nga administrata ndërkombëtare që të shërbejë përtej mandatit të saj si forcë civile emergjente, ajo nga popullsia shumicë konsiderohej si trashëgimtare e UÇK-së. Kjo ka bërë që përkrahja e qytetarëve për TMK-në të tejkalojë çdo institucion tjetër në Kosovë.

Procesi i Rekrutimit, Verifikimit dhe Përzgjedhjes (RVP) për t'iu bashkuar Forcës së Sigurisë së Kosovës do të përcaktojë ata individë që nuk do të përfshihen në forcën e re, qoftë duke mos i plotësuar kriteret për rekrutim, duke mos plotësuar nevojat e shërbimit ose duke mos pasur sukses në përmbushjen e standardeve të nevojshme gjatë trajnimit. Këta individë, bashkë me ata që vendosin vullnetarisht të mos i bashkohen Forcës së re, kanë të drejtë të regjistrohen në Programin e ri-sistemimit të pjesëtarëve të TMK-së. Edhe pse NATO dhe UNDP kanë paralajmëruar një proces të shëndoshë të ri-sistemimit, mbetet të shihet se si ish-pjesëtarët e TMK-së do të integrohen në tregun e punës. Kuptohet, procesi i ri-integrimit të individëve me biografi të gjatë në frymën ushtarake mund të jetë relativisht i ndërlikuar. Një numër i kompanive private të sigurisë raportojnë se u janë afruar menaxhmentit të mëhershëm të TMK-së për tu ofruar atyre punë në këtë industri, të cilën ata e kishin refuzuar në mënyrë të fuqishme.⁹⁶ Siç ishte rasti me ish-pjesëtarët e UÇK-së, një numër i tyre ka gjasë që të kërkojnë të përdorin aftësitë e tyre në industrinë private të sigurisë. Sipas planeve ekzistuese nuk parashihet mbështetja e ndonjë përpjekjeje kolektive për sistemimin e ish-pjesëtarëve të TMK-së.

⁹⁵ *Ri-sistemim* është shprehje më e përshtatshme për tu përdorur në Kosovë, shih Programin e Ri-sistemimit UNDP.

⁹⁶ Intervistë me Abedin Hasanin, drejtor i kompanisë Besa Security, 09.01.2009.

3. Puna e kompanive private të sigurisë në Kosovë

Industria e sigurisë private në Kosovë konsiderohet një nga zhvillimet më të rëndësishme në periudhën e pasluftës. Edhe pse janë perceptuar si shërbime të qarta të biznesit, kontributi i tyre në krijimin e një mjedisi më të sigurt është i pamohueshëm dhe meriton një respekt të veçantë.⁹⁷ Në të vërtetë akterët e sigurisë private mund të japin një kontribut të çmueshëm në ofrimin dhe në përpjekjet për siguri brenda një shteti.⁹⁸ Madje, zgjerimi i industrisë së sigurisë private i jep fund monopolit të shtetit mbi sektorin e sigurisë si rezultat i kërkesave tepër të mëdha në treg për mbrojtjen e pronave.

Nga pikëpamja e sigurisë, prania dhe zhvillimi i vazhdueshëm i KPS-ve në Kosovë kontribuon në përpjekjet e përbashkëta për sigurimin e një mjedisi më të sigurt në vend. Kur KPS-të kryejnë detyrat statike të ruajtjes së pronave private dhe publike, kjo e shkarkon policinë e shtetit nga detyrat e kushtueshme dhe mjaft të rënda.⁹⁹ Numri i pjesëtarëve të policisë së shtetit nuk duhet të rritet si rezultat i rritjes së numrit të rojeve të sigurisë privat. Kohëve të fundit, Njësia e Policisë së Kosovës për ruajtjen e institucioneve publike është shpërbërë dhe tani atyre u është caktuar të kryejnë një kurs themelor të aftësimin në Qendrën Kosovare për Siguri Publike për tu bërë pjesë e njësive të rregullta të policisë.¹⁰⁰ Argumenti për shpërbërjen e kësaj njësie mund të jetë i thjeshtë – nuk ekziston as edhe një arsye e vetme për të vazhduar me këto shërbime të ruajtjes për shkak të mundësisë së angazhimit të ndonjë kompanie private të sigurisë për këtë gjë. Megjithatë, kjo nuk e përjashton rolin e pashmangshëm të policisë në detyrat e ndjeshme që janë të përcaktuara vetëm për mekanizmat për zbatimin e ligjit.

⁹⁷ Shih konstatimet sasiore. Në pyetjen për kontributin e KPS-ve në uljen e nivelit të kimit shumica u përgjigjen pozitivisht. Po ashtu ekziston një qëndrim i përbashkët se prania e KPS-ve kontribuon në një mjedis më të sigurt.

⁹⁸ Anna Richards dhe Henry Smith, *Trajtimi i rolit të kompanive private të sigurisë në kuadër të programeve për reformimin e sektorit të sigurisë*, Gazeta e Menaxhmentit të Sektorit të Sigurisë, 2007.

⁹⁹ Intervistë me Agim Musliun, *South East Europe Security*, 12.01.2009.

¹⁰⁰ Kjo njësi përbëhet nga prej 500 deri në 600 pjesëtarë.

3.1 Organizimi, përzgjedhja dhe verifikimi

Shumica e KPS-ve në Kosovë kanë pasur përvojë të mëhershme në institucionet publike të sigurisë. Ata që kanë pasur përvojë në strukturat ushtarake ose të sigurisë kanë qenë në gjendje të sqarojnë më lehtë “zinxhirin komandues” të organizatës. KPS-të kryesore kanë skema organizative. Kompania e tanishme ndërkombëtare paraqiti një zinxhir logjik të funksionimit që është në përputhje me çdo shërbim bashkëkohor të sigurisë private.¹⁰¹ Edhe kompanitë e tjera lokale theksuan se kanë një strukturë të qartë të hierarkisë. Sipas hulumtimit, zinxhiri drejtues varet nga numri i përgjithshëm i punëtorëve të KPS-së si dhe nga numri i rojeve që janë të pranishëm në terren. Në mënyrë tipike, ato e përdorin metodën e “pikave” për të strukturuar operacionet e tyre – që ndryshojnë varësisht prej distancës së këtyre pikave në terren dhe rëndësisë së një pike të caktuar. Për shembull, një mbikëqyrësi mund t’i caktohet detyra e menaxhimit të një pike të rëndësishme, ose disa pikave më pak të rëndësishme që janë afër njëra-tjetrës. Ky mbikëqyrës pastaj i raporton direkt drejtorit ose shefit të KPS-së. Zakonisht është edhe një zyrtar kujdestar, veçanërisht gjatë ndërrimit të natës.

Duhet brengosur për profesionalizmin në nivelin e menaxhmentit. Përveç për ata që kanë përvojë ushtarake ose përvojë tjetër në fushën e sigurisë, ekziston një shqetësim për mundësin e angazhimit të individëve me përvojë të pamjaftueshme në siguri. Megjithatë, kjo nuk e përjashton përvojën që shumica e tyre e kanë fituar gjatë kohës sa kanë shërbyer në KPS të ndryshme. Çka është më se e qartë, menaxhmenti mund të drejtohet nga individë të punësuar në bazë të besueshmërisë por jo në bazë të përvojës së tyre. Kjo mund të ndodh si pasojë e përzgjedhjes jo të duhur, veçanërisht për pozitat e larta. Infrastruktura ekzistuese ligjore nuk i ka paraparë kushtet për kualifikimet përkatëse të pronarit si dhe për zyrtarët e lartë të KPS-ve. Bazuar në projektligjet, infrastruktura e re ligjore mund të vë si kusht kualifikimin përkatës për pozitat e larta. Megjithatë, procesi i përzgjedhjes domosdoshmërisht duhet t’i nënshtrohet kontrollit të rreptë dhe të hollësishëm.

KPS-të duhet t’i raportojnë policisë kur e punësojnë ndonjë punëtor të ri të sigurisë. Ata marrin përgjigje sapo policia të bëjë kontrollin e biografisë

¹⁰¹ Henderson.

së tij/saj (verifikimin). Kjo përfshinë ndonjë të kaluar të mundshme kriminale të personit pavarësisht se a e ka përfunduar ai procesin e socializmit pas vuajtjes së dënimit, se a ka mundësi për aktivitete të korrupsionit, etj. Për qëllime të këtij dokumenti, verifikimi është një proces me të cilin individët verifikohen për qasje në të drejta dhe detyra praktikisht për të gjitha pozitat në qeveri dhe biznese.¹⁰² Edhe në sektorin e sigurisë private ky verifikim është i pashmangshëm.

3.2 Posedimi i armëve

Çështja posedimit të armëve është shumë kundërthënëse, e ndjeshme dhe e ndërlikuar. Ajo ndryshon nga një vend në tjetrin, megjithatë, në Kosovë për momentin vetëm një kompani ndërkombëtare mban armë të zjarrit.¹⁰³ Legjislacioni i tanishëm ka përjashtuar të drejtën e kompanive lokale që të aplikojnë për armë të vogla përkundër kërkesave të mëdha për këtë. Kjo e forcoi monopolin e kompanive ndërkombëtare pasi që ishte e pamundur që kompanitë vendore të ofrojnë dhe të fitojnë tenderët për disa shërbime; veçanërisht për transportin e parave për nevoja të bankave komerciale. Për ta thjeshtuar, kompanitë vendore janë përjashtuar në mënyrë automatike nga ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes, veçanërisht për bankat ndërkombëtare.

Ligji i ri do t'i jap fund përfundimisht këtij monopoli dhe do t'i mundësojë edhe KPS-ve vendore të aplikojnë për leje dhe autorizime për armë. Ky hulumtim konstatoi mospërputhje ndërmjet kërkesave të KPS-ve dhe hartuesve të ligjit për rastet e posedimit të armëve. Legjislacioni i ardhshëm qartazi dhe shprehimisht do të parashikojë posedimin e armëve vetëm për dy qëllime: transportimin e parave për nevoja të bankave dhe trupat private.¹⁰⁴ Kufizimet në posedimin e armëve përputhet me nevojën për të shmangur pasojat e mëtejshme ose keqpërdorimin e armëve. Nuk duhet harruar rojet e sigurisë që punojnë dhe përdorin qentë. Përkundër faktit se edhe këta roje duhet të trajnohen, qeni mund të përdoret si armë dhe me sukses mund të mposht çdo rrezik të mundshëm ose sulm kundër pronës ose individit që është nën përgjegjësinë e KPS-së. Megjithatë qeni mund të jetë

¹⁰² DCAF, *Verifikimi dhe sektori i sigurisë*, 2006.

¹⁰³ Henderson

¹⁰⁴ Bazuar në diskutimet me palët përkatëse me interes..

përgjegjësi më me rrezik dhe duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë, ngjashëm me atë që u kushtohet qenve të policisë.

Në anën tjetër, KPS-të janë mjaft të kënaqura me ligjin e ri të ardhshëm¹⁰⁵ dhe me lejimin e posedimit të armëve, por kufizimi i tij në vetëm dy qëllime konsiderohet të jetë i papranueshëm nga shumica prej tyre.¹⁰⁶ Argument për këtë janë pronat e ashtuquajtura me “rëndësi strategjike” siç janë Penda e liqenit, KEK-u ose pronat e tjera. Ata citojnë skenarin e “sabotimit” ose sulmit kundër tyre kur ato nuk kanë mundësi të luftojnë në mënyrë efektive kundër kërcënimit pa pasur armë. Megjithatë, ekziston edhe mundësia e kombinimit të sigurisë publike dhe asaj private për mbrojtjen e këtyre pikave të rëndësishme,¹⁰⁷ por kjo nuk është aq bindëse për pronarët e KPS-ve. Disa KPS kanë shkuar aq larg sa të sugjerojnë që edhe “patrullat e sigurisë duhet të mbajnë armë si edhe rojet e sigurisë që rrinë brenda në banka”. Ata gjithmonë i bazojnë argumentet e tyre duke ju referuar vendeve fqinje dhe vendeve të tjera të rajonit.¹⁰⁸

Duke marrë parasysh pasojat dhe keqpërdorimet e mundshme, gjatë hartimit të ligjit kësaj çështjeje duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë. Duhet të ketë kufizime për mënyrën e përdorimit të armëve dhe nuk duhet lënë hapësirë për interpretime ligjore. Këto kufizime do të rishikohen në të ardhmen që ato të lejohen për më shumë qëllime, nëse nuk ka shkelje të mëdha dhe keqpërdorime në 3-5 vitet e ardhme. Është e nevojshme që të ekzistojë një procedurë e verifikimit për mbajtësit e armëve dhe duhet të garantohet një mbikëqyrje e rreptë. Po ashtu armët që mbahen për këto qëllime duhet të barten gjatë kryerjes së detyrave të përditshme dhe të kthehen menjëherë në depo.

¹⁰⁵ Veçanërisht në leximin e parë.

¹⁰⁶ Gjatë debateve të grupeve të fokusuara, shumica e drejtorëve ose pronarëve të KPS-ve shprehën dëshirën për të mos e kufizuar vetëm për këto dy qëllime.

¹⁰⁷ Intervistë me Emrush Xhemajlin, anëtar i Kuvendit të Kosovës, Komisioni për punë të brendshme dhe siguri, 16.01.2009

¹⁰⁸ Ata zakonisht i referoheshin rastit të Bullgarisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë.

3.3 Përdorimi i forcës

Mbrojtja e pronës ose individëve mund të paraqes situata të rrezikshme prandaj kërkohen reagime efektive nga rojet private të sigurisë. Rojet e sigurisë mund të ballafaqohen me sulme të drejtpërdrejta kundër pronës ose individit që është nën mbrojtjen e tyre. Në këto rrethana, është e paqartë se si do të reagojë KPS-ja për të siguruar mbrojtjen në raste të tilla. Rregullorja e tanishme dhe ligji i ardhshëm parashohin përdorimin e forcës nëse nuk ka ndonjë mënyrë tjetër për të ndalur personat e paautorizuar. Kjo përfshinë përdorimin e forcës fizike siç është shkopi i policisë ose prangat për t'iu kundërvënë çfarëdo sulmi të drejtpërdrejtë.

Aplikimi i parimit të proporcionalitetit është i pashmangshëm për të evituar shkeljen e mundshme të të drejtave të njeriut përmes përdorimit të forcës. Ligji nuk mund të paraqes në hollësi se si duhet respektuar ky parim, megjithatë legjislacioni sekondar ka mundësi të jetë më i qartë. Forca mund të përdoret në raste të caktuara dhe kur është e nevojshme vetëm për aq sa kërkohet që të shmanget rreziku i mundshëm. Thënë më thjeshtë, përdorimi i forcës ushtrohet vetëm për të arritur sigurinë legjitime me pasojat më të vogla të dëmshme. Në rast të sulmit të armatosur kur mbrohet një VIP ose gjatë transportimit të parave përdorimi i armëve nga rojet private të sigurisë bëhet vetëm për të mbrojtur perimetrin e përgjegjësisë së tyre dhe ata nuk mund të ndër marrin kundërsulm pasi që kjo do të dilte jashtë proporcionalitetit. Policia duhet të informohet sa më parë që të jetë e mundur për përdorimin e forcës.

Rojet private të sigurisë lejohen të përdorin forcën kur e mbajnë një sulmues dhe më vonë kur ua dorëzojnë atë autoriteteve të policisë. Megjithatë, legjislacioni i ri nuk e kufizon në mënyrë të qartë periudhën e ndalimit nga rojet private të sigurisë, duke u dhënë KPS-ve shumë autorizime krahasuar me policinë.¹⁰⁹ Hulumtimi ka konstatuar vështirësi për të marrë të dhëna për shkeljet dhe veprat e kryera nga KPS-të. Këto të dhëna konsiderohen si mungesë e transparencës nga autoritetet përkatëse. Shpërndarja e informatave për rastin shkeljes së rëndë nga ana e një KPS-je ishte përjashtim. Kohëve të fundit, menaxheri i një KPS-je

¹⁰⁹ Intervistë me Agim Musliun, South East Europe Security, 12.01.2009. Kjo deklaratë lidhet me përcaktimin e mundshëm të afatit kohor në ligjin e ri për mbajtjen e sulmuesve.

përdori forcë joproportionale duke i shkaktuar lëndime serioze një personi.¹¹⁰ KPS-ja u mbyll menjëherë nga autoritetet publike.

3.4 Pajisjet dhe aftësimi

Shumica e KPS-ve në Kosovë u kushtojnë më shumë rëndësi pajisjeve dhe teknologjisë. Përdorimi i teknologjisë mundëson mbrojtjen e pronave, është më e lirë dhe shmang praninë e panevojshme statike të rojeve të sigurisë. Të gjitha KPS-të posedojnë radiolidhje me qëllim të komunikimit të brendshëm në mes të patrullave në terren dhe zyrës qendrore të kompanisë. Instalimi i alarmeve dhe detektorëve konsiderohet i dobishëm dhe pothuaj 100% i suksesshëm. KPS-të janë duke u ballafaquar me një kërkesë gjithnjë në rritje për instalimin e alarmeve dhe pajisjeve të tjera teknologjike për mbrojtjen e pronave e jo praninë statike të rojeve të sigurisë. Instalimi i kamerave po ashtu është gjithnjë e më i kërkuar nga sektori privat. Megjithatë, mbulimi me kamera efikase CCTV për momentin nuk është në nivelin e kënaqshëm në Kosovë.¹¹¹

E vetmja pengesë për këtë është çmimi i lartë i kësaj teknologjie prandaj ajo instalohet vetëm në disa zona të caktuara. Edhe monitorimi përmes kamerave kërkon individë profesionistë të aftësuar vetëm për këto qëllime. Legjislacioni i ri parasheh një aftësim të veçantë për këtë. Gjatë këtij hulumtimi disa nga pronarët e KPS-ve përmendën se në disa vende, si p.sh bankat, angazhonin punëtorët e vet për monitorimin e kamerave. Madje, gjatë ofertimit për kontrata, disa kompani kishin kërkuar numër më të vogël i kamerave dhe pajisjeve të tjera plotësuese se ai që rekomandohet vetëm për të shmangur shpenzimet për sigurinë.¹¹² Në të vërtetë kjo edhe e përcakton garancinë për mbrojtjen e pronës.

Bazuar në legjislacionin e tanishëm, KPS-të janë të obliguara të organizojnë së paku aftësimin themelor për rojet private të sigurisë. KPS-të më të mëdha në Kosovë kanë krijuar qendrat e trajnimit duke

¹¹⁰ KPS-ja e quajtur “Vetmbrojtja” është mbyllur në fund të vitit 2007. Të dhënat zyrtare, Njësia e Policisë së Kosovës për Inspektimin e KPS-ve.

¹¹¹ KPS-të që shesin pajisjet theksuan se ka kërkesa për lloje të tjera të kamerave dhe për shumë pak CCTV. Shumica e tyre janë instaluar në banka dhe në ndërtesa të tjera të rëndësishme.

¹¹² Intervistë me Bahri Arifin, drejtor i “Delta Security”, 18.01.2009.

investuar në këtë çështje.¹¹³ KPS-të e tjera më të vogla shfrytëzojnë qendrat e aftësimit të kompanive të mëdha, ndërsa një pjesë e tyre angazhon trajnerë vetëm për këto qëllime. Po ashtu nuk ka shënime të qarta për përmbushjen e detyrimeve për organizimin e këtyre trajnimeve. Kjo ngjall dyshimin e mundshëm për cilësinë e këtyre trajnimeve dhe për mungesën e mbikëqyrjes. Ekziston një përceptim i përbashkët për ripërsëritjen e trajnimeve dhe sipas të gjitha gjasave organizimin e trajnimeve të veçanta varësisht prej detyrave.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet aftësimin për tu marrë dhe për të përdorur armët dhe qentë. Nga perspektiva profesionale, aftësimi për përdorimin e armëve duhet të zhvillohet paralelisht me aftësimin e policisë. Para aftësimeve individët duhet t'u nënshtrohen procedurave të verifikimit të përcaktuara nga institucioni përkatës. Leja nga organet e sigurisë është parakusht për të drejtën për tu aftësuar dhe më vonë për të përdorur armë. Për këtë çështje rekomandohet një periudhë minimale e aftësimit intensiv prej tre muajsh.¹¹⁴ Megjithatë, pyetja që mund të shtrohet është se cila është qendra më adekuate e aftësimit për këtë qëllim. E vetmja qendër e specializuar që përfshinë të gjitha objektet e nevojshme si poligonet dhe të tjerat është Qendra Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (KCPSED).

Ekziston një frikë se ky inatitucion mund të jetë i stërngarkuar dhe se nuk do të jetë në gjendje të plotësojë nevojat për aftësimin e KPS-ve. Argumenti qëndron në rolin gjithnjë e më të madh që ka qendra për të trajnuar edhe mekanizmat e tjerë të sigurisë. Për momentin, KCPSED organizon aftësime për armët e zjarrit për Shërbimin Korrektues, Doganat dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Përveç kësaj, kjo qendër ofron trajnime për shërbimet e gatishmërisë emergjente. Në këtë mënyrë, ndonjë alternativë e mundshme do të ishte e mirëseardhur sepse do të shmangte burokracinë e paevitueshme dhe vonesat për aftësimet për armët e zjarrit. Ngjashëm, edhe trajnimet për punëtorët me qen duhet të mbahen në KCPSED në pajtim me planprogramin e policisë.

¹¹³ Veçanërisht WDG dhe Balkan Security.

¹¹⁴ Kështu ka theksuar edhe Agim Musliu.

3.5 Përfshirja e të drejtave të njeriut në operacionet e kompanive private të sigurisë

Ky hulumtim i kushtoi vëmendje të veçantë çështjes së të drejtave të njeriut të KPS-ve. Ai i kushtohet të drejtave të punëtorëve dhe ekuilibrit gjinor. Me disa përjashtime, shkelja e të drejtave të punëtorëve në KPS është e shpeshtë. Duke filluar nga koha e punësimit, në mënyrë paradoksale në shumicën e KPS-ve punëtorët paguajnë për uniformat. Për më tepër, disa të punësuar duhet të blejnë uniformat¹¹⁵ dhe pastaj me siguri pas një periudhe të shkurtër përjashtohen nga puna pa pasur të drejtë që të kërkojnë dëmshpërblim për uniformën. Çështja e pagesës së uniformave është shkelje e të drejtave të njeriut. Ligji për punësim e thotë qartë se punëdhënësi është përgjegjës mes tjerash edhe që të sigurojë kushte të pranueshme të punës për të punësuarit. Kjo duhet domosdoshmërisht të rishikohet dhe nëse është e mundur të rregullohet me legjislacion sekondar.

Përveç kësaj, disa të punësuar merren në punë përkohësisht pa pagesë (deri në tre muaj) dhe pastaj përjashtohen pa kurrfarë arsytimi. Disa prej këtyre punëtorëve kishin kërkuar pagesat për muajt që kishin punuar, por në shumicën e rasteve nuk kishin pasur sukses t'i marrin.¹¹⁶ Kjo situatë e shfrytëzon nivelin e tanishëm të varfërisë dhe papunësisë në shoqëri. Për më tepër, disa kompani zbatojnë një “disiplinë” tepër të ashpër. Një prej ish-rojeve të sigurisë shkoi aq larg në vlerësimin e kësaj gjendjeje të disiplinës duke e barazuar atë me atë të *Legjionit francez të të buajve*.¹¹⁷ Në të vërtetë, kompanitë dhe institucionet e sigurisë kërkojnë një nivel të caktuar të disiplinës megjithatë kjo nuk duhet të shkel të drejtat e punëtorëve. Madje, kjo duhet të rregullohet dhe të punësuarit duhet të njoftohen për këtë gjë, që nuk ndodh në disa KPS në Kosovë. Në rast të shkeljes së këtyre rregulloreve, duhet të aplikohen ndëshkimet në formë të strukturuar dhe nuk duhet që ato menjëherë të jetë të drejtuara në shumën e pagës. Edhe dispozitat ndëshkimore duhet të rregullohen dhe t'i kalohen autoritetit përkatës publik. Kjo nuk duhet të konsiderohet se i përket ekskluzivisht KPS-ve pasi që të drejtat e punëtorëve dhe të drejtat e njeriut janë shqetësim i përgjithshëm.

¹¹⁵ Ketë na thanë drejtpërdrejtë disa drejtorë të KPS-ve.

¹¹⁶ Bazuar në diskutimet me disa ish-punëtorë të KPS-ve.

¹¹⁷ Intervistë me një prej ish-punëtorëve të KPS-ve.

Me shtimin e trendit të privatizimit të sigurisë dhe me rregullimin e kësaj sfere, përfshirja e gjinive do të përmirësonte në masë të madhe efektivitetin operacional në tërë këtë sektor dhe do t'i jepte kah pozitiv zhvillimit të tij në të ardhmen.¹¹⁸ Sa i përket përfaqësimit gjinor në Kosovë, KPS-të punësojnë një numër shumë të vogël të femrave. Ato kryesisht janë të angazhuara në administratë, në qendrat e monitorimit dhe shumë pak prej tyre në patrulla. Vetëm një kompani theksoi përfaqësimin e femrave prej 5%,¹¹⁹ të tjerat më pak ose shumica prej tyre nuk kanë fare femra të punësuar. Në vendet ku bëhet kontrolli fizik i individëve, siç janë ndeshjet sportive ose koncertet, legjislacioni i tanishëm kërkon domosdoshmërisht që kjo të bëhet nga roja i sigurisë i gjinisë përkatëse. Në këtë mënyrë disa femra janë ftuar në disa prej këtyre ngjarjeve. Është e qartë se çështja e ekuilibrit gjinor në mekanizmat e sigurisë është shqetësim i përgjithshëm dhe duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Angazhimi i femrave në ruajtjen statike në pika të rëndësishme, mbrojtje të afërt dhe për më tepër në përdorimin e armëve ka mundësi të konsiderohet si diçka e vështirë për tu arritur. Kjo nuk e përjashton mundësinë dhe aftësinë e femrave që të kryejnë edhe këto detyra por ekziston frika se ato nuk do të jenë në gjendje të reagojnë në mënyrë adekuate fizike kundër ndonjë sulmi të mundshëm. Disa prej klientëve madje ishin kategorik kundër angazhimit të femrave në KPS.¹²⁰

4. BASHKËPUNIMI DHE KOMUNIKIMI ME MEKANIZMAT PUBLIKË TË SIGURISË

Sektori privat i sigurisë nuk duhet të perceptohet thjeshtë vetëm si sektor komercial. Roli i tij është që të ofrojë mbrojtje fizike për pronat dhe mbrojtje të afërt për individët. Megjithatë, këto shërbime po ashtu bëjnë pjesë në kuadër të mandatit dhe misionit të mekanizmave publikë të sigurisë për rendin publik, sigurinë e njerëzve dhe qetësinë publike. Një pjesë e këtij hulumtimi u fokusua në çështjet e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet KPS-ve dhe institucioneve publike të sigurisë në Kosovë. Për këtë qëllim, vlerësimi i shkurtër në këtë aspekt ju referua dy mekanizmave të sigurisë: policisë dhe emergjencave civile.

¹¹⁸ Schulz Sabrina dhe Christina Yeung, *Kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë dhe gjinia*, DCAF, OSBE/ODHIR, UN INSTRAW 2008.

¹¹⁹ Henderson.

¹²⁰ Intervistë me Grant Cambridge, "Henderson", 13.01.2009.

4.1 Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës

Bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Kosovës dhe KPS-ve mund të konsiderohet si shumë i rëndësishëm. Në parim, është vështirë të injorohet bashkëpunimi i tanishëm ndërmjet mekanizmave privatë dhe publik të sigurisë pasi që ka argumente për gatishmëri dhe komunikim në terren. Në të vërtetë, KPS-të duhet t'i raportojnë policisë për çdo shkelje ose sulm kundër pronave pasi që ata janë të obliguar të bëjnë këtë sipas legjislacionit të tanishëm. Sidoqoftë, ende nuk ekziston ndonjë mekanizëm i cili do të ta bënte këtë bashkëpunim si detyrim ligjor. Ligji i ri mund të rregullojë bashkëpunimin, por është e qartë se jo në nivelin adekuat. Mënyra më e mirë do të ishte që Policia e Kosovës të nënshkruajë një MiM me KPS-të.¹²¹

Ky MiM do të parashikonte në mënyrë të veçantë aspektet e bashkëpunimit dhe komunikimit; në veçanti, shkëmbimi i informatave ka rëndësi të veçantë për mekanizmin e zbatimit të ligjit.¹²² Nga perspektiva profesionale, prania në terren e rojeve private të sigurisë mund tu mundësojë atyre të vëzhgojnë dhe të raportojnë lëvizjet e dyshimta të individëve, duke ndihmuar kështu në parandalimin e krimeve.¹²³ Bazuar në numrin e tanishëm të KPS-ve, prania e 1.200 – 1.400 rojeve të sigurisë gjatë një ndërrimi përbën një numër të konsiderueshëm dhe ata thjeshtë mund të plotësojnë mungesat në terren.¹²⁴

Nga perspektiva e KPS-ve, qëndrimi i tyre në këtë aspekt është i ngatërruar dhe është vështirë që të merret një qëndrim i përbashkët. Disa prej tyre e perceptojnë bashkëpunimin vetëm nga dimensionimi moral e jo në atë profesional dhe ligjor. Disa kompani theksojnë se rojeve private të sigurisë u lejohet të bashkëpunojnë me policinë në çdo rast, por ata nuk janë të obliguar të bëjnë këtë gjë.¹²⁵ Vërtetë, bashkëpunimi e rrit në mënyrë efektive suksesin në punë të të dyjave – edhe mekanizmave privatë edhe atyre publikë të sigurisë. Dhe këta dy akterë të sigurisë nuk duhet ta shikojnë njëri-tjetrin si konkurrentë. Praktika në vendet e tjera

¹²¹ Intervistë me Kolonel Rifat Marmullakun, shef i Departamenteve kundër krimit, Policia e Kosovës, 17.01.2009.

¹²² Ibid.

¹²³ Ibid.

¹²⁴ Ibid.

¹²⁵ Intervistë me Abedin Hasanin, drejtor i Besa Security, 09.01.2009.

ka dëshmuar se kjo është një fushë jashtëzakonisht problematike.¹²⁶ Kjo veçanërisht mund të ndodh nëse policisë dhe pjesëtarëve të tjerë të sigurisë publike nuk do tu ndalohej të punonin me KPS-të. Ligjet e reja për dy institucionet e tjera publike të sigurisë e ndalojnë rreptësisht angazhimin në sektorët e tjerë për ata që punojnë në këto institucione.¹²⁷ Ngjashëm, edhe Ligji i ri për KPS-të e ndalon angazhimin e KPS-ve në mekanizma të tjerë të sigurisë. Duhet të bëhet një inspektim rigoroz për tu siguruar që një individ të mos punojë në të njëjtën kohë për një mekanizëm privat dhe publik të sigurisë.

4.2. Bashkëpunimi me Emergjencat Civile

Bashkëpunimi me emergjencat civile është shumë i rëndësishëm. Veçanërisht në rastet e ndonjë zjarri në pjesën ku janë të pranishëm rojet e sigurisë KPS-të duhet të krijojnë një lidhje të drejtpërdrejtë të komunikimit me brigadën e zjarrfikësve për të evituar dëmet e mëtejshme dhe viktimat. Ky komunikim duhet të bëhet drejtpërdrejtë e jo përmes policisë. Çdo përpjekje për të komunikuar dhe për të kërkuar ndërhyrje nga ndonjë shërbim i emergjencës përmes policisë mund të shkaktojë joefektivitet, prandaj ata duhet të thërrasin drejtpërdrejtë 112-shin.¹²⁸ Ka qenë propozim i mençur që në rast emergjence të bëhet intervenimi i shpejtë i patrullës së KPS-së dhe nëse është e mundur që ajo të përdor dritën ngjyrë portokalli si sinjal.¹²⁹ Megjithatë, lejimi i mundshëm i dritës së portokalltë duhet t'i nënshtrohet një mbikëqyrje të rreptë dhe hetimit për abuzime. Madje, një rëndësi e madhe i kushtohet edhe komunikimit ndërmjet KPS-ve dhe shërbimeve mjekësore emergjente.

¹²⁶ Born Hans, Caparini Marina dhe Cole Eden, *Rregullimi i sigurisë private në Evropë; Statusi dhe e ardhmja*, 2007, DCAF Gjenevë.

¹²⁷ Shih *Ligjin për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligjin për policinë*.

¹²⁸ Numri i shërbimit të emergjencës.

¹²⁹ Intervistë me Bahri Arifin, drejtor i "Delta Security", 18.01.2009. Ai theksoi disa shembuj në rajon të përdorimit të dritës së portokalltë.

5. MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI I HOLLËSISHËM I KPS-VE

Mbikëqyrja demokratike e mekanizmave të sigurisë domosdo kërkon organe efektive dhe të fuqishme të kontrollit të hollësishëm. Për shkak të rëndësisë gjithnjë e më të madhe dhe përhapjes së akterëve privatë të sigurisë, është duke u bërë gjithnjë e më e rëndësishme që institucionet demokratike të sigurojnë një standard minimal të mbikëqyrjes dhe kontrollit.¹³⁰ Në këtë aspekt, edhe Kushtetuta e parasheh në mënyrë të qartë rëndësinë e mbikëqyrjes demokratike të sektorit të sigurisë. Dimensioni më i gjerë i kontrollit të hollësishëm qëndron në transparencë dhe llogaridhënie. KPS-të në Kosovë duhet të jenë krejtësisht transparente dhe llogaridhënëse për shërbimet që ofrojnë. Siguria është çështje shumë e ndjeshme dhe kërkon angazhimin e akterëve të ndryshëm kështu që e përjashton ekskluzivitetin e dikujt mbi këto shërbime. Për më tepër, një kontroll i hollësishëm i përmbushjes së obligimeve siç janë: trajnimet, personeli, shkelja e të drejtave të njeriut, aktivitetet e mundshme kriminale duhet të konsiderohet gati si i paevitueshëm.

5.1 Mbikëqyrja nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

MPB ka të drejtën e posaçme të mbikëqyrjes së mekanizmave të sigurisë, siç tashmë e bën për policinë dhe emergjencat civile. Në kohën e hartimit të këtij dokumenti, MPB-ja e ka një Divizion për sigurinë private, i cili ka autoritet të kufizuar të mbikëqyrjes. Seksioni i UNMIK-ut për autorizimet për armë dhe Njësia e Inspektimit të Ofruesve të Sigurisë (SSPIU) i bënin inspektimet dhe lëshonin licencat, por ato pushuan së ekzistuari ndërsa ato kompetenca iu bartën Policisë së Kosovës. Policia i pranon raportet dhe vazhdon afatin e licencave dhe inspekton për shkelje të mundshme të kushteve nga ana e KPS-ve. Këto inspektime bëhen nga Njësia e inspektimeve në Departamentin e administratës. Megjithatë, shtrohet pyetja se a do të vazhdojë Policia e Kosovës të kontrollojë KPS-të? Dy versionet e Ligjit për KPS-të e parashohin që MPB-ja të ketë autoritetin për mbikëqyrjen e KPS-ve.

¹³⁰ DCAF, *Mbikëqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë, parimet, mekanizmat dhe praktikat*, Fq.72.

Ka disa tregues se MPB-ja do të jetë autoriteti përfundimtar për inspektimin e aktiviteteve të KPS-ve madje do të lëshojë licenca përmes një organi. Janë bërë disa përpjekje për themelimin e departamentit të sigurisë publike në kuadër të MPB-së dhe një organ për sigurimin privat është planifikuar të funksionojë në kuadër të këtij departamenti.¹³¹ Megjithatë policia do të mbajë të dhënat dhe do të kontribuojë në aktivitetet e mbikëqyrjes.

Inspektorët e specializuar do të mbikëqyrin shkeljet e mundshme staturore dhe ndryshimet e Procedurave Standarde të Punës (PSP). Duhet pasur frikë për profesionalizmit të këtij organi inspektues. Në anën tjetër, ka pasur një propozim për krijimin e njësisë së specializuar të inspektimit në kuadër të Inspektoratit të Policisë i cili do të jetë mjaft i përgatitur të ushtrojë këtë kontroll të hollësishëm.¹³²

5.2 Mbikëqyrja parlamentare e KPS-ve

Mbikëqyrja parlamentare e KPS-ve është shumë e rëndësishme. Megjithatë, kontrollimi i hollësishëm i KPS-ve shpesh konsiderohet i ndërlikuar dhe disa vende thjeshtë i janë shmangur mbikëqyrjes së KPS-ve nga parlamenti, prandaj i kanë hequr ato nga fushëveprimi i tij. Në Kosovë, Komisioni i Kuvendit që është përgjegjës për mbikëqyrjen e KPS-ve është Komisioni për punë të brendshme dhe siguri. Përveç rolit të tij si mbikëqyrës i institucioneve të sigurisë, ky Komision duhet të ushtrojë kontroll dhe të kërkojë llogari për aktivitetet e KPS-ve. Ka pasur disa përpjekje nga një pjesë e anëtarëve të këtij Komisioni që të jenë pjesë e hartimit të ligjit dhe të dëgjojnë zërin e KPS-ve. Në të vërtetë kjo konsiderohet si hapi i parë drejtë kontrollit të hollësishëm të sektorit privat të sigurisë.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e KPS-ve nga Komisioni, në kuptimin e plotë të fjalës, është konsideruar i pamundur. Komisioni për punë të brendshme dhe siguri nuk mund të anashkalojë MPB-në për të ushtruar kontroll mbi këtë sektor. Komisioni do të ushtrojë kontroll të

¹³¹ Në bazë të kontakteve që patëm me zyrtarët e MPB-së ne kuptuam për përpjekjet që po bëhen për krijimin e këtij departamenti sa më parë që të jetë e mundur.

¹³² Intervistë me Heinz Schnaider, shef i Seksionit për zhvillimin e sigurisë publike, OSBE. Z. Schnaider ishte i angazhuar nga OSBE ne grupin e parë punues për hartimin e Ligjit për Sigurinë private, 14.01.2009.

tërthortë.¹³³ Nëse ndodh ndonjë aktivitet i paligjshëm, ndonjë shkelje e të drejtave të njeriut ose funksionim jo i duhur i këtij sektori, komisioni do të kërkojë sqarime dhe përgjegjësi nga Ministria.¹³⁴ Infrastruktura e tanishme ligjore¹³⁵ nuk parashih mbikëqyrje parlamentare ndërsa është duke u hartuar ligji dhe një pjesë e veçantë duhet të trajtojë këtë çështje. Vlen të përmendet se në kohën kur është bërë ky hulumtim menaxherët dhe pronarët e KPS-ve theksuan rëndësinë e Komisionit parlamentar dhe rolit të tij në procesin e hartimit të ligjit.

Në çdo rast të shkeljes së të drejtave të njeriut nga rojet e sigurisë ose poseduesit e licencës është i pashmangshëm edhe roli i Avokatit të Popullit të Kosovës. Sidoqoftë, shkeljet e vogla nuk duhet të jenë pjesë e mbikëqyrjes parlamentare duke pasur parasysh autoritetin inspektues të Ministrisë. Komisioni duhet të kërkojë llogari në rast të shkeljeve dhe veprave të rënda, financimit të dyshimtë të shërbimeve private të sigurisë, etj.

PERCEPTIMET E PËRGJITHSHME PËR KOMPANITË PRIVATE TË SIGURISË NË KOSOVË – REZULTATET E ANKETIMIT


Në këtë pjesë të analizës, analizohen konstatimet kryesore të anketimit të 1.202 personave, duke dhënë një spektër të perceptimeve të përgjithshme për rolin e kompanive private të sigurisë në situatën e përgjithshme të sigurisë, punën e tyre, kuadrot dhe nivelin e profesionalizimit, posedimin e armëve, përdorimin e forcës, mundësinë e përfshirjes së ish pjesëtarëve të TMK-së në industrinë e sigurisë private dhe parimet etike të operatorëve. Ekipi hulumtues dhe nëngrupet e caktuara kanë pasur anketime *ad hoc* sy më sy në intervistat e bëra në shtëpitë e të anketuarve. Janë mbledhur të dhëna për mostrën përfaqësuese të popullsisë së Kosovës që janë qytetarë mbi 18 vjeç. U zhvillua një mostër e madhësisë prej 1.202 të anketuarve për t’u përgjigjur popullsisë së synuar prej 2.1 milionësh. Lloji i mostrës është shtresuar në bazë të mostrës së probabilitetit 3 fazash me fazat për caktimin e mostrave:

¹³³ Intervistë me Emrush Xhemajlin, anëtar i Kuvendit të Kosovës, Komisioni për punë të brendshme dhe siguri, 16.01.2009.

¹³⁴ Ibid.

¹³⁵ Rregullorja e UNMIK-ut.


- Teritori i vendvotimit – përafërsisht i madhësisë prej 200 amvisërive (PPS me probabilitet që është proporcional me madhësisë)
- Amvisëritë përmes teknikës së zgjedhjes së rastësishme duke filluar nga adresat e caktuara (SRSËoR)



- Anëtarët e amvisërive me të njëjtin probabilitet (SRSËoR) – Skema Kish



Tabela 1: Pasqyra e përgjithshme e rezultateve të anketimit të modeluar sipas tetë pikave kryesore që kanë të bëjnë me kompanitë private të sigurisë.

Roli i kompanive private të sigurisë në mjedisin e përgjithshëm të sigurisë në Kosovë: rezultatet e anketimit tregojnë se në përgjithësi shumica e kosovarëve e konsiderojnë se roli i KPS-ve është pozitiv në situatën e përgjithshme të sigurisë në Kosovë. Kur nga ta u kërkua që të bënin vlerësimin e ndikimit të KPS-ve në sektorin e sigurisë në Kosovë, 73% u përgjigjën me po ndërsa vetëm 18% kishin mendim negativ dhe 8% refuzuan/ ose thanë se nuk dinin si të përgjigjeshin në këtë pyetje. Ketë



perceptim të përgjithshëm e kanë meshkujt dhe femrat, komuniteti shumicë dhe komunitetet pakicë, ndërsa ndryshoret e tjera shoqërore dhe gjeografike kishin vetëm ndryshime të papërfillshme nga ky perceptim të përgjithshëm.


Kur nga të anketuarit u kërkua që të **vlerësonin punën e përgjithshme të kompanive private të sigurisë**, shumica e tyre thanë se ishin të kënaqur me punën e tyre (11% shkëlqyeshëm, 78% e mirë, 4% e kënaqshme) dhe vetëm 3% thanë se puna e tyre ishte keqe ndërsa pjesa tjetër prej 4% refuzuan ose thanë se nuk dinin si të përgjigjeshin në këtë pyetje.



Përderisa shumë të anketuar paraqitën një pasqyrë pozitive për punën e kompanive private të sigurisë, ata nuk ishin aq pozitivë për atë se sa ishte **adekuat personeli i kompanive private të sigurisë dhe sa i përmbushnin ata kriteret** për tu angazhuar në çështje të rëndësishme siç është siguria. Pothuaj gjysma e të anketuarve


(45%) thanë se operatorët privatë të sigurisë nuk plotësonin sa duhet kërkesat për tu marrë me çështje që kanë të bëjnë me sigurinë. Një reagim më pozitiv në këtë pyetje erdhi nga 35% e të anketuarve ndërsa rreth 19% refuzuan të përgjigjen ose thanë se nuk dinin për këtë.

Pothuaj gjysma e të anketuarve (46%) besojnë se kompanitë private të sigurisë **duhet të lejohen me ligj që të mbajnë armë kur janë në detyrë**, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e përgjigjeve (39%) ishin kundër çfarëdo autorizimi ligjor për armë për operatorët privatë të sigurisë. Rreth 15% e atyre që u anketuan ishin të pavendosur




ose nuk dinin për këtë gjë. Kur ndahen sipas kategorive shoqërore, etnike apo demografike përgjigjet japin rezultate relativisht të ngjashme. Derisa përqindja e meshkujve që thonë po për mundësinë që kompanitë private të sigurisë të mbajnë armë kur janë në detyrë, një numër më i vogël (41 %) i femrave pajtohen me këtë. Një përqindje më e madhe e femrave (18 %) thanë se nuk e dinin, krahasuar me vetëm 11% të meshkujve.

Ndarja gjeografike sjell rezultate më interesante – një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve në rajonin e Mitrovicës (71%) besonin se operatorët privatë të sigurisë duhet të pajisen me armë për dallim prej 37 % e të anketuarve në Prishtinë që mendonin kështu.



Në pyetjen se a duhet që Ligji për kompanitë private të sigurisë **të lejojë përdorimin e forcës në raste të veçanta** kur sulmohen institucionet/individët që janë nën mbrojtjen e operatorëve, 62 % thanë se pajtohen me këtë krahasuar me 26% që dhanë




përgjigje negative. Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (12%) thanë se ishin të pavendosur ose se nuk e dinin. Ndikimi i ndryshoreve shoqërore, etnike ose gjeografike është i papërfillshëm kur është fjala për këtë.

Në përgjithësi, personat e anketuar

demonstruan qëndrim pozitiv për **kontributin e kompanive private të sigurisë në uljen shkallës së krimit në Kosovë** me 57%, duke deklaruar se prania e tyre parandalon krimet. Vetëm 26% kishin mendim të kundërt. Në këtë kategori, rezultatet ishin të ngjashme për grupet e ndryshme etnike dhe për grupet e tjera demografike në Kosovë.

Në pyetjen se a kishin **përfunduar ndonjëherë ndonjë rast të sjelljes së keqe ose të shkeljes së të drejtave të njeriut nga operatorët e sigurisë privat në Kosovë**, shumica e të anketuarve (66%) thanë jo. Është veçanërisht brengosëse përqindja e atyre që thanë se kishin përfunduar ose parë raste të tilla (31 %). Vetëm një numër i vogël prej 3% refuzuan të përgjigjen ose nuk e dinin.




Ekipi hulumtues ishte po ashtu i interesuar të dijë mendimin kosovarëve për çështjen se a mund të absorbojnë **kompanitë private në këtë industri ish-pjesëtarët e Trupave Mbrojtëse që nuk arritën të bëhen pjesë e Forcës së re të Sigurisë së Kosovës**.

Rreth 57% e përkrahën këtë ide dhe e konsideruan atë mekanizëm të mirë për ri-integrimin e tyre në tregun e punës. Pjesa tjetër theksuan se e kundërshtonin këtë mundësi (25%) ose refuzuan të përgjigjen/ nuk e dinin përgjigjen.

PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Ky dokument vlerësues nënvizon një numër fushash në të cilat industria private e sigurisë duhet të përmirësohet, rregullohet dhe mbikëqyret edhe më tej. Ndonëse perceptimet për kompanitë private të sigurisë duken stabile, siç u theksua në këtë dokument, Kuvendi, qeveria, kompanitë private të sigurisë si dhe shoqëria civile dhe mediat duhet vazhdimisht të jenë të angazhuara në trajtimin te sfidave të theksuara në këtë dokument. Sektori ballafaqohet me mungesë të infrastrukturës së mjaftueshme

ligjore dhe me një numër të dykuptimësive në përkufizim, fushëveprim dhe mjete. Ndjeshmëria e lidhjeve që kanë të bëjnë me funksionimin e KPS-ve dhe një numër i tendencave negative të kohëve të fundit kërkojnë intervenimin e menjëhershëm të shoqërisë. Sigurisht se mund të vërehet profesionalizmi, dedikimi dhe përkushtimi në disa segmente të



sektorit, por vlerësimi konstaton se kërkohet intervenimi i qeverisë si në përmirësimin e mjedisit ku veprojnë këto kompani ashtu edhe në zbatimin e rregulloreve të obligueshme ligjore.

Është me rëndësi shumë të madhe që konstatimet e këtij dokumenti vlerësues të hyjnë në listat e prioriteteve në hartimin e politikave për Kosovën. Kjo do t'i kontribuonte mjedisit më të sigurt në Kosovë si dhe do të siguronte një treg të strukturuar mirë të sigurisë private në Kosovë. Megjithatë, reagimi duhet të jetë i shpejtë, gjithëpërfshirës dhe në konsultim me të gjitha palët me interes. KPS-të që do të jenë pjesë e iniciativave të tilla për hartimin e politikave duhet të fillojnë transformimin gradual në struktura të besueshme duke siguruar kriteret e rrepta të përzgjedhjes, duke zbatuar etikën në punë dhe duke përfshirë parimet e përgjegjësive shoqërore, të bëhen më transparente dhe më të përgjegjshme për veprimet e tyre dhe të angazhohen në dialogun brenda KPS-së për të përpunuar edhe më tej perspektivën e zhvillimeve të mëtejshme.

Në anën tjetër, KPS-të duhet të shfrytëzojnë përparësinë që u jep qëndrimi pozitiv për praninë e tyre në terren. Vërtetë, siç tregojnë rezultatet e anketimit tonë, niveli i lartë i pranimin dhe reputacionit mund të shërbejë si kapital i çmueshëm shoqëror që kompanitë të ruajnë qasjen profesionale dhe cilësinë e shërbimeve të tyre për njerëzit. Por, megjithatë, KPS-të duhet të bëjnë reforma të mëdha të brendshme dhe plane konkrete për ofrimin e shërbimeve të pranueshme shoqërore. Mangësitë e vërejtura në respektimin e ligjit për punësim mund të tejkalohehen përmes marrëveshjeve të sigqerta ndërmjet KPS-ve si dhe përmes një kontrolli të hollësishëm nga agjencitë për zbatimin e ligjit.

BIBLIOGRAFIA

Artikujt dhe raportet

- Born Hans, Caparini Marina and Cole Eden, Regulating Private Security in Europe; Status and Prospects, 2007, DCAF Geneva
- CCMR, Private Security Companies in Serbia – A friend or foe?, Belgrade, 2007
- DCAF, Vetting and the Security Sector, 2006
- Kosovo Internal Security Sector Review (ISSR), UNDP, 2006
- Richards Anna and Smith Henry, Addressing the role of private security companies in security sector reform programmes, Journal of Security Sector Management, 2007
- Schulz Sabrina and Christina Yeung, Private Military and Security Companies and Gender, DCAF, OSCE/ODHIR, UN INSTRAE 2008

Dokumentet ligjore

- Draft Ligji mbi Kompanitë Private të Sigurisë në Kosovë, 2008
- Draft Ligji mbi Sigurinë Private, 2008
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji për Policinë, Kuvendi i Kosovës, 2008
- Ligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, 2008
- Rregullorja e UNMIK-ut 2000/33 mbi licensimin dhe rregullimin e kompanive private të sigurisë,

- Rregullorja e UNMIK-ut 2001/7 për Autorizimin e Posedimit të Armëve

Intervistat me fokus grupe

- Interviste me Abedin Hasani, Drejtor i “Besa Security”, 09.01.2009
- Interviste me Agim Musliu, “South East Europe Security”, 12.01.2009
- Interviste me Agron Isufi, Drejtor i “ËDG” and udhëheqës i Asociacionit të Kompanive Private të Sigurisë,
- Interviste me Bahri Arifi, Drejtor i “Delta Security”, 18.01.2009
- Interviste me Kolonel Rifat Marmullaku, Shef i Dep. te Krimeve, Policia e Kosovës, 17.01.2009
- Interviste me Emrush Xhemajli, Deputet, Komisioni për punë të brendshme dhe siguri, 16.01.2009
- Interviste me Grant Cambridge, Menaxher në “Henderson”
- Interviste me Heinz Schnaider, Shef i Sektorit të Zhvillimi të Sigurisë Publike, OSBE, 14.01.2009
- Interviste me Nuredin Ibishi, ekspert i sigurisë, 07.01.2009
- Interviste me Naim Azemi, “Bodyguards”, 12.01.2009
- Interviste me Nën.Kol Zylfije Krasniqi, Policia e Kosovës
- Interviste me Fadil Sylja, Drejtor i “Skyfterat”, Ferizaj, 12.01.2009

GJENDJA E EMERGJENCAVE
DHE MBROJTJES CIVILE NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS

K A P I T U L L I V

VITI 2008

1. HYRJE¹³⁶

Çështjet e menaxhimit të emergjencave paraqesin një nga segmentet më komplekse dhe shumë të ndjeshme të çdo shoqërie. Secili vend i kushton prioritet gatishmërisë emergjente ngase çdo masë preventive do t'i minimizonte katastrofat natyrore të cilat mund të i kanosen shtetit. Koncepti i mbrojtjes civile kryesisht i takon punëve të brendshme të shteteve¹³⁷ megjithatë është e metë të thuhet se kjo është kompetencë ekskluzive vetëm e një shteti. Katastrofat natyrore mund të ndodhin jo vetëm brenda një shteti - ato mund të kenë reperkusione rajonale e më gjerë. Realisht, çështjet e mbrojtjes civile tashmë po marrin më shumë karakter ndërkombëtarë.

Republika e Kosovës, si vend në zhvillim e sipër, ka nevojë për kapacitete më të përgatitura për të qenë në gjendje të reagojë në situatë krizash e që mund të jenë të natyrës së ndryshme. Në këtë rast, nevoja për ngritjen e kapaciteteve dhe resurseve në përballim me situatat që kanë të bëjnë me rastet e emergjencave civile është e pashmangshme.

Që pas përfundimit të luftës në Kosovë e deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës, kompetencat në sektorin e sigurisë kryesisht ishin e drejtë e rezervuar e UNMIK-ut. Mirëpo, çështjet e gatishmërisë emergjente dhe menaxhimit të emergjencave ishin kompetencë e vendorëve.¹³⁸ Duke e pasur parasysh këtë, pyetja shtrohet: Sa kanë bërë institucionet e Kosovës dhe shoqëria në drejtim të zhvillimit të këtij segmenti të sigurisë? A i është dhënë rëndësi nga politik-bërsit këtij segmenti të sigurisë? A kemi ngritur kapacitete të mjaftueshme në rast të katastrofave?

Ky hulumtim ka gjetur dobësi dhe mungesa të theksuar në këtë segment. Që nga niveli strategjik, mungon fillimisht strategjia gjithpërfshirëse e sigurisë e cila do t'i parashihte kërcënimet dhe rreziqet, në këtë rast ato që vijnë nga katastrofat natyrore dhe nga faktori njeri. Vlerësimi i kërcënimeve dhe rreziqeve shtrohet si një nevojë e menjëhershme në Kosovë. Pastaj, vërehet një mungesë e shtuar rreth informimit të qytetarëve lidhur me çështjet e gatishmërisë emergjente. Kjo aq më parë

¹³⁶ Ky vlerësim është shkruar nga MA Florian Qehaja dhe Kosum Kosumi

¹³⁷ School of Civil Protection, *Ethical Aspects*, f.6

¹³⁸ Që nga themelimi i Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes (IPVQ)

që një informim i mirëfilltë do të ndikonte në ngritjen e vetëdijës së qytetarëve për këtë lëmi shumë të rëndësishme.

Përveç tjerash, punonjësit e mbrojtjes civile kanë mungesë motivi si rezultat i pajisjeve të dobëta dhe rrogave shumë të ulta.¹³⁹ Kur kësaj i shtohet fakti se procesi i shpërbërjes së TMK-së është çështje që duhet të ndodhë, shtohet brenga e rënies së motivit për angazhimin e tyre në gatishmëri emergjente gjatë procesit të shpërbërjes së TMK-së dhe ngritjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kjo mund të krijojë një vakum sa i përket gatishmërisë emergjente të institucioneve të Republikës së Kosovës deri sa FSK nuk bëhet plotësisht operative.¹⁴⁰

Ky vlerësim ka përdorur një metodologji gjithpërfshirëse. Kjo përfshin përvojën e ekspertëve të QKSS-së, legjislacionin aktual në fuqi dhe literaturë bashkëkohore ndërkombëtare nga kjo lëmi.

Fillimisht vlerësohen aspektet e politikave të vlerësimit në çështjet e gatishmërisë emergjente. Pastaj, politikat e planifikimit strategjik, si në nivel qendror po ashtu edhe në atë lokal, zënë një pjesë të rëndësishme. Çështjet e koordinimit ndër-institucional karshi kësaj sfare përbëjnë poashtu një pjesë të këtij vlerësimi. Tërthorazi vlerësohen trajnimet, ushtrimet dhe pajisjet ekzistuese. Ky hulumtim përfshin edhe çështjet e informimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtarë. Së fundi, konkluzionet.

2. Politikat e vlerësimit

Identifikimi i kërcënimeve dhe rreziqeve paraqet faktor në drejtim të ngritjes së gatishmërisë vepruese si në aspektin preventiv ashtu edhe në atë reaktiv. Sa për të thjeshtëzuar, vlerësimi i kërcënimeve dhe rreziqeve në sektorin e sigurisë paraqet një llojë “kushtetute” në sektorin e sigurisë ngase në bazë të saj edhe orientohen politikat operative. Është më se e vërtetë që Kosovës i mungon një vlerësim në këtë sferë. Vlerësimi më

¹³⁹ Këtë e ka paraparë edhe vlerësimi i bërë nga ekspertët e Asociacionit të Zjarrfikësve të Evropës të cilët kanë bërë një vlerësim për OSBE lidhur me gjendjen e zjarrfikësve në Kosovë. Shih “*Analizimi i gjendjes – Shërbimi për Zjarrfikëse dhe Shpëtim në Kosovë*”. OSBE

¹⁴⁰ TMK-ja në bazë të misionit që ka, është forcë kryesore e linjës së dytë por në disa raste edhe linjës së parë, në ballafaqim me emergjencat civile

gjithpërfshirës është bërë gjatë vitit 2005 dhe 2006 nga UNDP ku një kapitull ka përfshirë kërcënimet dhe rreziqet në Kosovë.¹⁴¹ Gjithashtu, ka pasur vlerësime të kërcënimeve dhe rreziqeve sa i përket katastrofave natyrore nga TMK, Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe OSBE-së mirëpo të gjitha këto ose ishin të kufizuara ose tashmë nuk qëndrojnë sepse nevojitet ripërtirja e tyre.¹⁴²

Nga këndvështrimi i ekspertëve, duke e parë zhvillimin, investimet dhe ndryshimet në infrastrukturë, duhet të bëhen vlerësime dhe ripërtirja e planeve së paku një herë në tre vite. Me vlerësime në baza tre vjeçare, do të përgatiteshin planet për masat preventive dhe atyre operacionale. Kjo do të shpiente deri te planifikimi i mirefilltë strategjik.

Siç u cek edhe në hyrje, gjatë këtyre nëntë viteve të fundit, është investuar në një masë në këtë segment, Në këtë drejtim, ekziston një strukturë e cila është pjesë e menaxhimit të emergjencave. Në Kosovë, me çështjet e mbrojtjes civile deri më tani është marrë TMK dhe Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave (DME).¹⁴³ Duke mos hyrë në detaje të funksionimit hierarkik të menaxhimit të emergjencave, ia vlen të theksohet se mundësitë për vlerësim të rreziqeve ekzistojnë. Pothuajse secila komunë i ka departamentet/sektoret për mbrojtje dhe shpëtim të cilat kanë lidhje direkte me Qendrat Operative Rajonale Emergjente 112 (QORE) të cilat duhet të raportojnë gjatë 24 orëve lidhur me situatën emergjente civile dhe rreziqet e mundshme.¹⁴⁴ Të gjitha informata e nevojshme mbledhen dhe dërgohen në Qendrën e Situatave (QS) e cila gjendet në objektin e Qeverisë së Kosovës, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.¹⁴⁵

¹⁴¹ Shih *Rishikimi i Sektorit për Siguri të Brendshme në Kosovë*, UNDP, 2006

¹⁴² Në bazë të hulumtimit, TMK ka bërë një vlerësim më të gjerë në vitin 2004 ndoshta edhe ndonjë më vonë mirëpo së paku këto tre vitet e fundit nuk është ripërtirë. Poashtu, departamenti i mëparshëm i gatishmërisë emergjente dhe sigurisë civile (DGEMC), i cili ishte në kuadër të UNMIK-ut, ka bërë një vlerësim të rrezikut në nivel të komunave në vitin 2001. Kjo nuk është përtërirë më vonë nga DME.

¹⁴³ DME është në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

¹⁴⁴ Qendra Operative Rajonale gjenden në Prishtinë, Prizren, Gjilan dhe Pejë. Në Mitrovicë, ende nuk është ngritë një Qendër e tillë për shkaqe politike.

¹⁴⁵ Investimi në Qendrën e Situatave është i një rëndësie të posaçme. Pajisjet dhe metodologjia që është investuar aty është një ndër më të mirat në rajon.

Ky hulumtim ka vërejtur se përveç pranimit të informacioneve, as QORE 112 dhe as QS, nuk kanë një sektor të analizave i cili do të merrej me vlerësimin e informacioneve që kanë të bëjnë me kanosjet e mundshme të rreziqeve në sferën e emergjencave civile. Këto vlerësime, nëse jo në baza ditore e javore, do të duhej të bëheshin së paku çdo muaj. Domosdoja e vlerësimit dhe analizave shtohet kur sipas të gjitha gjasave QS do të inkorporohet në Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës (KSK).¹⁴⁶

3. Planifikimi strategjik dhe operativ

Në bazë të përceptimit dhe vlerësimit të kërcënimeve e rreziqeve, domosdoshmërisht duhet të bëhen plane si në nivelin strategjik po ashtu edhe në atë operativ. Sa i përket nivelit strategjik, mungon një strategji gjithëpërfshirëse. Ka pasur tendenca që të hartohet një strategji e tillë mirëpo ngecjet janë arsyetuar me mungesën e fondeve, edhe pse sipas vlerësimeve, mendohet që donatorët kanë kontribuar dhe do të mund të kontribuonin edhe më tutje në këtë drejtim.

Në momentin e bërjes së këtij vlerësimi, ende nuk është konstituuar KSK. KSK do të duhej të konsolidohej dhe të bënte vlerësime, këshilldhënie e diskutime lidhur me kërcënimet e rreziqet në Kosovë, në këtë rast, lidhur me rreziqet që vijnë nga katastrofat natyrore.¹⁴⁷ Rëndësia e KSK-së në menaxhimin e emergjencave është aq e madhe sa që në raste të gjendjes së jashtëzakonshme ajo e ka rolin kryesor në menaxhimin e situatave.¹⁴⁸

Realisht, strategjia për reagim ndaj katastrofave natyrore do të duhej të bazohej në strategjinë e sigurisë së Kosovës. Kosova ende nuk ka hartuar këtë strategji edhe pse rëndësia e saj është e padiskutueshme. Kush duhet të merret me hartimin e strategjisë së sigurisë? Sipas ligjit në fuqi, Këshilli

¹⁴⁶ Shih *Qendra e Situatave* <http://www.ks-gov.net/pm/RëndësiaesigurisëpublikënëKosovëdherajon/tabid/101/Default.aspx>

¹⁴⁷ Për qëllime të këtij dokumenti vlen të përmenden disa aspekte të katastrofave natyrore. Ato mund të ndodhin si rezultat i natyrës apo edhe si rezultat i veprimeve të individëve. Katastrofat mund të jenë: tërmetet, vullkanet, vërshimet, zjarret, kontaminimet kimike e radiologjike, shpërthimet, përhapja e elementeve toksike, rrëshqitjet e dheut, përmytjet etj.

¹⁴⁸ Shih Ligjin mbi Këshillin e Sigurisë së Kosovës, Neni 12, “*Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, KSK ushtron autoritet dhe përgjegjësi ekzekutive në emër të Qeverisë ...*”

i Sigurisë është organi i cili duhet t'a hartojë këtë strategji. Në momentin që po e shkruajmë këtë dokument, KSK ende nuk është formuar e aq më parë konsoliduar. Edhe pse për rëndësinë e formimit të KSK-së duhet të bëhet një vlerësim i posaçëm, në rastin konkret ngecjet në formimin e këtij institucioni ndikojnë përveç në aspektet e tjera të sigurisë, edhe në çështjet e menaxhimit të emergjencave.

Hulumtimi ka vërejtur që në nivel ministror ka plane operative për reagim në menaxhimin e emergjencave. Këto plane sidomos janë hartuar nga DME, Ministria e Shëndetësisë dhe TMK. Rasti i fundit është hartimi i një plani kombëtar për parandalimin e zjarreve,¹⁴⁹ i cili në masë të madhe ka senzibilizuar të gjitha nivelet për marrjen e masave preventive. Mirëpo shikuar në përgjithësi, këto plane nuk i referohen ndonjë vlerësimi të ripërtëritur apo strategjie dhe kësajsoj mund të konsiderohen si të pamjaftueshme.

Sa i përket planifikimit dhe vlerësimeve, ka dobësi në nivel komunal e sidomos duke u bazuar në specifikat e komunave, vlerësimi dhe planifikimi përkatës është i pashmangshëm.

P.sh disa komunave i kanoset rreziku më shumë nga zjarret e pyjeve për shkak të dendësisë pyjore dhe terrenit të papërshtatshëm (Deçan, Pejë, Istog, Kamenicë etj). Apo, në disa komuna ka probleme me ndotje të ajrit, mjete toksike e radioactive (Mitrovica, Obiliqi, Prishtina etj). Vërshimet dhe rrëshqitjet e dheut (Fushë Kosovë, Kacanik, Vushtrri etj). Më specifik është rajoni i Gjilanit i cili seizmiologjikisht është jostabil dhe më i prekur.

Bazuar në këto specifika, jo vetëm planet mirëpo edhe gatishmëria e veprimtimit duhet të bëhet konform rrethanave. Ky hulumtim ka provuar se vetëm disa komuna bëjnë planifikime (edhe atë jo të rregullta) derisa disa të tjera nuk i ripërtërijnë apo edhe disa fare nuk kanë.

4. Koordinimi

Koordinimi është njëra prej çështjeve më kompleksive si gjatë vlerësimit dhe planifikimit strategjik por edhe gjatë reagimit emergjent. Prandaj për arritjen e një koordinimi të mirëfilltë duhet të bëhen trajnime dhe

¹⁴⁹ Koha Ditore, "Plan Kombëtar për Parandalimin e Zjarreve", 16 Korrik 2008

ushtrime të përbashkëta. Kjo më së miri bëhet me definimin e Procedurave Standarde Operative (PSO) në nivel vendi.

Rasti më i fundit i lëshimeve në koordinim është hyrja e mauneve me materie toksike në territorin e Kosovës. Kjo është njëra prej çështjeve më aktuale e cila po e ngarkon në masë të madhe opinionin në Kosovë. Këtu shihet se nuk ka një koordinim të mirëfilltë të institucioneve relevante rreth kësaj çështje, duke filluar nga kontrolli i pikave kufitare se çka krejt hynë në vendin tonë, e deri tek ata të cilët janë të obliguar të lëshojnë dokumentet përkatëse për transport apo blerjen dhe shfrytëzimin e këtyre materieve. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë licencën kompanitë për eksport pa u vlerësuar dhe analizuar nga ekspertët (njohës të rreziqeve) sidomos të atyre nga materiet e rrezikshme.

Nuk ka koordinim të mirëfilltë në mes institucioneve duke filluar nga lartë poshtë por edhe nga poshtë lartë. Me rregulloren e re të funksionimit të komunave shumë aspekte të menaxhimit të emergjencave kanë kaluar në kompetencë të Kryetarëve të Komunave. Ekziston një bindje në bazë të përvojave se pjesa dërmuese e Kryetarëve të Komunave e kanë shumë problem ta kuptojnë rëndësinë e funksionimit me sukses të shërbimeve emergjente. Në rast të ndonjë katastrofe mund të ndodh që të mos ketë ndonjë koordinim të mirëfilltë në mes institucioneve përkatëse relevante. P.sh në këto raste nuk është e qartë se shërbimet emergjente komunale t'i përgjigjen Ministrisë së Pushtetit Lokal apo DME-së.

Ky hulumtim ka gjetur që edhe vet DME kërkon një centralizim të shërbimeve emergjente për një funksionim më të mirëfilltë. Kjo padyshim se do ta thjeshtëzonte koordinimin në rast të reagimeve gjatë emergjencave civile.

5. Pajisjet dhe infrastruktura

Në çdo nivel, ekzistojnë kapacitetet fillestare për reagim ndaj emergjencave civile. Kryesisht këto pajisje janë të stërvjetuara dhe një pjesë e madhe e tyre janë në gjendje jo të mirë teknike prandaj edhe

shërbimet emergjente nuk janë sa duhet efikase në përballje me rreziqet e ndryshme. Një vlerësim të detajuar lidhur me mungesën e pajisjeve dhe infrastrukturës për zjarrëfikësit e ka bërë Asociacioni Ndërkombëtarë për Zjarrfikje dhe Shpëtim, i përkahur nga OSBE në Kosovë.

Ky hulumtim ka vërejtur se edhe ato pak fonde që ndahen në nivel komunal për emergjenca civile destinohen për nevoja tjera komunale duke mos i dhënë rëndësi këtij segmenti të rëndësishëm. Mungojnë pothuajse tërësisht pajisje në nivel lokal për matje seizmiologjike, ndotjen e ajrit dhe radioaktivitetit. Së fundi, në Gjilan është bërë një hap i parë në këtë drejtim. Janë futur matësit seizmiologjik lidhur me termetet e mundshme në atë rajon.

Një nga segmentet më kritike në aspektin e gatishmërisë emergjente janë spitalet. Infrastruktura e tanishme nuk do të mund të përballon ndonjë fluks të madh në raste krizash. Këtë e vërteton edhe shqetësimi i ngritur nga Drejtori i Klinikës Emergjente të Kosovës ku paralajmëron për mungesat më elementare në klinikën emergjente.¹⁵⁰

6. Trajnimet dhe ushtrimet

Krahas përgatitjes së planit për vlerësimin e rrezikut konform këtij vlerësimi, duhet të përgatiteshin edhe planet për zhvillimin e trajnimeve dhe ushtrimeve në cdo nivel, si atyre individuale por edhe atyre kolektive për emergjencat civile. Njëri prej elementeve kyçe në këtë lëmi është trajnimi i personelit dhe ushtrimet e rregullta në vazhdimësi në mënyrë që në çdo rast të arrijnë aftësi më të larta gjatë reagimit.

Edhe pse ekziston Qendra e Kosovës për Siguri, Edukim dhe Zhvillim, në Vushtrri, kapacitetet e saj janë të kufizuara. Problemi kryesorë në aspektin e trajnimeve konsiston në mungesën e ekspertëve apo trajnerëve të kësaj fushe. Përveç kësaj qendre, duhet të shfrytëzohen edhe kapacitetet që ofrojnë institucionet tjera. Më konkretisht, krahas personelit të DME-së, duhet të angazhohen edhe ekspertët e tjerë, si nga jeta akademike po ashtu edhe nga OJQ-të.

¹⁵⁰ Drejtori i Qendrës Emergjente Spitalore i ka dërguar letër Qeverisë së Kosovës duke shprehur shqetësimin dhe paralajmërimin lidhur me mungesat në këtë klinikë, Prill 2008,

Përveç ushtrimeve të parapara vetanake, ka nevojë që të ketë edhe ushtrime të përbashkëta në çdo nivel. Për herë të parë është mbajtur ushtrimi gjithëpërfshirës në nivel vendi i planifikuar, organizuar dhe udhëhequr nga TMK dhe në përkrahje të KFOR-it.¹⁵¹ Ushtrime të tilla do të ishte mirë që të organizoheshin një deri dy herë brenda një viti kalendarik. Krahas ushtrimeve në nivel vendi, për shkak të specifikave të cekura më lartë, do të duhej të organizoheshin edhe në nivel komunal duke inkorporuar të gjitha shërbimet përkatëse. Duke pasur parasysh mungesën e kapaciteteve infrastrukturore dhe në pajisje, ushtrimet në nivel komunal do të duhej të organizoheshin me pjesmarrjen e disa komunave me karakteristika të njëjta dhe afërsi gjeografike.

7. Informimi

Një ndër mangësitë që i karakterizojnë institucionet përkatëse të mbrojtjes civile është edhe mungesa e informimit. Qytetarët e Kosovës janë shumë pak të informuar lidhur me gatishmërinë emergjente të institucioneve. DME duhet të bëjë më shumë në drejtim të informimit të qytetarëve. Informimi duhet të bëhet edhe për vështirësitë që përballet ky institucion.

Bazuar në përvojën e shteteve të ndryshme, pavarësisht se gjatë një viti kalendarik nuk ndodh asnjë rast emergjent që duhet të reagojnë institucionet përkatëse, do të ishte zgjidhje e mirë sikur që institucionet e mbrojtjes civile të organizonin një konferencë për shtyp për të informuar komunitetin se çka është duke u bërë në këtë drejtim, të ngritet besimi dhe të përmirësohet imazhi shoqërorë.¹⁵²

Shumë pak është bërë për senzibilizimin e numrit emergjent 112. Tek popullata në përgjithësi ende ekziston ajo ndjenjë se për çdo rrezik duhet të thirret apo alarmohet policia apo ndonjë shërbim tjetër. Kjo vjen si pasojë e mosinformimit të qytetarëve rreth rëndësisë së 112. Sa për thjeshtëzim, nevojitet promovimi i 112-shit, siç bëhet edhe në shtetet e tjera të BE-së. Realisht, DME duhet të ketë së paku një zyrtarë aktiv që merret me çështjet e marrëdhënieve me publikun.

¹⁵¹ Ushtrimi u quajt “Shqiponja 7”, në Maj 2008

¹⁵² Civil Protection, *Training and Education*, f.27

Një fakt shqetësues është edhe mungesa e vetëdijësimit të qytetarëve. Duhet domosdoshmërisht të organizohen programe apo trajnime lidhur me masat për parandalimin e krizave. Kjo për arsye se dëmet që shkaktohen nga zjarret vijnë si rezultat i pakujdesisë së faktorit njeri.¹⁵³ Mënyra më idelae do të ishte inkorporimi i mësimave dhe trajnimeve për vetëdijësim, që nga nivelet më të ulta shkollore.

Rast dhe shembull i mire për të senzibilizuar dhe njohtuar opinionin kosovar ishte ushtrimi gjithpërfshirës në nivel vendi “Shqiponja 7” ku i është kushtuar vëmendje e konsiderueshme nga shumica e mediave. Mendojmë se kjo praktikë duhet të ekzistojë edhe në të ardhmen.

8. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Asnjë vend më nuk mund të bazohet vetëm në kapacitetet e saja. Veçanarisht, duke u bazuar në probabilitetin e katastrofave të shkallës së lartë si dhe në natyrën e kërcënimeve asimetrike nevoja për ndihmë reciproke është më se e nevojshme.¹⁵⁴ NATO dhe BE në objektivat e saj kanë pranuar se tani më katastrofat natyrore nuk i rrespektojnë kufijtë e shteteve.

Deri më tani, Kosovës i mungojnë plotësisht marrëveshjet me vendet e rajonit për ndihmë në raste të katastrofave. Bazuar në vështirësitë, mungesën e kapaciteteve dhe resurseve, domosdoshmërisht duhet të inicohen marrëveshjet e bashkëpunimit. Nuk ka asnjë arsye që të mos inicohet marrëveshja me Shqipërinë. Për shkak të afërsisë, marrëveshjet me Maqedoninë dhe Malin e Zi janë të paevitueshme. Realisht, për shkaqe politike marrëveshje të tilla me Serbinë për momentin nuk mund të arrihen, gjë që mund të vështirësojë reagimin ndaj situatave eventuale emergjente, sidomos në rast të zjarreve.¹⁵⁵

Këto marrëveshje duhet të përfshijnë ndihma reciproke në rast të: zjarreve, vërshimave, ndotje të ambientit, rrëshqitjeve të dheut, radioaktivitetit, ofrimit të shërbimeve spitalore etj. Rasti më i fundit në

¹⁵³ Sipas vlerësimeve, gjatë zjarreve në vitin 2007, gati se në 90% të rasteve shkaktar ishte faktori njeri.

¹⁵⁴ Backgrounder, *NATO's role in civil emergency planning*, f.1

¹⁵⁵ Sidomos rastet e zjarreve gjatë vitit 2007 në vijat kufitare me Serbinë ku shërbimet e zjarrfikjes dhe TMK-së kanë qenë të penguar për intervenime.

rajon është ndihma e menjëhershme që ju dha Shqipërisë nga Italia dhe Greqia, në rastin e Gërdecit, si rezultat i marrëveshjeve paraprake.

9. Konkluzionet

Hulumtimi ka gjetur mangësi dhe dobësi të theksuara në sferën e emergjencave civile. Qeveria e Kosovës duhet sa më parë të konsolidoj Këshillin e Sigurisë së Kosovës në mënyrë që të inicohet menjëherë hartimi i një strategjie kombëtare të sigurisë. Krahas saj, duke i pasur parasyh rrezikshmëritë e shumta, mungesa e vlerësimeve të kërcënimeve dhe rreziqeve në Kosovë është e pajustificueshme. Kosovës i nevojitet një vlerësim gjithëpërfshirës i kanosjeve të kërcënimeve dhe rreziqeve ngase kjo i determinon edhe politikën e planifikimit strategjik.

Koordinimi i dobët dhe i paqartë paraqet një problem në vete. Nuk dihet “ndarja e detyrave” në mes nivelit qendror dhe lokal lidhur me çështjet e emergjencave civile. Rekomandohet një sistem më i centralizuar ku emergjencat civile në nivel lokal do t’i përgjigjeshin drejtpërdrejtë një organi si dhe definimi i Procedurave Standarde Operative (PSO) në nivel vendi nga Qeveria e Kosovës.

Informimi është një ndër shtyllat kryesore. Qytetarët nuk janë të informuar lidhur me ekzistencën e numrit emergjent 112. Ngritja e vetëdijës së qytetarëve lidhur me rrezikshmëritë, sidomos ato që vijnë nga zjarret, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ndotja e ambientit etj, duhet të merret si një ndër detyrat parësore nga DME.

Fakt shumë shqetësues është mungesa e pajisjeve, resurseve e në veçanti gjendja e Klinikës Emergjente. Derisa ekziston infrastruktura bazike, mungojnë pajisje bashkëkohore shumë të nevojshme. Duke pasur për bazë këto vështirësi, duhet sa më shpejt që është e mundur të inicohen marrëveshje të bashkëpunimit me shtetet që na rrethojnë. Këto marrëveshje do të mundësonin ndihma dhe mbështetje reciproke në këtë lëmi.

Bibliografia

- Asociacioni Ndërkombëtarë për Zjarrëfikje dhe Shpëtim, *Analizimi i gjendjes – Shërbimi për Zjarrëfikje dhe Shpëtim në Kosovë*, OSBE, Shkurt 2008
- Basri Lenjani, *Letra drejtuar Qeverisë së Kosovës lidhur me gjendjen e Klinikës Emergjente*, Prill 2008, Prishtinë
- Backgrounder, *NATO's role in civil emergency planning*, Shtator 2006, Bruksel
- Civil Protection, *Information and Education*, Këshilli i Evropës, 2002
- Koha Ditore, *“Plan Kombëtar për Parandalimin e Zjarreve”*, Korrik, 2008
- Ligjin mbi “ *Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës*”
- *Qendra e Situatave* <http://ëëë.ks-gov.net/pm/RëndësiaesigurisëpublikënëKosovëdherajon/tabid/101/Default.aspx>
- School of Civil Protection, *Ethical Aspects*, Këshilli i Evropës, 2002
- UNDP, *Risikimi i Sektorit për Siguri të Brendshme në Kosovë*, 2006, Prishtinë

VITI 2009

Gjetjet kryesore për gatishmërinë emergjente në Kosovë janë:

- Kosova ballafaqohet me rreziqe natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri siç janë: ndotja e ambientit, zjarret, tërmetet, epidemitë, rrëshqitjet e dheut dhe vërshimet
- Gatishmëria emergjente joefektive në raport me emergjencat serioze apo katastrofike
- Korniza ligjore nuk është adekuate dhe kërkohet legjislacioni i ri apo amandamentim i legjislacionit ekzistues
- Nuk ka rezerva specifike financiare të cilat do të përdorëshin në raste të emergjencave
- Zjarrëfikësit janë të pakët krahasuar me kërkesat dhe/ose standardet ndërkombëtare; të pajisur me dobët dhe me të ardhura shumë të ulëta
- Ka mungesë të sistemit komandues gjatë incidenteve tek Shërbimet e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit
- Nuk ka ende një dokument të përgjithshëm për përcëtimin e kërcënimeve dhe rreziqeve. Ka një dikrepancë të madhe në mes të komunave dhe agjencive/ministrive në lidhje me përpilimin dhe freskimin e planeve operative
- Ka mungesë të vlerësimit të kërcënimit dhe rrezikut bazuar në specifikat lokale të disa komunave
- Procedurat Standarde Operative (PSO) nuk janë duke u implementuar
- Sektori i gatishmërisë emergjente është i neglizhuar si nga niveli qendror po ashtu edhe nga niveli lokal
- Ekzistojnë shërbime paralele emergjente të cilat operojnë në pjesën veriore të Kosovës
- Nuk ka mbikëqyrje të mjaftueshme parlamentare
- Bashkërendimi në mes të shërbimeve emergjente është i padefinuar
- Nuk ka një orar për stërvitje të përbashkëta emergjente
- Nuk ka bashkëpunim me shtetet fqinje
- Ka mungesë të profesionistëve të cilët merren me çështjet e mbrojtjes ambientale dhe rrjedhimisht ka performancë të dobët në këtë fushë

- Kapacitetet e shërbimeve mjekësore janë të pamjaftueshme që të i përgjigjen një numri të madh të pacientëve në raste të emergjencave

Hyrje¹⁵⁶

Gatishmëria i referohet organeve që duhet të përgatiten në raste të incidenteve të paparashikuara. Nga pikpamja e shteteve ky term konsiston në gatishmërinë emergjente të shteteve në ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga rreziqet e ndryshme. Gatishmëria emergjente nuk ka të bëjë me shmangien e katastrofave natyrore apo jo-natyrore, por efikasiteti i saj mund të minimizojë në masë të madhe dëmtimet dhe pasojat. Rreziqet kanë komponentë si natyrorë, ashtu edhe njerëzorë, me mundësi të krijimit të humbjeve për qeniet njerëzore, mirëqenien, si dhe për pronat e tyre.¹⁵⁷

Gatishmëria emergjente në përgjithësi tenton të krijojë masa parandaluese për menaxhimin e së paku pesë rreziqeve të mundshme: atmosferike¹⁵⁸, hidrologjike¹⁵⁹, gjeologjike¹⁶⁰, biologjike¹⁶¹ dhe teknologjike.¹⁶² Këto rreziqe nuk do të thotë se paraqesin rrezik për të gjitha vendet. mirëpo secili shtet krijon dhe përpiqet të parashohë dhe të përgatitet në raste të fatkeqësive. Literatura ndërkombëtare përmban katër faza të menaxhimit emergjent: matjen, gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbjen. Ky koncept do të fokusohet në dy fazat e para - në matjen dhe gatishmërinë.

Ekzistojnë disa terme që i referohen gatishmërisë emergjente, siç janë: menaxhimi i emergjencave, menaxhimi i fatkeqësive, mbrojtja civile, siguria civile apo mbrojtja civile (civil protection). Të gjitha këto terme në këndvështrim më të gjerë zëvendësojnë *mbrojtjen civile* që fokusohet në mbrojtjen e qytetarëve nga sulmet ushtarake. Në këtë mënyrë ky sektor

¹⁵⁶ Ky hulumtim është bërë nga MA Florian Qehaja dhe BA Mentor Vrajolli

¹⁵⁷ Shkolla për mbrojtjen civile, *Rreziqet dhe Manxhimi i Emergjencave*, Blloku I.

¹⁵⁸ Uragani, shiu, ngricat, bora.

¹⁵⁹ Vërshimet, transportim trupash.

¹⁶⁰ Rrëshqitje te dheut.

¹⁶¹ Epidemitë njerëzore, bimore dhe shtazëve të egra.

¹⁶² Eksplodimet industriale, centrale bërthamore.

është duke pësuar ndryshime dhe aq më parë që është duke u zgjeruar me përfshirjen e resurseve civile. Përveç kësaj, koncepti i menaxhimit të rrezikut (risk management) është duke u zhvilluar shumë shpejt dhe kryesisht i referohet emergjencave civile krahas faktit që mbulon rreziqet financiare dhe bizneset e sigurimit, rreziqet politike, të inteligjencës dhe ato ushtarake.

Kosova është ballafaquar me situata të rrezikshme, posaçërisht me rastin e tërmetit në Gjiilan në vitin 2002, me shpërthimin e zjarreve gjatë viteve 2006-2007, sëmundjeve epidemike; vërshimeve të lumenjve, posaçërisht në Fushë Kosovë, rrëshqitjeve të dheut në rajonet e Kaçanikut, Anamoravës dhe Dukagjinit, si dhe incidenteve të tjera të shkallës me të ulët. Që nga viti 1999 shërbimet emergjente janë krijuar dhe reformuar me një mbështetje serioze nga bashkësia ndërkombëtare. Çështjet e gatishmërisë emergjente kryesisht kanë qenë nën kompetencat e autoriteteve lokale, përveç atyre që kanë të bëjnë me policinë dhe mbrojtjen të cilat kanë qenë nën kompetencat e bashkësisë ndërkombëtare.

Gjate hulumtimit, disa pyetje i janë adresuar autoriteteve relevante për atë se a ka ndërtuar Kosova kapacitete për raste të fatkeqësive dhe sa rëndësi i kanë kushtuar përpiluesit e politikave këtij sektori. Këto pyetje kanë hasur në përgjigje të padëshirueshme, madje duke e bërë këtë hulumtim më të vogël në mënyrë që të bëhet një vlerësim më gjithëpërfshirës lidhur me problemet që ekzistojnë në këto shërbime. Deklarata joformale se “shpresojmë të mos ndodhë asgjë përndryshe shërbimet janë të paafta të mbulojnë fatkeqësitë me përmasa të mëdha” shtrojnë një çështje dhe brengosje të veçantë për shoqërinë kosovare.

Edhe pse në përgjithësi lexuesi në brendi do t'i identifikojë pengesat, të metat dhe të arriturat e shërbimeve emergjente, hulumtimi konstaton se gatishmëria emergjente në Kosovë është efiçase në raste të incidenteve të shkallës së ulët dhe, nëse përdoren edhe atomet e fundit të kapaciteteve, edhe të disa incidenteve të shkallës së mesme.¹⁶³ Sidoqoftë, zyrtarët kanë pranuar se shërbimet emergjente janë të paafta të veprojnë në raste të emergjencave të rënda dhe katastrofike. Vlen të përmendet deklarata e kaluar e drejtorit të spitalit gjegjësisht qendrës emergjente në Prishtinë që

¹⁶³ Varësisht nga rajoni.

iu adresua qeverisë se nuk mund të absorbon një numër të madh të pacienteve në rast të emergjencave me përmasa të mëdha.

Në kapitullin e parë në përgjithësi vlerësohet gjendja momentale e shërbimeve emergjente, duke filluar nga niveli qendror. Për më tutje, përkundër gjendjes operative vlerësimi i rrezikut vlerësohet si i rëndësishëm pasi që mungojnë vlerësimet institucionale. Ky kapitull përmban vlerësimin e infrastrukturës ligjore momentale dhe rekomandimet për ndryshime si dhe kërkesa për kornizë të re ligjore.

Kapitulli i dytë me gjerësisht shtjellon hulumtimet në nivelin lokal. Duke konsideruar shtrirjen në pesë rajone: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjiilan dhe Mitrovicë. Ky kapitull përmban gatishmërinë e tanishme emergjente të departamenteve¹⁶⁴ për mbrojtje dhe shpëtim në komuna, duke përfshirë koordinimin, si dhe planifikimin e tyre. Ne veçanti, zjarrfikësit ishin caku rrjedhimisht duke i vënë në pjesën që ka të bëjë me qeverisje lokale. Përveç kësaj, ndihma e parë dhe emergjencat mjekësore janë pjesë e këtij kapitulli si dhe zyrat e pylltarisë.

Kapitulli i tretë përmban gatishmërinë emergjente për institucione specifike, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë janë pjesë e emergjencës. Posaçërisht, ka qenë në interes të përfshihet Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe Ministria e Pushtetit Lokal. Ky hulumtim gjithashtu është pasuruar me vlerësimin e institucioneve specifike/kompanive, siç janë: KEK-u, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Instituti Sizmologjik, Kryqi i Kuq i Kosovës, Agjencia e Pylltarisë dhe institucionet mjekësore.

Kapitulli i fundit shtjellon dimensionin e bashkërendimit të këtyre institucioneve, e konsideruar kështu me rëndësi të veçantë në menaxhimin e emergjencave poashtu dhe mbikëqyrja parlamentare. Përveç bashkëpunimit ndër-komunal në këtë fushë, bashkëpunimi ndërkombëtar po ashtu është futur në fushën e hulumtimit. Si përfundim, raporti studiuës përmban rekomandimet dhe bibliografinë.

¹⁶⁴ Në disa komuna mbrojtja dhe shpëtimi është në nivel te departamentit, përderisa në të tjerat, në nivelin e sektorëve – pjesë e departamentit të shërbimeve publike.

1.2 Metodologjia

Hulumtimi për gatishmërinë emergjente në Kosovë është bërë gjatë një periudhe tremujore, prej muajit mars në qershor 2009. Ekipi punues ka përdorur burime të ndryshme me qëllim që të dhënat të janë të krahasueshme për studim, të sigurojnë nivel të lartë dhe të saktë për analizim të detajuar të situatës. Burimet e informative përfshinë:

- 12 grupe / takime tryeza të rrumbullaket të mbajtura në 12 komuna duke përfshirë pesë rajonet;
- Me shumë se 45 intervista me “informues kyç”, intervista me DME, me zjarrfikësit, ministritë, ekspertët e sigurisë, agjenci, spitale, palët me interes, shoqërinë civile etj;
- Analizat dhe të dhënat e mundshme nga DME, raportet e mëhershme;
- Rishikimi i hulumtimeve në nivel lokal dhe ndërkombëtar lidhur me gatishmërinë emergjente dhe
- Rishikimi i infrastrukturës ligjore aktuale

Hulumtimi mbështetet kryesisht në analiza kualitative dhe vetëm në deklaratat e profesionisteve të sigurisë dhe individëve relevant, si dhe në të dhënat e tjera ngase vlerësimeve kuantitative lidhur me perceptimet e publikut është bërë çdo vit në projektin “Matja e besimit të mekanizmave të sigurisë në Kosovë”. Në këtë mënyrë, perceptimi publik për shërbimet emergjente është matur.

2. Pikëpamje e përgjithshme e gjendjes së tanishme në gatishmërinë emergjente të Kosovës

Që nga viti 1999 shërbimet emergjente të Kosovës kanë qenë pjesë e Reformimit të Sektorit të Sigurisë (RSS) dhe Ndërtimin të Sektorit të Sigurisë (NSS). Si pjesë e RSS-së, fillimisht kanë qenë zjarrfikësit dhe shërbimet e shpëtimit, shërbimet e ambulancës dhe Departamenti për Siguri Civile dhe Gatishmëri Emergjente tashme i njohur si Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave në Ministrinë e Punëve të

Brendshme. NSS duhet t'i referohet Trupave Mbrojtës të Kosovës (TMK), dhe më vonë Forcave të Sigurisë të Kosovës (FSK). Në të vërtetë ky sektor në të kaluarën ka qenë i organizuar në bazë të standardeve të mbrojtjes civile që ishte e aplikueshme në sistemin e dikurshëm Jugosllav. Siç u cek ne fillim, bashkësia ndërkombëtare ka luajtur një rol të rëndësishëm në reformimin dhe ndërtimin e sektorit në pajtim me zhvillimet e tanishme në mbrojtjen dhe përgatitjen emergjente. Në veçanti, që nga sulmet e njëmbëdhjetë shtatorit në Nju Jork është pranuar tërësisht se ky sektor duhet të ketë një rol më të madh në përgatitje dhe nëse ndodhë një gjë e tillë të i përgjigjet secilit incident me potencial të shkaktimit të viktimave.

Menaxhimi i emergjencave në Kosovë është i organizuar në mënyrë hierarkike. Këshilli për Siguri të Kosovës ka një rol ekzekutiv në raste emergjente për dallim nga gjendja e rregullt, kur ka një rol konsultues dhe bashkërendues.¹⁶⁵ Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave (DME) është pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), dhe është autoriteti më i lartë përgjegjës për hartimin dhe realizimin e strategjisë për gatishmëri për emergjencat civile në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera.¹⁶⁶ DME është e ndarë në tre sektorë: sektorin e parandalimit, sektorin e planifikimit dhe në sektorin e emergjencave. Detyrat e këtyre sektorëve kanë të bëjnë me planifikimin e nevojshëm për çështjet emergjente. Këta sektorë po ashtu janë përgjegjës për hartimin e ligjeve dhe të Procedurave Standarde të Operative (PSO). Detyra e Sektorit të parandalimit është zbatimi i vlerësimit për kërcënimet e mundshme dhe monitorimi i gjendjes në terren. Detyra e sektorit të fundit është që të merret me gjendjet emergjente dhe bashkërendimi në mes të institucioneve të ndryshme në kohë të krizave.¹⁶⁷

Në nivel lokal, çdo komunë ka departamentin dhe sektorin për mbrojtje dhe shpëtim. Varësisht nga rëndësia që jepet, disa komuna e kanë vendosur në nivel të departamentit për mbrojtje dhe shpëtim përdorisa komunat e tjera kanë themeluar sektor për mbrojtje dhe shpëtim si pjesë e departamentit të shërbimeve publike. Zyrtarisht, këto departamente/sektorë janë pjesë e DME-së, por i raportojnë komunave

¹⁶⁵ Shih Ligji për Këshillin e Sigurisë në Kosovë.

¹⁶⁶ Shih <http://www.mpb-ks.org/?page=2,29>.

¹⁶⁷ Intervistë me Bislim Zyrapin, drejtor për DME.

përkatëse. Ky sistem është i decentralizuar, i mbështetur financiarisht nga komunat, mirëpo funksionon brenda fushëveprimit të komunës përkatëse. Gjithashtu, palët me interes në nivel lokal lidhur me gatishmërinë emergjente janë shërbimet mjekësore, zyrat e pylltarisë, Kryqi i Kuq etj.

Roli i SHPK-së në raste emergjente është vendimtar, pasi që patrullat policore janë të parat që ballafaqohen me incidentin, dhe roli i tyre primar është bashkërendimi i shërbimeve emergjente në terren. Sa për ilustrim, zyrtarët e SHPK-së marrin gjendjen nën komandë dhe kontroll, derisa të arrijn në vend të ngjarjes njësitë i zjarrfikësve dhe i shpëtimit. Bashkëpunimi mes SHPK-së dhe shërbimeve emergjente duket se është në nivel të kënaqshëm. Zyrtarët e SHPK-së janë të obliguar të marrin pjesë në takime për planifikim dhe vlerësimin emergjent. Në krahasim me shërbimet emergjente në nivel lokal dhe qendror, SHPK-ja i respekton nivelet kryesore të PSO-së. Kjo është parë gjatë disa ushtrimeve të përbashkëta që janë bërë në nivel lokal dhe në atë të vendit.¹⁶⁸ Përveç kësaj, në bazë të praktikave të deritanishme, disa qytetarë mund të kontaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë SHPK-në (92-shin) lidhur me vetëdijesimin e tyre për numrin për lajmërimin e rasteve emergjente 112. SHPK-ja merr përgjegjësinë për informimin e QAKE-ve rreth incidentit.

Ekzistojnë pesë Qendra për Alarmim dhe Koordinim Emergjent (QAKE), me lokacion në: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjiilan, dhe Mitrovicë. Te gjitha janë e funksionale dhe japin shërbime, përveç qendrës në Mitrovicë, e cila nuk funksionon. Për shkaqe të situatës politike, është marr vendimi që Qendra në Mitrovicë të transferohet brenda QAKE-së në Prishtinë. Linja telefonike emergjente numër 112 pranon informatat për incidentet të cilat ndodhin në rajon 24 orë në ditë. Rastet emergjente raportohen në qendrën e situatave (SITCEN) në Prishtinë, e cila është pjesë e Zyrës së Kryeministrit.

Si institucion i rëndësishëm për mbrojtje civile ishin Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Pjesëtarët e TMK-se kanë qenë të specializuar në mbrojtjen civile duke ndihmuar institucionet e tjera, posaçërisht në

¹⁶⁸ Gjate bisedës me grupe dhe debateve me palët me interes janë vërejtur përgatitjet e SHPK-së në raste emergjente në rast të incidenteve dhe zbatimi i PSO-ve.

fatkeqësi të shkallës së lartë. Duke i marr parasysh ndryshimet ne terren, ky institucion tanimë është shpërbërë. E sapoformuar, Forca e Sigurisë së Kosovës ka mandat të veprorë dhe të përgjigjet në operacione për mbrojtjen civile, si dhe të ndihmojë autoritetet civile në reagim ndaj fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera.¹⁶⁹ Ky institucion i sapoformuar nuk është ende operacional dhe për këtë arsye nuk është pjesë e këtij hulumtimi. Roli i saj në çështjet e mbrojtjes civile është thelbësor, mirëpo boshllëku kohor mes kohës së shpërbërjes së TMK-së dhe funksionalizimi të FSK-së mund të ndikojë seriozisht në gatishmërinë emergjente, posaçërisht në rast të emergjencave të rënda dhe katastrofike.¹⁷⁰

Përderisa ky dokument përmban informata për gjendjen e tanishme të gatishmërisë emergjente në Kosovë, mund të ekzistojë interesimi për efektivitetin si rezultat i investimeve dhe reformave dhjetëvjeçare në këtë sektor. Raporti Vjetor i Qeverisë ne vitin 2008 ka qenë befasisht pozitiv për sektorin e sigurisë, përveç çështjeve të menaxhimit të emergjencave. Për ta thjeshtëzuar, në krahasim me institucionet e tjera, qeveria pranoi që ka mangësi në menaxhimin e emergjencave. Raporti i qeverisë tregon për mangësitë në mbrojtjen kundër zjarrit, fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga faktori njeri. Ne veçanti u fokusua mungesa e përgatitjes për raste emergjente në ndërtesat publike, duke përfshirë këtu edhe ndërtesat e qeverisë, ndërtesat komunale, spitalet etj.¹⁷¹ Ky raport i referohet edhe mangësisë së planifikimeve të mirëfillta, posaçërisht të atyre të shpëtimit dhe të mbrojtjes nga zjarri, vendosjes së hidrantëve, daljeve emergjente etj.¹⁷² Duke pasur parasysh mungesën e planifikimit në ndërtesat e institucioneve publike mund të shtrohet brenga për gjendjen e përgjithshme të gatishmërisë emergjente.

Çështja e inspektimit të ndërtesave dhe vlerësimi i gjendjes së emergjencave është kompetencë e DME-së.¹⁷³ Vlerësimi i ndërtesave private dhe publike se a mund të vendosen hidrantë, dalje emergjente dhe masa të tjera parandaluese është një temë e gjerë, prandaj nevojitet

¹⁶⁹ <http://mksf-ks.org/>

¹⁷⁰ TMK ishte “vija e dytë” në rast të incidenteve dhe roli i saj ishte që të mbulonte zbrastësirat e shërbimeve emergjente. Ky rol mund të trashigohet nga FSK

¹⁷¹ Raporti i Vjetor i Qeverisë për vitin 2008, 13.3

¹⁷² Ibid,

¹⁷³ Ligji për Mbrojtje nga Zjarri, Kapitulli VII

një raport specifik. Për shkak të investimeve të mëdha në vendet urbane, posaçërisht në Prishtinë, ekipi hulumtues ka qenë i interesuar të dijë më shumë për kapacitetet e DME-së në inspektimin e ndërtesave të vjetra dhe të reja. Bazuar në diskutimet, zyrtarët e DME-së përgjegjës për parandalim pjesërisht i inspektojnë disa ndërtesa, dhe thjesht nuk mund t'i përgjigjen kërkesës se madhe për inspektim dhe për dhënien e lejeve. Kjo çështje është brengosëse me vet faktin se mungon një pasqyrë e përgjithshme për tërë Kosovën.

Buxheti i Kosovës nuk përmban linjë të veçantë buxhetore për shfrytëzimin në raste emergjente. Në baze të zyrtarëve, për këtë vit janë përafërsisht 900.000 euro¹⁷⁴ si rezervë buxhetore për raste emergjente në kuadër të Buxhetit të Kosovës, të cilat nuk është specifikuar për çfarë qëllimi mund të shpenzohen. Në të vërtetë, qeveria do të përdorte këtë shumë në raste emergjente mirëpo problemi kryesor është i lidhur me procedurat burokratike që mund të ngriten në raste të specifikimit të kërkesës. Nga këndvështrimi profesional, dihet se gjatë incidenteve emergjente, veprimet e shpejta dhe efektive janë të paevitueshme duke përfshirë edhe shpenzimet financiare.

Investimet kapitale kryesisht nuk ekzistojnë. Shumica e komunave nuk sigurojnë linjë të veçantë për investime kapitale, përveç linjës buxhetore për “mallra dhe shërbime”, e cila shfrytëzohet për mirëmbajtje të mjeteve dhe infrastrukturës ekzistuese. Në krahasim me vitin e kaluar, ka edhe mungesë të donacioneve që mund të përdoren për mjete dhe trajnime. Deri me tani hulumtimi ka gjetur se ky sektori ka pranuar një shumë të vogël donacionesh nga UNDP-ja dhe nga Ambasada e Francës. Në përgjithësi, duke marr parasysh alokimin financiar si nevojë në nivelin qendror dhe lokal, është e evidente se ky sektor është anashkaluar. Posaçërisht në diskutimet me komunat disa brenga janë ngritur për “diskriminimin” në planifikimin financiar, në veçanti në komunat që kanë themeluar nivelin sektorial për mbrojtje dhe shpëtim. Disa nga zyrtarët janë shprehur se linjat buxhetore, të cilat janë paraparë fillimisht për çështje emergjente janë përdorur për qëllime të tjera. Një nga zyrtarët e lartë të Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar se grantet e

¹⁷⁴ Ne insistuam nga DME për të na treguar shumën e rezervave përndryshe ekipi i QKSS-së nuk mund ta verifikonte shumën e saktë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

dhëna nga kjo ministri për autoritet lokale pothuajse kurrë nuk janë vendosur si prioritet për shërbime emergjente.

Pjesa kryesore e mekanizmave të menaxhimit të emergjencave i adresohet Shërbimit të Zjarrfikësve dhe të Shpëtimit. Momentalisht ekzistojnë përafërsisht 620 zjarrfikës¹⁷⁵ në Kosovë me pajisje të dobëta dhe me paga të ulëta. Vetëm në komunën e Prishtinës ka brigadë të zjarrfikësve dhe të shpëtimit, përderisa të tjerat janë në nivel të njëjësive. Zyrtarët shprehen se ky numër është i ulët krahasuar me standarde evropiane, të cilat parashohin një zjarrfikës për 1,000 banorë. Nëse i referohemi zyrtarëve, numri i përgjithshëm i zjarrfikësve është vetëm ¼ e standardeve evropiane. Reciprokisht, bazuar në deklaratat, normalisht duhet të jenë 2000 zjarrfikës në Kosovë. Problemet që ndodhin nga numri i ulët i zjarrfikësve janë shpjeguar praktikisht gjatë hulumtimit. Për shembull nëse kemi një zjarr të shkallës së ulët në Prishtinë, i njëjti mund të mbulohet nga brigada e zjarrfikësve, gjithashtu nëse njëkohësisht ndodh incidenti i dytë, i njëjti mund të mbulohet nga një komponentë rezervë, edhe pse me vështirësi. Sidoqoftë, zjarri i tretë ose më shumë sish përnjëherë thjeshtë nuk do të mund të mbuloheshin nga numri i tanishëm i zjarrfikësve. Në shumicën e komunave numri i tanishëm i zjarrfikësve mund të mbulojë vetëm një incident në të njëjtën kohë. Mosekzistimi i mundësisë për fikjen e njëkohshme të disa zjarreve u shkakton probleme të mëdha njësiteve zjarrfikëse. Si rezultat, kohëve të fundit në Prizren zjarrfikësi është sulmuar fizikisht nga pronari i pronës së djegur për mosarritjen me kohë.¹⁷⁶ Përveç kësaj, shërbimeve zjarrfikëse dhe të shpëtimit u mungon sistemi komandues në incident, dhe kjo shkakton huti gjatë intervenimit.

Zjarrfikësit janë duke u aftësuar në një objekt në Vushtrri. Qendra për aftësim dhe arsim është sektor i Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave, i cili është në kuadër të MPB-së, megjithëse për shkak të mungese të mjeteve dhe personelit profesional, objekti nuk mund të ofrojë shërbimet e nevojshme për brigadën e zjarrfikësve. Zjarrfikësit në Kosovë kalojnë vetëm një aftësim themelor dyjavor, dhe në disa raste, vijojnë kurse të avancuara. Sidoqoftë, përkundër nevojave, aftësimet nuk organizohen nëpër komuna. Tutje, aftësimet dhe përvoja për ndërtesat e

¹⁷⁵ Intervistë me Muharrem Beka, Kryetar i Sindikatës së Zjarrfikësve

¹⁷⁶ Intervistë me Hazir Deliaj, U.D i Shefit të Njësisë së Zjarrfikësve në Prizren

larta, pyjet dhe vërshimet janë të pakta. Për me shumë, zjarrfikësit kosovarë nuk kanë njohuri për transportimin e mallrave të rrezikshme që përmbajnë elemente kimike, biologjike, radiologjike dhe nukleare, si dhe për shpëtimin në ujëra dhe bjeshkë.

Në të shumtën e rasteve jeta e zjarrfikësve është në rrezik për shkak të mungesës së mjeteve adekuate për pajime të mbrojtjes personale. Pesëdhjetë për qind e kamionëve të zjarrit dhe shpëtimin kanë defekte teknike, që e kufizon mjaft përdorimin e tyre. Tridhjetë e gjashtë për qind e mjeteve të tjera transportuese nuk janë të përdorshme. Ekziston mungesa e procedurave standarde për alarmimin dhe për komandim në vendin e ngjarjes së incidenteve.

Në bazë të DME-së, kohëve të fundit është hartuar një plan i përgjithshëm në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare për krijimin e një sektori të efektshëm të menaxhimit të emergjencave. Është llogaritur përafërsisht se investimet në shumën diku prej 15 milionë euro në tri vitet e ardhshme do të ngrisin kapacitetet e gatishmërisë emergjente në Kosovë.¹⁷⁷ Ky hulumtim kishte të vështirë të vërtetoj nëse ky vlerësim ishte i saktë dhe se a do të mund të rimëkëmbej gatishmëria emergjente. Për më tepër, ka gjithnjë e më pak shpresa se ky planifikim i përgjithshëm do të përkrahet nga qeveria qendrore. Në këtë kontest është e ditur se përkundër disa tentimeve përgatitja emergjente nuk duket të jetë prioritet i qeverisë. Për ta dëshmuar këtë, në MPB janë caktuar disa këshilltarë për çështje të tjera, por jo edhe për gatishmëri emergjente. Gjithashtu mungojnë edhe faqet e internetit që do të tregonin strukturën e menaxhimit të emergjencave dhe, në veçanti, atë të zjarrfikësve. Janë disa objektiva të shkruara në faqen e internetit të MBP-së, mirëpo faqja specifike e internetit për këtë temë do të ishte thelbësore për vetëdijësimin e qytetarëve dhe për informimin e tyre.

Ekziston një kërkesë e madhe për një organ të centralizuar me qëllim të krijimit të një sektori të fortë të menaxhimit të emergjencave. Në bazë të zyrtarëve të DME-së sistemi qendror do të ishte më efikas në Kosovë bazuar në numrin e popullatës dhe në territorin e vogël të saj.¹⁷⁸ Madje edhe Asociacioni Evropian për Zjarrfikës në raportin e tij të vitit 2008

¹⁷⁷ Intervistë me Bislim Zyrapin, Drejtor i DME

¹⁷⁸ Aty,

për OSBE-në rekomandon një organ qendror.¹⁷⁹ Thënë më thjeshtë, këto kërkesa i referohen themelimit të një Agjencie të Pavarur për Menaxhim Emergjent me buxhet të pavarur, e cila do të reagonte në mbarë Kosovën. Organi qendror do t'i sillte në një vend të gjitha kapacitete në dispozicion, të cilat do të shfrytëzoheshin në të gjitha pjesët e Kosovës sipas nevojës dhe nuk do të bazohej në kapacitetet ekzistuese të çdo komune. Përkundër përpjekjeve është e paqartë nëse kjo kërkesë do të merret parasysh. Këto ndryshime domosdo kërkojnë ndryshimin e ligjit ose mundësisht hartimin dhe miratimin e ligjeve të reja.

2.1 Infrastruktura ligjore

Infrastruktura ligjore është dimension thelbësor në lidhje me gatishmërinë emergjente. Legjislacioni është themel për përkufizimin e masave të gatishmërisë dhe gjithashtu veprimet që duhet të ndërmerren në rast të incidenteve emergjente. Infrastruktura ligjore në lidhje me gatishmërinë emergjente përbëhet nga shumë ligje prej të cilave më të rëndësishmet janë: Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe Ligji për mbrojtjen nga zjarri.

2.1.1 Ligji 2006/02-L68 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera –Kjo rregullon masat e gatishmërisë për parandalim të rasteve emergjente ose nëse ndodh ndonjë rast i tillë, të minimizojë koston e mundshme të dëmit. Ky ligj rregullon mbrojtjen civile në rast të fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive tjera dhe mobilizimin e aktorëve relevant që mund të përfshijë mbrojtjen e shërbimeve publike në nivel lokal dhe qendror, institucioneve, ndërmarrjeve dhe organizatave tjera, shoqatave vullnetare, shoqatave profesionale dhe OJQ-ve, qytetarëve si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.¹⁸⁰ Ky ligj gjithashtu rregullon përgjegjësinë e civilëve për të bashkëvepruar dhe për t'iu përgjigjur mobilizimit civil me qëllim të tejkalimit të pasojave të fatkeqësive me humbje minimale.¹⁸¹

¹⁷⁹ Asociacioni Evropian i Zjarrëfikësve, Analizimi i gjendjes: Shërbimi i zjarrëfikësve dhe shpëtimit në Kosovë, OSBE, Shkurt 2008

¹⁸⁰ *Ligji 02/L-68 për mbrojtje kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera*, kapitulli II

¹⁸¹ Aty, Kapitulli III

Kapitulli IV rregullon kompetencat e qeverisë, të komisionit ndërministror për mbrojtje dhe shpëtim, të ministrisë së punëve të brendshme dhe të ministrive, entiteteve publike dhe të komunave.¹⁸² Përveç kësaj kapitujt tjerë të këtij ligji rregullojnë pjesët e rëndësishme siç janë programimi dhe planifikimi, sistemi unik për alarmim dhe koordinim, masat parandaluese, mbrojtja personale dhe e ndërsjellë, forcat për mbrojtje dhe shpëtim kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, administrim dhe lidërshtimi, punë profesionale dhe siguri në punë si dhe sanksionet financiare dhe administrative.

Për qëllim të këtij hulumtimi është e domosdoshme që të adresohen brengat që janë ngritur nga disa zyrtarë relevant se ky ligj nuk i përgjigjet realitetit në Kosovë dhe aq më parë është kopjuar nga disa ligje të huaja që tingëllon mirë por nuk i përgjigjet rrethanave dhe realitetit në Kosovë.¹⁸³

Tutje, disa pjesë nuk janë freskuar dhe nuk i përgjigjen kërkesave në terren. Në veçanti kjo është e qartë kur vije te dispozitat për komisionin për mbrojtje dhe shpëtim. Sipas ligjit 03/L-050 që themelon Këshillin e Sigurisë së Kosovës “gjatë gjendjes së gatishmërisë, Këshilli i Sigurisë së Kosovës ushtron autoritetin ekzekutiv dhe përgjegjësitë në emër të qeverisë siç është dhënë në nenin 13 të këtij ligji, i kufizuar në kohë dhe ato veprime që konsiderohen të domosdoshme për tu ndërmarrë në gjendje emergjente.”¹⁸⁴ Prandaj ligji për mbrojtjen kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera duhet të adaptohet me qëllim eliminimit të konflikteve të ligjit dhe hamendjeve tjera në rastin e gjendjes së gatishmërisë. Ekzistojnë edhe kundërshtime tjera legjislative në këtë ligj që lidhen me shpërbërjen e institucioneve siç janë Trupat Mbrojtëse të Kosovës që kishte rol të rëndësishëm, e mungesa e TMK-së nuk është ndryshuar në ligj.

¹⁸² Aty, Kapitulli IV

¹⁸³ Intervistë me Nehat BASHA Drejtor i Drejtorisë Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim

z. Basha theksoi se ligji jo vetëm që është kopjuar nga ligji kroat por nuk është i përputhur me rrethanat e Kosovës

¹⁸⁴ *Ligji 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës*, Kapitulli 2, neni

2.1.2 Ligji nr. 02/L-41 për mbrojtjen nga zjarri – është gjithashtu një nga ligjet më të rëndësishme për sektorin e gatishmërisë. Ai rregullon masat parandaluese, gatishmërinë në lidhje me mbrojtjen nga zjarri në rastin e incidenteve të zjarrit, rolin e institucioneve relevante dhe përgjegjësitë individuale dhe të përgjithshme në lidhje me mbrojtjen nga zjarri. Kapitulli III i këtij ligji përkufizon përgjegjësitë e institucioneve relevante siç janë komunat, ministria e punëve të brendshme dhe entitetet private për të ofruar planet e mbrojtjes kundër zjarrit në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe gjithashtu përdorimin e personelit dhe pajisjeve të mjaftueshme për mbrojtje kundër zjarrit në bazë të kategorisë së rrezikut nga I gjer në IV.¹⁸⁵

Kapitulli IV rregullon masat e mbrojtjes nga zjarri që mund të ndërmerren nga MPB dhe Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor (MMPH). Ai parasheh kushtet e veçanta të ndërtimit për rregullim hapësinor, shkallët emergjente dhe pajisjet e tjera në lidhje me mbrojtje nga zjarri në bazë të kërkesave nga MMPH, që është kërkesë që ju bëhet ndërtuesve për ta marrë lejen e ndërtimit. Ai gjithashtu parasheh se personeli i autorizuar nga MPB të marrë pjesë në komisionin për inspektimet teknike dhe dispozitën për monitorim dhe zbatim të projektit, në bazë të lejes së ndërtimit nga MMPH. Në këtë kapitull janë edhe dispozitat që lidhen me mirëmbajtjen e pajisjeve të cilat shkaktojnë zjarr si dhe të objekteve të tjera të rrezikshme, me qëllim të shmangies së incidenteve të zjarrit dhe të regjistrimit e mirëmbajtjes teknike të të gjitha kapaciteteve të instaluara për mbrojtje nga zjarri, në bazë të kushteve të MPB-së, me qëllim që të kemi pajisje funksionale kundër zjarrit nëse ndodh ndonjë rast i tillë dhe gjithashtu që të rregullohet importimi i pajisjeve për mbrojtje nga zjarri.¹⁸⁶

Kapitulli V e përkufizon rolin e stacioneve zjarrfikëse dhe të shoqatave vullnetare të zjarrfikësve si organe kryesore të shpëtimit nga zjarri. Ky kapitull e specifikon bazën ligjore për krijimin e stacioneve zjarrfikëse ose shoqatave vullnetare zjarrfikëse por gjithashtu edhe rolin e komunave për ta vlerësuar domosdoshmërinë e krijimit të stacioneve të reja zjarrfikëse në ndonjë zonë që konsiderohet si e pambrojtur, si dhe bashkëpunimin në mes të komunave fqinje për të krijuar stacione të përbashkëta zjarrfikëse për mbrojtje të avancuar nga zjarri. Gjithashtu ka

¹⁸⁵ *Ligji Nr. 02/L-41 për mbrojtjen nga zjarri*, Kapitulli III, 2006

¹⁸⁶ *Aty*, Kapitulli IV, 2006

edhe dispozita në këtë kapitull të cilat parashohin funksionimin organizativ të stacioneve dhe parasheh që stacioni i tillë të udhëhiqet nga mbikëqyrësi pa e specifikuar atë. Ka edhe dispozita për kërkesat për kualifikime profesionale për punësim në stacion të zjarrfikjes, gjë që kërkon përfundimin e shkollës së mesme dhe që kandidati të jetë më i ri se 35 vjeç. Prandaj personeli duhet të marrë pjesë në trajnimet profesionale të zjarrfikjes, me qëllim të angazhimit në operacionet e zjarrfikjes. Përveç kësaj, ky kapitull i obligon zjarrfikësit që ta veshin uniformën e njëjtë, pa i treguar strukturat e larta përmes uniformës.¹⁸⁷

Kapitulli VII rregullon mbikëqyrjen lidhur me zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri. Ai përfshin rolin e Inspektoratit të Zjarrfikjes si dhe inspektoratet e tjera relevante, siç janë Inspektorati i Pylltarisë dhe Inspektorati i Bujqësisë, të cilat kanë autoritet për t'i inspektuar masat e mbrojtjes nga zjarri. Ekzistojnë disa dispozita që i specifikojnë pozitat dhe kualifikimet e kërkuara për të qenë inspektorë, si dhe kompetencat relevante gjatë inspektimeve.¹⁸⁸ Dispozitat për sanksione administrative janë paraparë në Kapitullin X.¹⁸⁹

Ligjet e tjera – Janë edhe ligjet e tjera të rëndësishme për gatishmërinë emergjente. Në mesin e ligjeve, që lidhen direkt ose indirekt me gatishmërinë emergjente, janë:

- **Ligji 2008/03-L005 për përdorimin civil të eksplozivëve**
- **Ligji 2004/6 për transportin të mallrave të rrezikshme**
- **Ligji 2008/03-L050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës**
- **Ligji 2007/02-L78 për shëndetin publik**
- **Ligji 2006/02-L50 për shërbimet mjekësore emergjente**
- **Ligji 02/L-109 për parandalim dhe luftim kundër sëmundjeve infektive**
- **Ligji 2009/03-L-025 për mbrojtjen e mjedisit**
- **Ligji 2003/14 për planifikimin hapësinor**
- **Ligji 2009/03-L-043 për kontroll të integruar dhe parandalim të ndotjes**
- **Ligji 2005/02-L30 për mbeturina**

¹⁸⁷ *Ligji Nr. 02/L-41 për mbrojtjen nga zjarri*, Kapitulli V, 2006

¹⁸⁸ Aty, Kapitulli VII,

¹⁸⁹ Aty, Kapitulli X,

- **Ligji 2004/15 për ndërtim**
- **Ligji 2003/3 për pyjet e Kosovës**

Shumë pjesë të këtyre ligjeve edhe pse janë thelbësore, kanë dikrepancë ligjore në mes tyre,¹⁹⁰ pasi që nuk ka pasur amendamentim të ligjit që do të kontribuonte në harmonizim të ligjeve paraprake dhe të ligjeve të reja në lidhje me sektorin e sigurisë. Është me rëndësi të nënvizohet se infrastruktura aktuale ligjore nuk jep udhëzime ose dispozita në lidhje me mbikëqyrjen parlamentare ose me kontrollin demokratik.

Përkundër mangësive të sipërpërmendura ligjore shtohet nevoja për t'i miratuar ligjet e reja të cilat do t'i rregullojnë disa pjesë thelbësore të këtij sektori. Një nga nevojat më të menjëhershme është miratimi i Ligjit për Zjarrfikësit. Aktualisht zjarrfikësit konsiderohen si shërbyes civilë. Kontratat e tyre të punës janë identike me ato të të gjithë shërbyesve civilë që punojnë me kontrata. Në bazë të këtyre kontratave, ata duhet të punojnë pesë ditë në javë dhe vetëm në dy ndërrime.¹⁹¹ Megjithatë për ta kryer punën si duhet, zjarrfikësit punojnë edhe gjatë fundjavës, jashtë orarit të punës dhe gjatë ndërrimeve të natës, edhe pse këto nuk janë të përfshira në kontratat e tyre të punës. Por, ata nuk kompensohen për të. Në bazë të kësaj situatë aktuale kritike të zjarrfikësve dhe në përputhje me rëndësinë për ta pasur një strukturë funksionale është e domosdoshme që të miratohet Ligji i cili do të konsideronte zjarrfikësit si shërbyes publik, ngjashëm me SHPK-në ose Policinë Doganore.

2.2 Politikat e planifikimit dhe të vlerësimit

Kosova ende ndjen mungesë të dokumentit specifik i cili i identifikon rreziqet potenciale natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu. Raportet paraprake kanë treguar se ka pasur disa tentime për ta perceptuar këtë kategori të kërcënimeve¹⁹², por sidoqoftë ato ishin marginale dhe të pamjaftueshme. Siç tregohet nga kapitulli për nivelin lokal, vetëm disa komuna kanë përmbushur të gjitha standardet e vlerësimit të rrezikshmërisë. Fatkeqësisht shumica e komunave dhe organet qendrore e ndjejnë këtë mungesë të dokumenteve të vlerësimit. Ky hulumtim

¹⁹⁰ Intervistë me Nehat BASHA, Drejtor i Drejtorisë Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim.

¹⁹¹ Kjo pjesë bazohet në kontratat e punës së zjarrfikësve

¹⁹² Në veçanti TMK dhe DME

veçanarisht nuk mund të has në vlerësimet e duhura të rrezikshmërisë, për shembull për sëmundjet epidemike dhe posaçërisht në kërcënimet mjedisore.

Nga perspektiva ndërkombëtare, Rishikimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme në Kosovë, i drejtuar nga UNDP-ja në vitin 2006, kishte një kapitull të veçantë për kërcënimin dhe për vlerësimin e rrezikut. Ndërsa në lidhje me rreziqet natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu, ky vlerësim i vë fatkeqësitë natyrore, dhe në veçanti epidemitë, në nivel të ulët – të mesëm.¹⁹³ Kjo i përfshinte edhe mbeturinat industriale dhe kërcënimet që i shkaktohen mjedisit. Duke u mbështetur në këtë vlerësim të kërcënimit, Kosova qëndron në zonë aktive të tërmeteve me linja sizmike përgjatë bregut të Adriatikut dhe Luginës së Vardarit.¹⁹⁴ Rreziku nga tërmetet i referohet kryesisht regjionit të Gjilanit.

Duke marrë parasysh kritikën e nisura sidomos gjatë vitit 2008 nga shoqëria civile dhe komuniteti ndërkombëtar, ekipi hulumtues ka vërejtur se kohëve të fundit shihen disa përpjekje fillestare për vlerësimin e rreziqeve në nivel qendror dhe lokal. Megjithatë është i rëndësishëm së jashtëzakonshme zhvillimi i politikave të vlerësimit të rrezikut, ky hulumtim vërtetoi se asnjë nga zyrtarët nuk janë të sigurt për kohën e përfundimit të vlerësimit. Asnjë prej mekanizmave emergjent nuk mund të hartojë plane operative përderisa të identifikohen rreziqet.¹⁹⁵

Përpunimi i planeve operative në fushën e gatishmërisë emergjente është kryesisht i lidhur me Procedurat Standarde Operative (PSO). Struktura Kosovare për Menaxhim të Krizës¹⁹⁶ sqaron pesë nivele të PSO-ve duke filluar nga niveli i parë që i referohet emergjencave katastrofale e poshtë gjër te niveli i pestë për emergjencat e ulëta. PSO-të kanë për qëllim që të ofrojnë një mekanizëm koherent të reagimit midis aktorëve përkatës që janë pjesë e menaxhimit të krizave në Kosovë.¹⁹⁷ Përderisa zyrtarët e DME-së kanë besim se do të bëhet zbatimi i të gjitha PSO-ve, disa

¹⁹³ ISSR, Kapitulli III, *Vlerësimi i kërcënimit të Kosovës*, f. 39

¹⁹⁴ Aty

¹⁹⁵ Intervistë me Bislim Zyrapi, Drejtor i Departamenti i Menaxhimit Emergjent, MPB

¹⁹⁶ DFID & DME, *Struktura e Propozuar për Menaxhimin e Krizave Kombëtare*, Mars 2008

¹⁹⁷ Aty, f.1

zyrtarë përgjegjës në nivel lokal dhe qendror nuk kanë dëgjuar fare për PSO-të më herët.

Përkundër rolit të nivelit qendror dhe lokal në politikat e vlerësimit, Qendra e Situatave konsiderohet si lojtari kyç në gatishmërinë emergjente. Në të vërtetë roli i qendrës së situatave është thelbësor në kuptim të analizimit të informatave. Përveç grumbullimit të informatave nga QAKE112 është vështirë të matet nëse informatat e grumbulluara në baza ditore, javore dhe mujore janë duke u analizuar. Çdo hulumtim i kryer në lidhje me qendrën e situatave shkakton vështirësi në grumbullimin e konstatimeve pasi që Ligji për klasifikimin e informatave ende nuk është miratuar. Në të vërtetë në lidhje me këtë ligj, zyrtarët janë ngurues që të bëhen më transparent. Tutje, qendra e situatave mund të ketë rol më të rëndësishëm në vlerësimin e rreziqeve natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu duke marrë parasysh rolin e tij si organ mbështetës të Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës (KSK). Në bazë të ligjit të aplikueshëm, KSK në koordinim me institucionet relevante është përgjegjës për hartimin e Strategjisë së sigurisë së Kosovës.¹⁹⁸ Ky dokument, siç është paraparë që të jetë më i larti në këtë sektor, duhet doemos të identifikojë rreziqet dhe kërcënimet në Kosovë. Strategjia e sigurisë ka gjasa të përfaqësojë “kushtetutën” e sektorit të sigurisë pasi që ai tregon vizionin, kërcënimet e identifikuara dhe aktivitetet që duhet të ndërmerren gjatë viteve në vijim.

3. Matja e performancës së gatishmërisë emergjente në nivelin lokal

Përgjegjësia për fushën e emergjencës në nivel lokal dhe qendror ndahet nga shumë aktorë. Ligjet aktuale në fuqi kanë caktuar përgjegjësi të shumta qeverisë lokale dhe në veçanti komunave. Kompetencat e komunave për emergjencë janë të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera nën nenin 31.¹⁹⁹ Disa nga ato përgjegjësi parashohin themelimin e Sektorit ose Departamentit

¹⁹⁸ *Ligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës*

¹⁹⁹ *Ligji për mbrojtjen kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera*

¹⁹⁹ Aty,

për mbrojtje dhe shpëtim që do të drejtojë zjarrfikësit, inspektorët lokal dhe do të bashkërendon punën. Pasi që Ligji thekson se pushteti lokal është përgjegjës për emergjenca, i bie qeverisë lokale që të ketë ekip të gatishmërisë emergjente që është i aftë për tu përballë me të gjitha situatat. Ky sektor ose departament zakonisht mbikëqyr personelin, inspektorët që vëzhgojnë terrenin, departamentin lokal të zjarrfikjes dhe institucionet e tjera që janë të përfshira në aspektet e emergjencës.²⁰⁰ Gjendja e tanishme e gatishmërisë emergjente në pesë regjione në Kosovë nga zyrtarët lokalë shpjegohet si vijon:

3.1 Regjioni i Prishtinës

Territori mbulon pjesën qendrore të Kosovës dhe është një nga regjionet më të mëdha. Territori është nën autoritetin e Komunës së Prishtinës dhe mbulon Lipjanin, Obiliqin, Podujevën, Fushë Kosovën dhe Gllogovcin. Me popullsi prej 600.000 gjer në 800.000 banorë, ky është regjioni më i populluar në Kosovë. Regjioni i Prishtinës është gjithashtu qendra e zhvillimit ekonomik që do të thotë se ka fabrikat kryesore dhe bizneset tjera me rëndësi siç është Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Aeroporti ndërkombëtar, të gjitha institucionet e qeverisë qendrore, spitalet, etj. Duke pasur të gjitha këto institucione dhe biznese të rëndësishme dhe pasi që mbulon territor të gjerë, regjioni i Prishtinës gjithmonë është në rrezik ndaj situatave emergjente që do të kërkonin menaxhim nga autoritetet lokale. Numri i personelit që duhet të punojë në sektorin e emergjencës varet nga terreni dhe popullsia e komunës. Pasi që Prishtina mbulon një territor të madh, rreziqet dhe problemet varen nga pozita gjeografike e komunës që janë të ndryshme nga njëra tjetra. Zyrtarët komunal mundohen që të vendosin prioritetet e tyre në bazë të kërcënimeve specifike që janë në regjionet e tyre.

Në regjionin e Prishtinës janë disa pjesë të qytetit që janë në kërcënim konstant nga vërshimet nga lumi siç është Sitnica në territorin e Obiliqit.²⁰¹ Gjithashtu edhe në fshatrat Shkabaj dhe Makovc problemi i vërshimit është permanent.²⁰² Përkundër vërshimeve edhe terreni është i

²⁰⁰ Aty,

²⁰¹ Intervistë me Xhabir Çunaku, Drejtor i sektorit të emergjencës në komunën e Obiliqit

²⁰² Intervistë me Avdi Paçarda, Drejtor i sektorit të emergjencës në komunën e Prishtinës

papërshtatshëm ku sipërfaqja rrëshqet ose lëviz që rrezikon popullsinë që jeton në zonën përreth. Qeveritë lokale kanë probleme për të gjetur zgjidhje edhe për këtë çështje. Për këto çështje përgjegjësia është duke u hedhur si “ping-pong” nga një institucion te tjetri dhe nga qeveria lokale në atë qendrorë. Ky problem vërehet kryesisht në territorin e Obiliqit dhe fshatin Hade dhe shfaqet për shkak të mihjeve konstante nga KEK-u.²⁰³ Përkundër faktit se qeveritë lokale nuk kanë kapacitetin e parandalimit të këtyre problemeve, ato kanë mungesë të fondeve për t’u përballë me vërshime dhe problemet me mihje.

KEK-u gjithashtu paraqet kërcënim për qytetin e Prishtinës. KEK-u është ndotësit kryesor në Kosovë dhe duhet të konsiderohet si kërcënim mjedisor. Ai ka të depozituar substanca radioaktive që janë të mbrojtura keq dhe qeveria lokale nuk ka pajisjet e duhura për t’u marrë me këtë problem. Një nga këto substanca është Fenoli (gjurmët e së cilit mund të gjenden nën tokë rreth 20 km nga lokacioni i KEK-ut).²⁰⁴ Në zonën e Lipjanit gjendet një depo që është afër zonës së banuar dhe nuk janë ndërmarrë kurrfarë masash sigurie për të mbrojtur atë zonë nga shpërthimi i mundshëm i depos.²⁰⁵

Zjarrfikësit janë aktorë të rëndësishëm në përballje me kriza në veçanti në aksidentet me zjarr. Vetëm komuna e Prishtinës ka brigadë të zjarrfikësve²⁰⁶ kurse rajonet tjera kanë vetëm njësite të zjarrfikësve. Sfida kryesore për zjarrfikësit është mungesa e fondeve dhe trajnimit të standardizuar dhe profesional që do t’i mundësonte ata të kryejnë funksionin e tyre me sukses. Edhe pse ekzistojnë fonde që i dedikohen mbështetjes së Shërbimeve zjarrfikëse dhe atyre të shpëtimit, udhëheqësit komunal kanë tendencë që të shpenzojnë ato fonde për qëllime tjera gjë që rezulton në mungesa një numri të mëdha të pajisjeve zjarrfikëse që mund të rezulton kërcënuese për jetën e zjarrfikësve. Pasi që puna e zjarrfikësit nuk paguhet mjaft dhe ka mungesa të përfitimeve tjera në veçanti duke pasur parasysh rreziqet e kësaj pune, është vështirë që të motivohen ata e aq më parë vështirësohet rekrutimi i stafit të ri. Nevoja

²⁰³ Aty,

²⁰⁴ Aty,

²⁰⁵ Intervistë me Agim Bylykbashin, Drejtor i sektorit të emergjencës në komunën e Lipjanit

²⁰⁶ Afro 120 zjarrfikës

për më shumë zjarrfikës është një nga brengat kryesore e autoriteteve përgjegjëse të qeverive lokale.

Një nga problemet më brengosëse është se qeveritë lokale nuk kanë strehimore publike. Ato gjithashtu kanë mungesë të rezervave të ushqimit, barnave dhe furnizimeve tjera që do të duhen për akomodim në kohë të krizave emergjente. Në disa krahina në regjionin e Prishtinës qeveritë lokale kanë tentuar që të kontraktojnë bizneset lokale për të siguruar ato mallra në kohë të nevojave por asgjë nuk është ndërtuar as depozituar nga qeveria lokale edhe pse kjo është një nga përgjegjësitë e tyre.²⁰⁷ Nuk ka as linjë buxhetore për strehimore publike. Në krahasim me regjionet tjera, komuna e Prishtinës ka linjë buxhetore të kufizuar për investime kapitale. Investimi i vetëm që do të bëhet është ndërtimi i stacionit të zjarrfikësve në Arbëri që në krahasim me nevojat është zotim shumë solid në këtë kuptim. Është me rëndësi të theksohet se Prishtina është shembull i mirë i bashkëpunimit me institucionet tjera kur vije te bashkëpunimi në sektorin e emergjencës.²⁰⁸ Këto institucione janë për shembull Shërbimi Policor i Kosovës, KFOR-i dhe Shërbimet e ambulancës ose Departamenti i Menaxhimit të Emergjencës. Kjo marrëdhënie forcohet përmes disa ushtrimeve me simulim të krizave që ata mbajtën së bashku në disa raste. Sipas zyrtarëve, komuna e Prishtinës është e vetmja që ka qendër të duhur të alarmimit në krahasim me regjionet tjera.

3.2 Regjioni i Mitrovicës

Regjioni i Mitrovicës është regjioni më i komplikuar gjer tani. Që nga viti 1999 ai ka qenë i ndarë në dy anë: anën shqiptare dhe anën serbe. Të dyja anët administrohen ndaras pa bashkëpunim në mes të anës veriore dhe jugore. Pasi që nuk ndahen informatat në mes të dy anëve, është vështirë të merret numri i saktë i popullsisë atje. Regjioni i Mitrovicës mbulon territorin e Vushtrrisë, Zveçanit, Zubin Potokut, Leposaviqit dhe Skenderajt. Është territor me tokën më të pasur dhe për këtë arsye disa nga fabrikat më të mëdha në Kosovë gjenden atje, edhe pse disa nga to nuk janë aktualisht funksionale. Në regjionin e Mitrovicës janë katër lumenj dhe terreni i tij gjeografik kufizohet me male.

²⁰⁷ Aty,

²⁰⁸ Intervistë me Avdi Paçarda, Drejtor i sektorit të mbrojtjes dhe shpëtimit në komunën e Prishtinës

Në regjionin e Mitrovicës sektorët emergjent janë organizuar në divizione për mbrojtje dhe shpëtim si pjesë e komunës për çdo territor. Ato kanë rreth 40 punëtorë përfshirë zjarrfikësit për çdo qytet. Zyrtarët e komunës së Mitrovicës tregojnë se ata kanë kryer vlerësimet e rrezikut për territoret e tyre. Kjo në veçanti vërehet në departamentin e Vushtrrisë pasi që ata kanë vlerësuar kërcënimet e tyre lokale dhe bile kanë hartuar planin e tyre operativ në rast se ato ndodhin.²⁰⁹

Në këtë regjion janë katër lumenj, prandaj brenga kryesore është vërshimi. Kjo kryesisht shihet në territorin e Vushtrrisë. Një lum kalon përmes qendrës së qytetit dhe kur bie shi ose gjatë dimrit ky lum ka tendenca të daljes nga shtrati. Për këto raste komuna e Vushtrrisë ka krijuar një plan të veprimit.²¹⁰ Qyteti i Mitrovicës ende përballet me problemet e ngjashme pasi që lumi kalon përgjatë qytetit dhe ndonjëherë vërshon.²¹¹ Hapi i parë ishte krijimi i planit të veprimit dhe më pas të kontraktohet një kompani private për të mirëmbajtur rrjedhën e lumit brenda qytetit. Një nga hendikepet kryesore në regjionin e Mitrovicës është se Qendra e alarmimit dhe koordinimit urgjent 112 (QAKE 112) ende nuk është funksionale dhe kohëve të fundit është vendosur që të funksionojnë brenda 112 të Prishtinës. QAKU 112 jofunksionale në Mitrovicë shkakton shumë vështirësi në kuptim të pranimit të informatës për gjendjen në këtë pjesë të Kosovës.

Pasi që disa pjesë të regjionit të Mitrovicës janë të rrethuara me terrene të larta dhe monumente, ndonjëherë duket se komuna duhet të merret me lëvizjet tektonike të tokës. Kjo është në veçanti rasti në disa vende afër Vushtrrisë dhe parashihet gjithashtu që të shfaqet në disa pjesë tjera të këtij regjioni.²¹² Përveç lëvizjeve tektonike, zjarret gjithashtu paraqesin problem sepse Vushtrria është afër disa pyjeve regjionale. Ky kërcënim është parë në vitin 2007 kur zjarret shpërthyen në këtë regjion duke dëmtuar shumë prona private.²¹³ Sikurse në çdo regjion tjetër në Kosovë, Mitrovica ka problem me Shërbimet e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit,

²⁰⁹ Intervistë me Shefqet Aliu, Drejtor i sektorit të mbrojtjes dhe shpëtimit në komunën e Mitrovicës

²¹⁰ Intervistë me Nazmi Pantina, Sektori i emergjencës në komunën e Vushtrrisë

²¹¹ Aty,

²¹² Aty,

²¹³ Aty,

kryesisht për shkak të shkurtimit të fondeve që çoi në mungesë të zjarrfikësve. Gjithashtu ka nevojë për pajisje përkatëse dhe domosdoshmëri tjera. Disa nga problemet tjera që janë parë janë mungesa e fondeve për sektorin e emergjencës dhe fakti se të gjitha qytetet kanë mungesë të strehimores publike. Në disa raste strehimoret ekzistojnë por nuk janë funksionale pasi që nuk mirëmbahen. Dilema që është e përbashkët me regjionet tjera është se regjioni i Mitrovicës gjithashtu nuk ka rezerva të ushqimit dhe barnave për raste emergjente. Kërkohen ligjet që do të ndihmojnë në delegimin e punës për sektorin e emergjencës dhe bashkëpunim në mes të gjithë personave dhe personelit profesional.²¹⁴

3.3 Regjioni i Pejës

Komuna e Pejës mbulon territorin e Pejës, Gjakovës, Deçanit, Klinës, Istogut dhe Junikut dhe terreni unik gjeografik është i rrethuar me male dhe pyje. Ka popullsi prej 225,000 banorëve që e bën një nga qytetet më të mëdha në Kosovë. Komuna e Pejës ka sektorin e vet të mbrojtjes emergjente që merret me të gjitha problemet që lidhen me emergjencë. Pasi që qyteti i Pejës është i rrethuar me male, ajo përballet me shumë zjarre. Kjo gjendje kërkon shërbime plotësisht operacionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit.²¹⁵ Fatkeqësisht kjo nuk është e vërtetë pasi që zjarrfikësit e tyre përballen me problemet e njëjta sikurse kolegët e tyre përgjatë Kosovës. Edhe ata kanë mungesë të trajnimeve profesionale dhe fondeve që është arsyeja kryesore për mungesë të pajisjeve përkatëse duke filluar nga automjetet motorike, pajisjet personale që përfshinë pajisjet për komunikim, pajisjet për frymëmarrje, etj. Ata gjithashtu përballen edhe me mungesë të resurseve njerëzore.²¹⁶

Një problem tjetër me të cilin përballet Peja është bashkëpunimi jo i mirë me komunat dhe institucionet tjera, përveç me SHPK, Kryqin e Kuq të Kosovës dhe Departamentin e Menaxhimit të Emergjencave. Ata kanë kulturë të dobët të komunikimit dhe bashkëpunim me popullsinë lokale, edhe pse roli që mund të luaj popullsia lokale në disa raste mund të jetë

²¹⁴ Aty

²¹⁵ Intervistë me Smail Shala, Drejtor i sektorit të emergjencës në komunën e Pejës

²¹⁶ Aty,

thelbësor. Ata veçanërisht nuk kanë bashkëpunim të mirë dhe asistencë nga popullsia lokale.²¹⁷ Në këtë regjion thuhet se komuna e Gjakovës ka pothuajse të gjitha pajisjet e domosdoshme dhe personelin për tu përballë me incidente. Zyrtarët tregojnë një kohë të gjatë ky sektor në Gjakovë është llogaritur si shumë i rëndësishëm dhe niveli i gatishmërisë emergjente është ende në nivelin e kënaqshëm.

3.4 Regjioni i Gjilanit

Gjilani gjendet në pjesën juglindore të Kosovës. Në regjionin e Gjilanit jetojnë afro 250,000 banorë. Regjioni mbulon komunën e Gjilanit, Kamenicës, Novobërdës dhe Vitisë. Terreni është kryesisht i hapur me disa pjesë me male dhe kodra.

Në regjionin e Gjilanit komunat kanë themeluar Departamentin për mbrojtje dhe shpëtim dhe personeli i tyre është rreth 20. Për shembull në sektorin e emergjencave në Gjilan punëson 40 punëtorë prej së cilëve 31 janë zjarrfikës. Sektori i emergjencave në Kamenicë punëson rreth 24 punëtorë. Të dy sektorët kanë shprehur mungesë të personelit pasi që duhet të mbulojnë terriore të mëdha dhe gjithashtu në disa raste duhet të asistojnë komunat lokale²¹⁸. Puna e sektorëve të emergjencës është koordinimi dhe organizimi i punës së përditshme dhe të vlerësojnë rrezikun për zonën e tyre.

Zjarrfikësit e tyre gjithashtu përballen me problemet e njëjta sikurse zjarrfikësit tjerë në Kosovë. Ata kanë mungesë të pajisjeve përkatëse pasi që shumica e pajisjeve janë të vjetruara dhe kërkojnë shumë investime për t'i bërë funksionale. Gjithashtu rrogat e tyre nuk janë shumë të larta, në veçanti duke pasur parasysh punën që bëjnë. Ata gjithashtu nuk marrin përfitime shtesë e as që paguhen për punën jashtë orarit. Ekziston nevoja për më shumë zjarrfikës por ky problem në komunën e Gjilanit është zgjidhur përkohësisht pasi që ata punësojnë zjarrfikës sezonal.²¹⁹ Sidoqoftë shtrohet pyetja nëse këta zjarrfikësit sezonal kanë ndjekur trajnime adekuate apo jo? Edhe pse ekziston brigada tjetër e porsa themeluar e zjarrfikësve e përbërë nga pesë zjarrfikës dhe një koordinator

²¹⁷ Aty,

²¹⁸ Intervistë me Fazli Avdullahu , Departamenti për mbrojtje dhe shpëtim, komuna Gjilan

²¹⁹ Aty,

në Hanin e Elezit, brigada nuk ka trajnimin themelor dhe pajisjet për tu konsideruar si operacionale.

Kërcënimet unike në regjionin e Gjilanit janë tërmetet. Kjo është një nga brengat kryesore. Për të parandaluar çfarëdo katastrofe të ardhme, komuna e Gjilanit ka krijuar një institucion që monitoron aktivitetet sizmike në regjion.²²⁰ Ky veprim është ndërmarrë pas tërmetit të prillit 2002. Qendra gjithashtu shërben si qendër alarmi për tërmete në regjionin e Gjilanit. Përkundër tërmeteve, problem tjetër paraqesin zjarret dhe vërshimet në këtë regjion. Pasi që departamentet e emergjencës në regjione kanë vetëm fonde të kufizuara në dispozicion, nuk është e mundur që të tentohet të parandalohen ato pasi që ata mund të veprojnë vetëm kur të jetë e domosdoshme.²²¹

Bashkëpunimi në mes të institucioneve është i mirë, në veçanti me KFOR-in dhe SHPK-në dhe Kryqin e Kuq të Kosovës. Edhe bashkëpunimi me popullsinë serbe në këtë regjion është i mirë pasi që ata kanë pasur disa ndërhyrje në regjion që janë kryesisht të banuara nga serbët dhe nuk përballen me probleme.²²²

Zyrtarët në regjion treguan se kanë nevojë për më shumë fonde, hapësirë më të mirë të punës dhe kushte për punëtorët e tyre. Gjithashtu kërkuan Ligjin për zjarrfikësit dhe personelin profesional për gatishmëri të emergjente. Të gjitha këto probleme gjenerohen nga financimi i varfër dhe më pak vëmendje nga qeveria qendrore dhe qeveria lokale.

3.5 Regjioni i Prizrenit

Institucionet emergjente në Prizren janë të organizuara nën Departamentin për mbrojtje dhe shpëtim. Ky departament koordinon Shërbimet e zjarrfikësve dhe të shpëtimit, gjithashtu edhe Zyrtarët për parandalim dhe Zyrtarët për planifikim dhe QAKU 112. Në Suharekë dhe Dragash sektori i emergjencës është organizuar nën Departamentin për shërbimet publike. Numri i punëtorëve në këtë sektor në Prizren është shumë i ulët në krahasim me numrin e banorëve që është rreth

²²⁰ Aty,

²²¹ Aty

²²² Aty,

350.000.²²³ Regjioni i Prizrenit përfshinë Suharekën, Dragashin, Rahovecin dhe Malishevën.

Në bazë të diskutimeve me grupet e fokusit kërcënimet kryesore të regjionit janë zjarret, epidemitë, erozioni i lumenjve, mbeturinat industriale dhe fatkeqësitë ekologjike, rrëshqitjet e dheut dhe vërshimet. Sa i përket incidenteve me zjarr, regjioni i Prizrenit përfshinë disa komuna tjera që kanë pjesën më të madhe të territorit të mbuluar me male. Gjatë verës 2007, regjioni i Prizrenit është përballë me incidente të mëdha të zjarrit dhe ishte problem i madh për t'i kthyer nën kontroll²²⁴ prandaj në këtë situatë është shprehur asistenca e rëndësishme e KFOR-it në Prizren. Vendet publike siç janë shkollat, stacionet e autobusit dhe spitalet nuk janë pajisur për rreziqe të tilla.

Lumi Drini kalon përmes Prizrenit dhe qeveria lokale neglizhon rregullimin e anëve të lumit për të parandaluar vërshimin. Ky konsiderohet rreziku më i madh për njerëzit dhe pronën e tyre.²²⁵ Gjithashtu qeveria lokale dhe Departamenti i shëndetësisë nuk ushtron kontroll strikt të mallrave që arrijnë në Kosovë. Ky regjion është në rrezik nga mbeturinat industriale. Më e rrezikuara është Depoja e hekurit skrap në Landovicë. Ky është vendi ku shumë komuna hedhin mbeturinat e tyre që paraqesin kërcënim të madh për mjedisin dhe njerëzit që jetojnë atje.²²⁶ Ekipi hulumtues kuptoi se Departamenti i mbrojtjes dhe shpëtimit në Prizren ka hartuar plane të ndryshme operative për ngritjen e nivelit të gatishmërisë emergjente. Ata kanë vlerësuar planet për personat në rast të nevojës, planin për të parandaluar emergjencat, planin për reagim ndaj zjarrit në male, për të luftuar fatkeqësitë epidemike dhe fatkeqësitë ekologjike. Ata gjithashtu treguan për planin e reagimit dhe ndërhyrjes në koordinim me institucionet tjera emergjente siç është Agjencia e pylltarisë, Shërbimi Policor i Kosovës dhe Shërbimet e mjekësisë emergjente.²²⁷

Disa institucione janë të përgatitura më mirë dhe kanë kapacitet të mjaftueshëm për tu përballë me emergjencat e ndryshme. Si shembull,

²²³ Intervistë me Nehat Basha, Departamenti për mbrojtje dhe shpëtim në Prizren

²²⁴ Intervistë me Hazir Deliaj, ushtrues detyre i shefit të zjarrfikësve në Prizren

²²⁵ Intervistë me Nehat Basha, Departamenti për mbrojtje dhe shpëtim në Prizren

²²⁶ Aty,

²²⁷ Intervistë me Halil Blakaj, Shef i QAKU 112 në Prizren,

Shërbimi i zjarrfikjes dhe i shpëtimit në Prizren ka bashkëpunim të mirë me komunat tjera siç është Suhareka dhe Dragashi dhe e kanë mbështetur me kapacitetin e tyre për të ndërhyrë. Departamenti i mbrojtjes dhe shpëtimit në Prizren përballet me shumë probleme që pengojnë punën.²²⁸ Ata nuk kanë rezerva në barna, ushqime ose ujë rezervë për pije për fatkeqësitë e ndryshme në situata emergjente.²²⁹ Nga qendra për thirrje emergjente thonë se banorët bëjnë thirrje false në Qendrën e alarmit 112. Rezultati është se policia duhet të konfirmojë së pari emergjencën e më pas të ndërhyjnë.

Në përgjithësi janë disa vështirësi me të cilat përballen shërbimet emergjente duke filluar nga problemet financiare, resurset njerëzore, ligjin për zjarrfikësit, trafikun dhe rrugët, problemet për të arritur në kohë për ndërhyrje, nuk ka trajnime profesionale, mosha shumë e vjetër e punëtorëve institucionale, problemet e ndërtimeve për ndërhyrje të suksesshme, objekti i vogël i qendrës së emergjencës në Prizren, orari i gjatë i punës, të ardhurat shumë të ulëta dhe strehimoret publike.

Komunat	Departament/Drejtori apo Sektor?	Nr. i zjarrfikësve	Nr. i banorëve	Buxheti për emergjenca €	Vërejtje
Deçani	Departamenti për Mbrojtje dhe Shpëtimit	5	40,000 +		
Dragash	Drejtoria komunale për ShP dhe Mbrojtje dhe Shpëtimit	18	41,000		
Gjakova	Drejtoria për Gatishmëri Emergjente	50	150,000	235,000	
Drenasi	Drejtoria për ShP dhe Emergjencë	17	73,000		

²²⁸ Aty,

²²⁹ Intervistë me Nehari Shporta, Shef i ndihmës së parë në Prizren

Gjilan	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	30	130,000 +		Nuk kanë buxhet të vecant, në kuadër të DShP
Istog	Drejtoria për ShP dhe MSh	11	56,000		
Kaçanik	Sektor në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë	18	43,000		Buxheti në kuadër të DShP
Klinë	Drejtoria për ShP dhe Emergjencë	16	55,000 (përafërsisht)		
Fushë Kosovë	Sektor në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë	5	50,000		
Kamenicë	Sektor në kuadër të Drejtorisë për ShP	24	63,000	28,000	
Mitrovicë	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	36 34	110,000 (Veri) 20,000 (Jug)		Nuk ka informata
Leposaviq		14	18,600		
Lipjan	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	18	76,000		Buxheti në kuadër të Drejtorisë për ShP
Malishevë	Drejtoria për ShP dhe Emergjencë	18	65,000		
Artanë	Drejtoria për Emergjencë	5	3,900		

Obiliq	Drejtoria për ShP dhe Emergjencë	-	30,000		Mbulohet nga BrZSh e Prishinës apo nga njësi ZSh e KEK-ut
Rahovec	Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, shërbime komunale, kadastër, gjeodezi, pronë dhe mjedis	18	73,700		
Pejë	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	36	170,000	80,000 Mallra dhe Shërbime 40,000 Investime kapitale	
Podujevë	Sektor i Emergjencës në kuadër të Drejtorisë për planifikim urban, kadastër dhe mbrojtjen e mjedisit	18	130,000		
Prishtinë	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë Civile	136	500,000 – 600,000		
Prizren	Drejtoria komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim	24	240,000	70,000 për mallra dhe shërbime 250,000 për investime kapitale	
Skënderaj	Sektor në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike	17	72,600		

Shtime	Sektor nëkaudër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale	8	29,000		
Shtërpcë	Koordinator për Mbrojtje dhe Shpëtim	4	13,600		
Suharekë	Sektor në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike	15	80,000		Buxheti në kuadër të Drejtorisë për ShP
Ferizaj	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjncë	32	160,000 – 170,000	360,000	Buxhet i përbashkët
Viti	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjncë	21	59,800		
Vushtrri	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	31	102,600	45,000	
Zubin Potok		11	14,900		Nuk kemi siguruar informatat për emërtim
Zveçan			17,000		

3.6 Sindikata e zjarrfikësve

Sindikata është themeluar në mars 2009 prandaj rrjeti dhe aktivitetet për këtë kohë janë në fazat e hershme. Megjithatë sindikata ka bashkëpunim të mirë me institucionet tjera dhe ndjek aktivisht përmirësimin e kushteve të zjarrfikësve, sidoqoftë ka vështirë të ndryshme që pengojnë sindikatën në përmbushjen e të priturve të zjarrfikësve me efikasitet më të madh. Përfaqësuesit e sindikatës tentuan që të bashkohen me

Sindikatën e Policisë së Kosovës por kërkesa nuk është pranuar.²³⁰ Megjithatë sindikata rregullisht angazhohet në bashkëpunim me DME-në, SHPK-në dhe mekanizmat tjerë relevant.

Siç u tha më sipër, njësitë e zjarrfikësve janë vendosur nën menaxhim direkt të komunave. Çdo komunë ka stacionet e veta të zjarrfikësve, dhe përgjatë Kosovës janë rreth 600 zjarrfikës të organizuar në gjashtë regjione. Në bazë të të dhënave të sindikatës, në një vit të vetëm janë mbi një mijë e dy qind (1200) raste të ndërhyrjes përgjatë Kosovës. Sindikata ka treguar brenga të ndryshme në lidhje me kushtet e vështira të punës për zjarrfikësit dhe si rrjedhojë jeta e tyre është në rrezik konstant, punojnë në distanca të largëta me rroga shumë të vogla.²³¹

Një çështje tjetër është procesi aktual i sindikatës për konsolidim të brendshëm, pasi që ende përballet me disa koncepte kryesore të menaxhimit të aktiviteteve të tyre. Në lidhje me këtë, kjo sindikatë nuk ka ndonjë plan veprimi, prioritet të aktiviteteve dhe listë të partnerëve. Sidoqoftë ekziston ndjenja e entuziazmit dhe interesimit për misionin e tij për mbrojtje të interesave të zjarrfikësve, fati i kësaj sindikate shumë varet nga përmirësimi i organizatës së brendshme, mënyrën si do të përfshihet me aktorët vendimmarrës, dhe përfundimisht statusin final ligjor. Prandaj kërkesat e tyre nuk mbështeten vazhdimisht siç është rasti me sindikatat tjera në Kosovë. Gjer tani, kjo sindikatë aktualisht ka kapacitete të kufizuara për të ndikuar në zhvillimet e përgjithshme në lidhje me gatishmërinë emergjente.

4. Gatishmëria emergjente tek ministritë, agjencitë dhe mekanizmat tjerë

4.1 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Kërcënimet mjedisore në përgjithësi perceptohen si një nga dimensionet më sfidues për sigurinë njerëzore. Për të qenë më të saktë, tek njerëzit nevoja për tu ndier i sigurt e ngritë rëndësinë për marrjen e masave në

²³⁰ Aty, Zyrtari nuk dha shpjegime shtesë pse sindikata e policisë ka refuzuar bashkimin me sindikatën e zjarrfikësve

²³¹ Intervistë me Muharrem Beka, Shef i sindikatës së zjarrfikësve

lidhje me parandalimin e shkatërrimeve mjedisore.²³² Përkundër faktit se koncepti i sigurisë mjedisore është ende duke u zhvilluar, fatkeqësitë ekologjike praktikisht zënë pjesën më të madhe në masat e gatishmërisë emergjente gjetiu.

Në Kosovë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për tu marrë me çështjet mjedisore prandaj ka një departament të ndarë për mbrojtje të mjedisit, që përbëhet nga katër sektor: mbrojtje të natyrës nga ndotësit industrial, menaxhim të mbeturinave, planifikim emergjent dhe politikat për mbrojtje mjedisore. Të gjithë këta aktorë udhëhiqen pa ndonjë plan veprimi dhe nuk ka udhëzime të qarta për mënyrën si të përballet me situata emergjente nëse ato shfaqen. Departamenti ka mungesë të personelit, me vetëm pesë punëtorë, dhe duket se është pothuajse e pamundur që të sigurohet zbatimi i legjislacionit në këtë çështje. Tutje, nuk ka planifikime të qarta dhe gjithëpërfshirëse ose listë të kërcënimeve potenciale dhe reale mjedisore, kryesisht nga ndotësit e ujit, ajrit dhe tokës. Në disa raste emergjente ky departament ka luajtur rolin e vet në reduktimin e dëmit ndaj mjedisit dhe ka luajtur rol koordinues me institucionet tjera. Sidoqoftë është e qartë se kjo bëhet nën orientim konfuz në lidhje me rolin, kapacitetet dhe zgjidhjen e problemit. Edhe pse kjo Ministri është e përfshirë në përgatitjen e planit emergjent ndërinstytucional, i udhëhequr nga DME, kontributi i saj mund të jetë i vogël për shkak të funksionimit të dobët të brendshëm të departamentit.

Nga ky pikëvështrim, departamenti ministror konsideron se fushat më të ndjeshme të ndërhyrjes janë regjionet me ndotës industrial siç janë KEK-u dhe Ferronikeli. Sidoqoftë reagimi i ministrisë për të gjetur zgjidhje në këto probleme akute ka qenë i ngadalshëm dhe kryesisht bazohet në ndryshim të legjislacionit. Ligji i ndryshuar që do të paraqitet së shpejti pritet që të krijojë kushte ku do të ketë udhëzime më të qarta për mënyrën si të përballet me kërcënime mjedisore. Sidoqoftë në bazë të ligjit aktual ky departament është ende duke punuar pa synim të qartë të urgjencës dhe ndjeshmërisë në lidhje me kërcënimet mjedisore dhe dëmet që bëhen për çdo ditë. Kontributi i saj mund të përmblihet në hartimin e udhëzimit administrativ, disa përfshirje në disa situata emergjente dhe vizita fushore. Sipas zyrtarëve, pas prezantimit të

²³² Collin Alan, *Studimet bashkëkohore të sigurisë, siguria mjedisore*, f.188

udhëzimit administrativ, ata do të jenë në gjendje që të përfshihen në mënyrë institucionale. Në këtë gjendje ata thonë se nuk kanë mbështetje ligjore për të ndërmarrë shumë aktivitete në lidhje me këta ndotës.²³³

Përkundër kësaj, ministria nuk bashkëpunon me institucionet tjera por ende ka dobësi në koordinim në mes të këtij departamenti dhe institucionet tjera. Edhe pse brenda qeverisë është një ekip nga dhjetë inspektorë që punojnë për çështje mjedisore dhe materie të rrezikshme, ende ka mungesë të udhëzimeve që do të rregullojnë transportin e materieve të rrezikshme dhe mungesën e vendeve për depozitim.²³⁴ Praktikisht kjo çështje është brenda kompetencave të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit. Ekipi hulumtues kuptoi se çështjet e brengave të veçanta në nivel lokal kanë të bëjnë me mungesën e ekspertëve që merren me kërcënimet mjedisore. Në përgjithësi ky departament është larg nga ajo që të numërohet institucion që menaxhon kërcënimet aktuale, dhe nga ky pikëvështrim është e pamundur që të parashihet angazhimi i tij i ardhshëm në lidhje me kërcënimet potenciale dhe të paparashikuara ndaj mjedisit dhe jetës së njeriut.

4.2 Ministria e Administrimit të Pushtet Lokal

Detyra kryesore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është monitorimi i performancës së strukturave lokale dhe kjo përfshinë kryetarët e komunave, kuvendet, drejtoritë komunale, etj. Pasi që ministria ka mandatin për të monitoruar zbatimin e Ligjit për pushtetin lokal, nuk ka lidhje direkte në mes të këtij institucioni dhe institucioneve tjera emergjente. Në rastin e çështjeve legjislativë që dalin në lidhje me institucionet përgjegjëse për emergjenca, është ministria që duhet të përfshihet, përkundrajt rolit të saj pasiv në lidhje me performancën e komunave në lidhje me menaxhimin e emergjencave.²³⁵

Përkundër kësaj, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mund të ndikojë në përmirësime përmes mbështetjes financiare për komunat duke dalë me projekte të ndërlidhura. Në këtë kontekst ka mungesë të madhe në bashkëveprim të ndërsjellë, në mes të Ministrisë dhe komunave,

²³³ Intervistë me Adem Tusha, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor

²³⁴ Aty,

²³⁵ Intervistë me Naim Behluli, Këshilltar politik në Ministri të Administrimit të Pushtetit Lokal

bashkëpunim i cili do të mund të rezultonte në përmirësimin e qasjes së komunave për sektorin e emergjencave. Ministria nuk ka mandat për të udhëzuar komunat në lidhje me përmirësimet e menaxhimit të emergjencave, prandaj mund të thuhet se ka vëshirësi të mëdha për të ndikuar në komuna. Masat e legjislacionit të ri do të nevojiten me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit ndërkomunal, tani për tani ministria ka mundur t'i ofroj vetëm opinionet e veta për çështje të caktuara pa pasur mundësi vendimmarrje. Si përfundim, kjo ministri ofron vetëm kontribut simbolik në lidhje me menaxhimin e fushës së emergjencës.

4.3 Kryqi i Kuq i Kosovës

Kryqi i Kuq i Kosovës ka zyra operuese në njëzetë e gjashtë komuna. Organizimi i brendshëm menaxhohet në mënyrë fleksibile, varësisht nga natyra, personeli, resurset dhe zbatimi i projektit. Prosesi vendim-marrës është i centralizuar, dhe është shumë i formësuar nga faktorët e jashtëm që pengojnë nivelin më të lartë të autonomisë së organizatës në projektet e filluara. Menaxhmenti i lartë synon që të organizojë punën duke ditur se ka nevojë për një shkallë më të lartë të fleksibilitetit për shkak të faktorëve të varësisë penguese siç janë personeli, resurset dhe kapacitetet tjera zbatuese të cilat janë të domosdoshme.

Kryqi i Kuq i Kosovës mbështetet në donacion dhe vullnetarizëm. Degët janë të lira që të operojnë dhe të organizohen, në pajtim me menaxhmentin qendror - “qendra mundet vetëm të jep sugjerime dhe këshilla”.²³⁶ Ka mungesë të orientimeve të përgjithshme menaxhuese që reflektojnë procedurat, udhëzimet dhe kapacitetet e paqarta. Tutje, ka mungesë të materialit potencial dhe resurseve njerëzore të kërkuara në rast të emergjencave të shkallës së lartë. Për qëllim të këtij dokumenti ja vlen që të përmendet se Kryqi i Kuq luan rol të rëndësishëm në raste të fatkeqësive të mëdha natyrore dhe fatkeqësive tjera. Roli i tij konsiderohet thelbësor në veçanti në vendet në zhvillim.

Është e evidente se në raste të emergjencës, parandalimi ose reagimi ndaj situatës së tillë do të kërkonte menaxhim më të mirë, orientim dhe udhëzime për koordinim. Kërkohen kapacitetet dhe aftësitë adekuate, përfshirë mobilitetin dhe kapacitetet materiale. Edhe pse natyra

²³⁶ Intervistë me Feride Hyseni, Sekretar i përgjithshëm i Kryqit të Kuq të Kosovës

organizative dhe mënyra si Kryqi i Kuq i Kosovës ndërmerr mbështetje financiare dhe zbatim të projekteve, është e ngjashme me OJQ-të në Kosovë, përfaqësuesit e organizatës thonë se gjendja e tyre është shumë specifike dhe duhet të trajtohet si OJQ tipike që operon në Kosovë.²³⁷ Me qenë se mungon një ligj specifik për organizatën e Kryqit të Kuq gjë që në vendet tjera ekziston (megjithëse pritet që të hartohet dhe miratohet nga Kuvendi këtë vit), ekziston mundësia të shfaqet një huti në mes të kësaj organizate me OJQ-të tjera.

Nga pikëvështrimi funksional ekzistojnë disa sfida me të cilat përballet Kryqi i Kuq i Kosovës. Këtu në vend, për shkak të dallimeve ndëretnike, Kryqi i Kuq i Kosovës nuk mbulon komunat e Kosovës me shumicë serbe. Ekziston Kryqi i Kuq paralel i vetëquajtur Kryqi i Kuq i Kosovës dhe Metohisë. Ndërkombëtarisht mungesa e njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Organizata e Kombeve të Bashkuara ka ndikuar negativisht në procesin e njohjes së Kryqit të Kuq të Kosovës si anëtar i barabartë i Konventës së Gjenevës për Kryqin e Kuq dhe të Konfederatë së Kryqit të Kuq. Mungesa e njohjes *de jure* nuk është duke penguar bashkëpunimin me Kryqin e Kuq të Gjenevës ose me Konfederatën. Që të dyja kanë zyrat e veta në Prishtinë, mirëmbajnë komunikim të rregullt dhe kanë mbështetjen e tyre të plotë.²³⁸ Megjithatë në raste emergjence të shkallës së lartë, nuk është e sigurt që Kryqi i Kuq i Kosovës do të përfitojë nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar pa pengesë ashtu sikurse vendet tjera të cilat nuk kanë vështirësi politike (në lidhje me statusin).

Kryqi i Kuq i Kosovës gjithashtu përballet me mungesën e mjeteve adekuate të mjaftueshme. Zyrat qendrore dhe fushore nuk janë në gjendjen më të mirë, kanë mungesë të numrit të automjeteve, kamionëve dhe mungesë të depove dhe rezervave esenciale me ushqim dhe veshmbathje. Mungesa e këtyre kushteve të domosdoshme do të thotë se në gjendje të emergjencave Kryqi i Kuq do të jetë shumë i kufizuar që të shfrytëzojë me efikasitet resurset e përgjithshme njerëzore ose për të reaguar me mobilitet më të madh. Edhe bile në rrethana të zakonshme, ka vështirësi të ndryshme që ndalon këtë organizatë nga përmbushja e rolit të vet. Organizata nuk posedon me ndonjë depo kryesore dhe personeli ka mungesë të zyrave të duhura.²³⁹

²³⁷ Aty,

²³⁸ Aty,

²³⁹ Aty,

Nuk ka dëshmi për numrin e personelit aktiv, vullnetarët aktiv dhe personelin tjetër që deklaroi se është i gatshëm që të mbështesë Kryqin e Kuq me çfarëdo mjeteshe dhe është shumë e pagjasë se do të ketë reagim të shpejtë dhe mbështetje adekuate në rast se kërkohet. Përveç kësaj, ky institucion nuk ka plan operativ për raste emergjente dhe është vështirë të sigurohen dëshmitë e sakta të personelit të Kryqit të Kuq ose për numrin e vullnetarëve, ku sipas zyrtarëve mund të jenë rreth pesë mijë, por kjo është shifër e pakonfirmuar.

Gjer tani Kryqi i Kuq i Kosovës është përballë me disa sfida lokale dhe lehtë të menaxhueshme siç është rasti i tërmetit në Gjilan dhe epidemia e hepatitit viral në Suharekë. Përveç këtyre Kryqi i Kuq është përqendruar në ofrimin e asistencës sociale siç është ushqimi dhe gjërat tjera për popullsinë.²⁴⁰ Duke marrë në konsideratë potencialin paraprak të reagimit dhe angazhimit dhe mungesën e Procedurave Standarde Operative (PSO) dhe planeve operative për emergjencat e jashtëzakonshme, Kryqi i Kuq i Kosovës nuk mund të perceptohet si një mekanizëm i mirëfilltë i gatishmërisë emergjente.

Tutje, Kryqi i Kuq i Kosovës mban takime të rregullta me ministritë e qeverisë, edhe pse nuk ka ndonjë qasje bashkëpunimi me qëllim të adresimit të ndonjë çështje specifike ose sfide që pritet në të ardhmen. Kryesisht këto takime mbahen varësisht nga nevojat e projektit. Siç u tha kohëve të fundit, ata janë përfshirë në grupet punuese të institucioneve të niveleve të ndryshme qeverisëse, si proces i përgatitjes së dokumentit shtetëror kundër kërcënimeve.²⁴¹ Sa i përket formave regjionale dhe formave tjera të aktiviteteve, ekziston bashkëpunim i dobët dhe nuk bëhet nën ndonjë lloj i marrëveshjes së dyanshme në mes të Kryqeve të Kuqe regjionale. Për shembull duhet të përmendet një rol i rëndësishëm i asistimit të Kryqit të Kuq të Shqipërisë në shpërthimin e municionit në Gërdec. Në përgjithësi, Kryqi i Kuq i Kosovës ka potencial shumë të kufizuar për tu angazhuar në emergjencat potenciale.

²⁴⁰ Aty,

²⁴¹ Aty,

4.4 Agjensioni Kosovar për Mbrojtjen e Pyjeve

Agjensioni Kosovar për Mbrojtjen e Pyjeve ka degët e veta në çdo komunë me personel prej 400 njerëz. Detyra kryesore e saj është mbrojtja e pyjeve pronë publike dhe private nga faktorët natyror dhe njerëzor siç janë zjarret pyjore, vërshimet, shpyllëzimin, sëmundjet e druve, etj. Agjencia është shumë e decentralizuar në kuptim të menaxhimit të aktiviteteve të tyre. Gjashtë drejtoritë regjionale kanë kompetenca të ndryshme dhe secili vendos pavarësisht për vëllimin e punës dhe prioritetet e veprimit.

Ka pengesa dhe sfida të ndryshme që bëjnë këtë agjenci të hendikepuar, nëse mund të themi ashtu, në përmbushjen e rolit më substancial në lidhje me mbrojtjen e pyjeve. Ata nuk kanë pajisje adekuate kundër zjarreve pyjore por gjithmonë njoftojnë njësitë e zjarrfikësve, policinë dhe KFOR-in.²⁴² Për me shumë, gjatë kryerjes së aktiviteteve, agjencia e ka të vështirë që të ngrisë nivelin e bashkëpunimit me komunitetet lokale që ndonjëherë mund të bëhen faktor i rëndësishëm për mbrojtjen e pyjeve kundër aktiviteteve jologjore njerëzore siç janë prerjet e pyllit, ose reagimet në rast të situatave emergjente. Agjencia pyjore e Kosovës përballet me sfida enorme të shkaktuara nga infrastruktura e keqe rrugore dhe mungesa e pajisjeve themelore kundër zjarreve pyjore. Poashtu ka vonesa të shumta për të arritur në pikën ku kërkohet ndërhyrja, dhe ka vende ku automjetet nuk mund të futen. Këto pengesa janë përmendur gjatë diskutimeve dhe takimeve të mbajtura me zyrtarët komunal.

Faktorët tjerë që pengojnë Agjencinë Pyjore të Kosovës që të bëhet më efikase janë ndërtimi i pikave vrojtuese dhe numri i pamjaftueshëm i objekteve për akumulim të ujit përgjatë pyjeve të Kosovës. Siguria e personelit të Agjencionit Kosovar për Mbrojtje të Pyjeve është pamjaftueshme dhe ka pasur raste kur personeli është sulmuar nga njerëzit që ilegalisht prenin pyllin.²⁴³ Megjithatë, dihet se nevojitet më shumë zotim për të adresuar këto zhvillime. Në këtë kontekst, janë zbatuar disa programe pilot që synojnë ngritjen e vetëdijes dhe bashkëpunimit me institucionet tjera siç është Agjencia Veterinare e Kosovës për parandalim të ngjitjes së sëmundjeve të ndryshme nga

²⁴² Intervistë me Muzafer Luma, Drejtor i Agjencisë Pyjore të Kosovës

²⁴³ Aty,

kafshët e egra.²⁴⁴ Nga pikëvështrimi i agjencisë, zjarret dhe vërshimet janë çështjet më sfiduese për Kosovën. Nëse kujtojmë rastin e Rugovës ku kishte emergjencë të vërshimeve që rezultoi me viktima ku tri familje janë prekur në këtë rast tragjik.²⁴⁵ Mungesa e pajisjeve themelore bëri ekipin e shpëtimit të pasuksesshëm në shpëtimin e jetës së familjeve.

Edhe pse Agjencia Pyjore e Kosovës ka mungesë të kapaciteteve për planifikim dhe caktim të prioriteteve, organizata ofron kontributin e saj solid në strategjitë kombëtare dhe në ndryshim dhe plotësim të ligjit për mbrojtje kundër zjarrit. Ky institucion gjithashtu është i brengosur për zbatimin e ligjeve në fuqi. Për të përmbyllur, Agjencia Pyjore e Kosovës mund të llogaritet për kontribut të kufizuar dhe të shkallës së ulët në menaxhim dhe reagim në raste emergjente. Ekziston nevoja për planifikim gjithëpërfshirës strategjik dhe hartimin e politikave për të ardhmen.

4.5 KEK – Departamenti i sigurisë në punë dhe mbrojtje nga zjarri

Departamenti i sigurisë në punë dhe mbrojtje nga zjarri përfshinë edhe dimensionin e mbrojtjes nga zjarri. Aktualisht ky departament punëson gjashtëdhjetë persona shumica e moshës mbi mesatare. Ka sfida të ndryshme të brendshme me të cilat përballet ky departament siç janë teknologjia dhe sistemi informativ i vjetër, dhe personeli jokompetent. Këta elementë e bëjnë këtë departament joefektiv për të reaguar në situata emergjente. Nuk ka vlerësim të brendshëm në lidhje me kapacitetet e tij për reagim ndaj emergjencave, përfshirë mungesën e parakushteve elementare për veprim në rastet emergjente.²⁴⁶

Sa i përket emergjencave, në shumicën e rasteve ky departament përballet me rastet e rrëshqitjes së dheut për shkak të mihjes së masës tokësore afër lumenjve, ndotjes masive të ajrit, zjarret, etj. Sipas përfaqësuesve të departamentit, ekziston besimi se ata gjer tani ia dalin mbanë mirë, sidoqoftë ka probleme tjera që lidhen me menaxhimin dhe ruajtjen në

²⁴⁴ Kjo është temë specifike e ngritur nga Agjencia Pyjore e Kosovës dhe ekipi ynë nuk gjeti arsye shtesë për të eksploruar tutje në lidhje me këto pilot projekte

²⁴⁵ Aty,

²⁴⁶ Intervistë me zyrtarët e departamentit nga KEK-u

depo të substancave radioaktive.²⁴⁷ U tha se nuk ka bashkëpunim dhe koordinim të duhur me ministrinë përgjegjëse dhe institucionet tjera.

KEK-u bashkëpunim me Departamentin e Menaxhimit të Emergjencave dhe mban koordinim të mirë të aktiviteteve me institucionet tjera përmes drejtorive komunale. Bashkëpunimi i tij regional ende mbetet në nivel të hershëm edhe pse ka korporate tjera energjetike që janë të interesuara që të mbështesin KEK-un. Përveç kësaj, nuk ka përllogaritje për strukturën tokësore dhe kërcënimet potenciale siç janë substancat potenciale toksike, mbetjet e mihjeve, korridoret, prandaj këto lënë punëtorët e KEK-ut shumë të ekspozuar ndaj kërcënimit dhe situatave emergjente.

4.6 Instituti Sizmologjik i Kosovës

Instituti Sizmologjik i Kosovës është institut i ri. Instituti u themelua në vitin 2008 dhe operon nën Ministrinë e Energjisë dhe Minierave. Para themelimit të institutit, të dhënat sizmologjike kryesisht merreshin nga Instituti Vrojtues Sizmologjik në Maqedoni. Instituti Sizmologjik i Kosovës është i ndarë në pesë stacione që gjenden në Gjilan, Pejë, Prizren, Smrekovicë dhe Zatriq. Të gjitha stacionet janë të pajisura me pajisjet përkatëse. Këto pajisje kanë qasje në internet dhe ofrojnë të dhënat për 24 orë për pajisjet qendrore përpunuese që gjenden në zyrat kryesore të institutit sizmologjik. Ka plane dhe përgatitje për të ndërtuar një stacion shtesë në Prishtinë, por gjer tani komuna e Prishtinës nuk ka siguruar ndonjë lokacion të përshtatshëm për këtë institut.²⁴⁸

Instituti Sizmologjik i Kosovës që nga viti 2008 ka ndërtuar marrëdhënie të mira me institucionet tjera sizmologjike nga regjioni e më larg. Ai është anëtar i barabartë i Qendrës Sizmologjike të Evropës së Mesdheut (EMSC)²⁴⁹ dhe i Qendrës Ndërkombëtare Sizmologjike (ISC).²⁵⁰

²⁴⁷ Aty,

²⁴⁸ Intervistë me z. Nazmi Hasi, Ushtrues detyre i drejtorit të Institutit Seizmologjik të Kosovës

z. Hasi na tha se argumentin që është dhënë nga zyrtarët e komunës së Prishtinës se pajisjet mund të shkaktojnë radioaktivitet në atë zonë dhe sipas ekspertëve të Institutit Seizmologjik ky argument nuk qëndron, pasi që radioaktiviteti nuk është më i lartë sesa antenat e telefonisë mobile ose antenat e radio – TV stacioneve”.

²⁴⁹ Shih uebsajtin zyrtar të EMSC, <http://www.emsc-csem.org/index.php?page=about&sub=org>

Përfitimet e kësaj anëtarësie është se Kosova ka qasje në të dhënat e të gjitha qendrave sizmike që janë anëtare të këtyre organizatave. Kosova ka këmbim të të dhënave 24 orë në ditë me institutet sizmologjike të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Shqipërisë por ende nuk ka bashkëpunim bilateral me Serbinë.

Projekti më i madh i kryer nga Instituti Sizmologjik i Kosovës që nga viti i kaluar është vendosja në hartë e zonave me rrezik sizmologjik në Kosovë. Kjo hartë paraqet intensitetin e aktiviteteve sizmike në Kosovë. Por ekziston nevoja e menjëhershme për Kosovën që të kryej matjet e detajuara të mikro zonave sizmike. Me këtë matje instituti do të merr informatat në detaje për qëndrueshmërinë e tokave të caktuara me qëllim shmangien e ndërtimeve të papërshtatshme për evitim të katastrofave të mundshme. Edhe pse domosdoja për matje është shumë e madhe, buxheti i institutit mbulon vetëm studimet për katër mikro zona.²⁵¹

Instituti operon vetëm si Sektor i Ministrisë së Energjisë dhe Minierave që mund të shihet si irracional me rëndësinë e institutit. Ndoshta do të ishte më e arsyeshme që të operoj nën MPB ose Universitetin e Prishtinës ose si institut i pavarur. Kjo do të ndihmonte në buxhetim direkt ose financim tjetër. Instituti Sizmologjik i Kosovës ka bashkëpunim të ngushtë me DME dhe i raporton për çdo tërmet që është mbi 3.8 shkallë të Richter-it.

4.7 Departamenti i zjarrfikjes së Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës

Është më se e domosdoshme që të vlerësohet gatishmëria emergjente e aeroportit ndërkombëtar për shkak të brengave të përgjithshme lidhur me sulmet e mundshme terroriste ose rrëzime të aeroplanit që kërkojnë efikasitet të lartë të menaxhimit emergjent që sigurohet nga aeroporti. Departamenti për zjarrfikje dhe shpëtim i ANP-së është themeluar në fillim të vitit 2003. Themelimi i departamentit ishte ndër hapat e parë të ANP-së për të kompletuar infrastrukturën e kërkuar për të marrë licencën ndërkombëtare. Para themelimit të Departamentit të zjarrfikjes,

²⁵⁰ Intervistë me Nazmi Hasi, Ushtrues detyre i drejtorit të Institutit Seizmologjik të Kosovës, 16.04.2009

²⁵¹ Aty,

ky funksion ishte kompetencë e zjarrfikësve të KFOR-it. Si rezultat i nevojës së menjëhershme për të krijuar departamentin e zjarrfikjes me qëllim që të fitohet licenca, ky departament u bë departamenti më i aftësuar dhe më i pajisur i zjarrfikjes në Kosovë.

Aktualisht departamenti i zjarrfikjes së ANP-së është plotësisht i krijuar dhe operon me rreth 60 zjarrfikës. Të gjithë janë të aftësuar nga Administrata Islandeze e Aviacionit Civil (ICAA) në pajtim me standardet e Asociacionit Kombëtar të Mbrojtjes nga Zjarri (SHBA). Të gjitha sesionet e trajnimit janë mbajtur në Islandë dhe Angli të cilat konsiderohen si qendrat për profesionale për aftësim. Këto trajnime ishin të përgjithësuara si dhe specifike që mbulonin materiet e rrezikshme siç janë elementët kimik, biologjik, radiologjik dhe nuklear, trajnimet e avancuara, trajnimet për komandantë, trajnimet për operator të komunikimit, trajnimet për ndihmë të parë dhe trajnimet tjera profesionale.²⁵²

Departamenti i zjarrfikjes i ANP-së është i pajisur mirë dhe posedon teknologjinë e fundit të pajisjeve për zjarrfikje. Për momentin ata kanë 6 kamionë të cilët krejt së bashku mbajnë 36000L ujë, 4800L shkumë, 1000 kg pudër të thatë dhe secili kamion ka rreth 12 kg të CO₂ që sipas zyrtarëve konsiderohet e mjaftueshme për aeroportin që të jetë funksional.²⁵³ Zjarrfikësit janë gjithashtu të pajisur me veshjet mbrojtëse dhe pajisjet tjera personale. Përveç kësaj ata posedojnë pajisjet për servisim dhe mbushje të shumicës së pajisjeve dhe janë të licencuar vetëm për servisim të pajisjeve të brendshme edhe pse ka ofertë shërbimi edhe për institucionet tjera zjarrfikëse.²⁵⁴ Përveç kësaj, departamenti i zjarrfikjes së ANP-së është i pajisur me autoambulanca që janë plotësisht të furnizuara me material ndihme dhe të gjithë pjesëtarët e departamentit të zjarrfikjes janë të certifikuar për ndihmën e parë.

Koordinatori për Menaxhimin e Botës Shtazore brenda departamentit të zjarrfikjes është përgjegjës për menaxhim të botës shtazore. Shtazët brenda zonës së aeroportit përbëjnë një çështje të ndjeshme sepse në

²⁵² Shih *Botimi për Departamentin e zjarrfikjes së Aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës*

²⁵³ Aty.

²⁵⁴ Intervistë me Adem Statovci, Shef i zjarrfikjes, Departamenti i zjarrfikjes, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës.

veçanti shpezët e egra dhe qentë endacak shkaktojnë probleme të mëdha për aeroplanë. Për largimin e kafshëve, aeroporti është i pajisur me një automjet që posedon sistemin për frikësim të kafshëve të egra.

Departamenti i zjarrfikjes së ANP-së punon në 4 ndërrime 24 orë në ditë, 7 ditë në javë dhe mbulon një sipërfaqe prej 8 km². Në këtë sipërfaqe departamenti i zjarrfikjes së ANP-së ka pozitën udhëheqëse dhe komandon operacionet.²⁵⁵ Sipas zyrtarëve, siguria e ofruar nga departamenti i zjarrfikjes së ANP-së është notuar në Kategorinë 8 që konsiderohet si më e larta në krahasim me shumicën e aeroporteve ndërkombëtare në regjion.²⁵⁶

Në krahasim me zjarrfikësit lokal, buxheti i përcaktuar për gatishmërinë emergjente në ANP nuk përmbushë të gjitha kërkesat në këtë fushë. Departamenti i zjarrfikjes së ANP-së ka asistuar edhe zjarrfikësit lokal në shumë raste të zjarrit dhe në të gjitha rastet personeli i departamentit të zjarrfikësve ishte i pari që arriti në lokacionin e zjarrit.²⁵⁷ Gjithashtu departamenti i zjarrfikjes i ka dhënë njësisive lokale të zjarrfikjes pajisje personale bile i ka huazuar një kamion për zjarrfikje një komune të afërt.²⁵⁸ Një pjesë e rëndësishme për ta përmendur është ndarja e mundshme e përvojave në mes të departamentit të zjarrfikjes së ANP-së dhe njësisive tjera zjarrfikëse që operojnë në Kosovë. Edhe pse departamenti i zjarrfikjes së ANP-së konsiderohet si më i aftësuar në Kosovë, disa ushtrime trajnimi do t'i ndihmonin ata që të këmbëjnë përvojën në mes të njësisive të ndryshme.

4.8 Institucionet mjekësore

Institucionet mjekësor kanë rol të pazëvendësueshëm në raste të incidenteve emergjente, prandaj elaborimi i kapaciteteve të institucioneve mjekësore është thelbësor për këtë studim. Ministria e shëndetësisë është autoriteti më i lartë në Kosovë përgjegjës për ofrimin e sistemit të duhur të kujdesit mjekësor dhe për të përcaktuar politikat e saj. Në këtë aspekt

²⁵⁵ Kjo informatë bazohet në deklaratën e zyrtarëve të lartë të ANP-së pasi që ekipi hulumtues nuk mundi të dëshmojë ndryshe

²⁵⁶ Aty,

²⁵⁷ ANP mund të reagojë në thirrjet jashtë me vetëm një kamion të zjarrfikjes.

Ndryshe aeroporti duhet të mbyllet për trafik ajror sipas ligjit ndërkombëtar

²⁵⁸ Aty,

një nga sfidat më të mëdha për MSH-në është krijimi i politikave dhe përgatitja për përballje me ndodhi të mëdha dhe të paparashikueshme siç janë sëmundjet epidemike dhe incidentet tjera të shkallë së gjerë. Siç dihet mirë, rreziqet mund të shkaktojnë fluks të pacientëve të lënduar ose infektuar që mund të kërkojnë trajtim shëndetësor nga institucionet shëndetësore në Kosovë. MSH në bazë të Ligjit të shëndetësisë së Kosovës ka organizuar institucionet shëndetësore në tri nivele: primar, sekondar dhe terciar.²⁵⁹

Niveli primar i kujdesit shëndetësor përfshinë këto institucione: qendrat kryesore të mjekësisë familjare, qendrat e shëndetit familjar, punktet, qendrat e shëndetësisë emergjente, farmacitë dhe qendrat e rehabilitimit.²⁶⁰ Niveli primar është i organizuar në nivelin e komunës.

Niveli sekondar i kujdesit shëndetësor përfshinë institucionet siç janë: spitalet, qendrat diagnostiko dhe terapeutike, qendrat për shëndetin oral dhe dental, qendrat e shëndetit mental, apartamenti për rehabilitim në shoqëri dhe qendra për rehabilitim special.²⁶¹ Niveli sekondar është i organizuar në qarqe. Ky institucion përfshinë kujdesin intensiv mjekësor për pacientët që niveli i parë nuk mund t'i pranojë.

Niveli terciar i kujdesit shëndetësor përfshinë shërbimet e specializuara që ofrohen në institucionet e kujdesit shëndetësor të autorizuar nga Ministria e shëndetësisë, institucionet ku zhvillohet procesi i arsimimit universitar, punët shkencore – hulumtuese dhe arsimimin e specializuar pas diplomimit.²⁶² Qendra Klinike Universitare e Kosovës është institucioni i vetëm i kujdesit shëndetësor në Kosovë i nivelit terciar.

Këto institucione mund të përballen vetëm me incidente të shkallës së vogël ose të mesme. Ka pasur shumë ankesa nga autoritetet përkatëse lidhur me mungesën e kapaciteteve. Mungesa e hapësirës është një nga problemet më të theksuara për institucionet mjekësore. Kjo shfaqet në veçanti në viset urbane. Edhe pse Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) në Prishtinë mund të konsiderohet si spitali më i frekuentuar në Kosovë, hapësira që ofrohet në lidhje me numrin e madh të pacientëve është shumë e vogël. Në qendrën emergjente të QKUK-së

²⁵⁹ Ligji i shëndetësisë nr. 2004/ 4, Kapitulli XII, neni 74.1

²⁶⁰ Aty, Kapitulli XII, neni 74.2

²⁶¹ Aty, neni 74.3

²⁶² Aty, neni 31.1

janë 12 punëtorë që punojnë në hapësirë më të vogël se 600m².²⁶³ Drejtori i qendrës emergjente tanimë ka tërhequr vëmendjen për vështirësitë me të cilat do të përballen në rast të emergjencave serioze. Deklarata e tij shkoi në atë masë sa që “marrë parasysh këtë situatë, një numër i madh i pacientëve nuk do të mund të absorbohen dhe ekziston frika se shumica e tyre do të përfundojnë në fatalitet”.²⁶⁴

Ky lloj i problemeve shfaqet edhe në Klinikën infektive të QKUK-së që sipas disa zyrtarëve nuk ofron hapësirë të mjaftueshme për masat e karantinës. Sipas tyre, ata tanimë kanë tri dhoma me kapacitete për dy pacientë për dhomë në rast të çfarëdo sëmundjeje epidemike ose në rast të shfaqjes së gripit H1N1. Në rast të epidemisë çmohet roli i Institutit të Shëndetit Publik pasi që ata kanë pajisjet e domosdoshme dhe kapacitetet njerëzore për testim të epidemive duke shfrytëzuar dy metoda.²⁶⁵ Sidoqoftë kërkohet edhe mbështetja nga institucionet ndërkombëtare siç janë Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Kjo agjenci i OKB-së ka deklaruar interesimin e vet në mbështetje të institucioneve mjekësore për të absorbuar numrin e lartë të lëndimeve në rast të fatkeqësive.²⁶⁶

Probleme të ngjashme shfaqen edhe në institucionet tjera mjekësore në Kosovë. Ato kanë planet emergjente për vendosje të pacientëve të hospitalizuar me qëllim që të hapin vend për pacientët e ri. Kjo mund të jetë e mjaftueshme në rast të incidenteve emergjente të shkallës së mesme por është vështirë të matet kapaciteti i mundshëm në raste të incidenteve të shkallës së madhe.²⁶⁷ Përveç kësaj institucionet mjekësore nuk janë të furnizuara rregullisht me barna dhe kanë mungesë të resurseve të kualifikuara njerëzore, pajisje dhe autoambulanca.²⁶⁸ Vetëm disa trajnime janë organizuar për personelin mjekësor në lidhje me incidentet emergjente. Tutje, nuk ka pasur formularë për vetëvlerësim që

²⁶³ Intervistë me Basri LENJANI, Drejtor i Qendrës Emergjente, Qendra Klinike Universitare e Kosovës në Prishtinë

²⁶⁴ Aty,

²⁶⁵ Ramadani Naser, Instituti i Shëndetit Publik, Deklaratë për televizionin publik RTK (5 maj 2009)

²⁶⁶ OBSH, Festimet e ditës së shëndetit publik në Kosovë, (të martën më 7 prill 2009)

²⁶⁷ Nehari Shporta, Emergjencia mjekësore, komuna e Prizrenit

²⁶⁸ Basri Lenjani, Drejtor i qendrës emergjente, Qendra Klinike Universitare e Prishtinës

MSH të vlerësojë kapacitetet e institucioneve të kujdesit mjekësor në Kosovë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është i kufizuar. Nuk ka ndonjë memorandum të mirëkuptimit me spitalet tjera regionale siç janë Shkupi, Tirana ose ndonjë ndihmë të dyanshme në rast të incidenteve të mëdha, përderisa mbështetja nga organizatat ndërkombëtare vazhdon të jetë prezente. Organizata Botërore e Shëndetësisë, OSBE dhe organizatat tjera mbështesin sektorin e shëndetësisë në Kosovë me trajnime si dhe pajisje.

5. Koordinimi, bashkëpunimi dhe mbikëqyrja parlamentare e shërbimeve emergjente

5.1 Koordinimi në mes të shërbimeve emergjente

Gatishmëria efektive emergjente doemos kërkon koordinim të fortë ndërinstitucional. Në veçanti duke marrë parasysh ndjeshmërinë e kësaj çështje, incidentet emergjente nuk mund të menaxhohen nga një institucion ose agjenci e vetme prandaj koordinimi i institucioneve në pajtim me parimet e ndarjes së punëve konsiderohet si e pashmangshme. Ka koordinim të padefinuar duke filluar nga lartë poshtë dhe nga poshtë lartë. Në veçanti ka frikë për përballje me incidentet e shkallës së madhe pasi që nuk është e qartë nëse shërbimet lokale të emergjencës duhet t'i raportojnë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ose DME-së. Kjo çështje është ngritur vazhdimisht nga zyrtarët e lartë.

Në të vërtetë një nga mekanizmat për matjen e koordinimit ka të bëj me ushtrimet e përbashkëta simuluese. Ekziston një perceptim i gjerë se ushtrimet bëhen shumë rrallë si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Gjer tani ushtrimi i përbashkët e kohëve të fundit (Shqiponja 7) u mbajt në qershor 2008, sidoqoftë ushtrimet lokale dhe regionale pothuajse nuk ekzistojnë. Sipas legjislacionit aktual komunat janë të obliguara që të organizojnë së paku një ushtrim për çdo mandat. Në këtë mandat vetëm disa komuna kanë përmbushur këtë përgjegjësi dhe siç dihet ky mandat përfundon në fund të vitit 2009. Argumenti kryesor lidhet me mungesën e linjës specifike të buxhetit për këtë qëllim.

5.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërkomunal

Bazuar në probabilitetin e katastrofave të shkallës së lartë si dhe në natyrën e kërcënimeve asimetrike, secili shtet duhet të llogaris në mbështetje të ndërsjellë.²⁶⁹ NATO dhe BE në objektivat e tyre kanë pranuar se fatkeqësitë natyrore tanimë nuk llogariten vetëm brenda kufijve shtetëror. Përkundër kësaj kritike të vazhdueshme, Kosova ende ka mungesë të marrëveshjeve me vendet regjionale për asistencë në rast të fatkeqësive. Bazuar në vështirësitë e përmendura në kapitujt tjerë, siç janë mungesa e kapaciteteve dhe resurseve, Kosova ka nevojë të menjëhershme që të inicojë marrëveshjet brenda agjencive të saja si dhe me vendet fqinje. Këto marrëveshje duhet të përfshijnë mbështetje të ndërsjellë në raste të zjarrit, vërshimeve, ndotjes mjedisore, rrëshqitjeve, radioaktivitetit, ofrimin e shërbimeve spitalore, etj.

Nuk ka arsye për të mos filluar marrëveshjen me Shqipërinë. Zyrtarët kanë paralajmëruar se memorandumit i mirëkuptimit me Shqipërinë do të nënshkruhet së shpejti²⁷⁰ por edhe tutje kjo çështje është në pritje. Gjatë hulumtimit është përmendur bashkëpunimi i ngushtë ndërkomunal në mes të Prizrenit dhe Kukësit.²⁷¹ Duke marrë parasysh afërsinë gjeografike, nga Prizreni mund të arrihet më shpejt në Kukës, krahasuar me qytetet tjera të mëdha në Shqipëri. Ky bashkëpunim ndërkomunal është i gjerë dhe nuk bazohet vetëm në asistencë emergjente.²⁷²

Përveç kësaj, marrëveshjet me Maqedoni dhe Mal të Zi janë të pashmangshme. Përkundër gatishmërisë së ndërsjellë nuk është arritur ndonjë përparim konkret në drejtim të nënshkrimit të marrëveshjeve me këto dy vende fqinje.²⁷³ Sidoqoftë kjo nuk përjashton bashkëpunimin ndërkomunal *ad hoc* siç është në mes të Gjilanit dhe Kumanovës në Maqedoni në veçanti gjatë zjarreve që u shfaqën gjatë viteve paraprake.²⁷⁴ Për shkak të arsyeve politike marrëveshjet e tilla me Serbinë nuk mund të

²⁶⁹ Historik, *Roli i NATO-së në planifikim të emergjencave civile* f.1

²⁷⁰ Intervistë me Bislim Zyrapi, Drejtori i DME-së, MPB

²⁷¹ Intervistë me Nehat Basha, Drejtor i Drejtorisë Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim, Prizren

²⁷² Aty,

²⁷³ Intervistë me Bislim Zyrapi, Drejtor i DME-së, MPB

²⁷⁴ Intervistë me Fazli Abdullahu, komuna e Gjilanit

arrihen dhe si rrjedhojë kjo mund të pengojë reagimet eventuale emergjente, në veçanti në rastet e zjarreve.²⁷⁵ Gjatë diskutimeve të fokus grupeve zyrtarët potencuan mungesën e bashkëpunimit me komunat në Serbi.

Infrastruktura aktuale ligjore në Kosovë mundëson bashkëpunimin në mes të komunave. Ky bashkëpunim duhet të konsiderohet shumë i rëndësishme në mungesë të pajisjeve të nevojshme dhe resurseve njerëzore në disa komuna. Në të vërtetë kjo do të ngritë nivelin e gatishmërisë emergjente të më shumë se dy komuna. Neni 31.2 i ligjit për mbrojtjen kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera shprehimisht lejon bashkimin e mjeteve dhe shërbimeve në përmbushjen e çështjeve të përbashkëta në lidhje me fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.²⁷⁶ Zyrtari i lartë pranoi se ka pasur përpjekje të kombinimit të shërbimeve në mes të komunës së Lipjanit dhe Shtëmës për shkak të afërsisë gjeografike. Përkundër vullnetit të mirë ky projekt nuk është funksional dhe nuk është duke u zbatuar më.²⁷⁷ Argumenti kryesor ishte procedura shumë burokratike lidhur me rrogat dhe çështjet tjera administrative që shkaktonin vështirësi në krijimin e linjës buxhetore ndërkomunale për këtë projekt.

5.3 Mbikëqyrja parlamentare e shërbimeve emergjente

Si pjesë e sektorit të sigurisë, shërbimet e gatishmërisë emergjente i nënshtrohen mbikëqyrjes parlamentare. Ushtrimi më rëndësishëm i mbikëqyrjes mbi këtë sektor është bërë me themelimin e Komisionit Parlamentar për Gatishmëri Emergjente. Ky komision ka kryer në veçanti aktivitetet mbikëqyrëse gjër kohëve të fundit kur është transformuar në Komisionin për Siguri²⁷⁸ dhe më vonë në Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri.²⁷⁹ Pasardhësi i Komisionit për Gatishmëri Emergjente ushtron mbikëqyrje në këtë sektor krahas institucioneve tjera të sigurisë.

²⁷⁵ Në veçanti në rastet e zjarrit në vitin 2007 në vija kufitare me Serbinë ku brigadat zjarrfikëse dhe TMK kishin pengesa për ndërhyrje.

²⁷⁶ *Shin Ligjin për mbrojtjen kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera*

²⁷⁷ Intervistë me Bislim Zyrapi, Drejtori i DME-së, MPB

²⁷⁸ Në vitin 2006

²⁷⁹ Themeluar në vitin 2008; shih <http://www.assembly-kosova.org/?cid=2.110.83>

Ndryshe nga legjislacioni paraprak, Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri pothuajse nuk ka mbajtur asnjë mbledhje për çështjet e gatishmërisë emergjente. Është e qartë se komisioni mund të jetë i 'tejnëgarkuar' me mbikëqyrjen e arkitekturës së re të sigurisë mirëpo nënvlerësimi i rëndësisë së gatishmërisë emergjente është i paarsyeshëm. Në veçanti kërkesat për ndryshim dhe plotësim të infrastrukturës aktuale ligjore dhe rishikim të politikave planifikuese nga komisioni mbikëqyrës duhet të konsiderohen si thelbësore në këtë fazë.

6. Rekomandimet

1. Në linjë me sygjërimet e Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave dhe OSBE-së, një sistem i centralizuar i shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit do ta ngriste efektshmërinë e gatishmërisë emergjente në nivel të Kosovës
2. Trajnimet dhe pajisjet duhet të standardizohen për të gjithë punonjësit e sektorit të emergjencave
3. Qeveria duhet të alokojë një buxhet specifik për modernizimin e gatishmërisë emergjente në Kosovë për një periudhë 3-5 vjet.
4. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal përveç prioriteteve tjera duhet poashtu të mundësoj grante për shërbime emergjente në disa komuna.
5. Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapsinorë duhet të kushtoj vëmendje serioze kërcënimeve ambientale. Duhet domosdoshmërisht të hartohet një plan profesional për vendosjen e materieve të rrëzikshme.
6. Urgjentisht të fillojnë procedurat për përpilimin dhe miratimin e ligjit të zjarrfikësve dhe shqyrtimin e statusit të tyre të shërbyesve civil
7. Amandamentimin e ligjeve ekzistuese të emergjencës bazuar në rrethanat e reja.
8. Aplikimi i sistemit të komandës në incident për shërbimin e zjarrfikjes dhe shpëtimit është shumë i nevojshëm.
9. Ku është nevojja, ngritjen e numrit të zjarrfikësve, një zjarrfikës për 1000 banorë nëpër komuna si dhe pagat e tyre të jenë së paku të nivelit me policët. Adresimin e kërkesave të vazhdueshme të sindikatës së zjarrfikësve.

10. Mbikqyrja e fortë parlamentare mbi shërbimet emergjente është shumë e rëndësishme.
11. Duhet të bëhen stërvitje të përbashkëta më shpesh që të mundësohet koordinimi ndër-institucional. Duhet së paku një ushtrim çdo vit në secilën komunë dhe së paku një ushtrim i përbashkët çdo vit.
12. Duhet të bëhet modernizimi i objekteve trajnuese të DME-së në Vushtrri përfshirë rritjen e numrit të instruktorëve profesional si dhe inicimi i trajnimeve të avancuara për zjarrfikësit përfshirë trajnimet për menaxhimin e katastrofave.
13. Urgjentisht të analizohen kërcënimet dhe rreziqet e tashme në nivel lokal dhe qendror. Në veçanti vlersimi i kërcënimeve ambientale është shumë i rëndësishëm.
14. Finalizimi i marrëveshjeve me shtetet fqinjë për asistencë të ndërsjellët në raste të incidenteve të shkallës së lartë.
15. Inkorporimin e strukturave paralele emergjente që veprojnë në veri në një kornizë të përbashkët.
16. Investimi në sistemi kudesit shëndetësor dhe furnizimi me pajisje të domosdoshme
17. Të ndërmerret një inspektim më agresiv në objektet e reja dhe të vjetra për uljen e gjendjes alarmante të ndërtesave në zonat urbane.
18. Urgjentisht të lejohet vendosja e paisjeve për matjen Mikrozonale të aktiviteteve seizmologjike në Prishtinë si dhe të mirëmbahen strehimoret publike.

BIBLIOGRAFIA

Artikujt dhe raportet

- Collin Alan, *Contemporary Security Studies*, Environmental Security, 2007
- DFID&DEM, *Proposed National Crisis Management Structure*, 2008
- *Government's Annual Report for 2008*
- NATO, *NATO's role in Civil Emergency Planning*, 2006
- OSCE, *Analyzing the state of Fire and Rescue Service in Kosovo*, February 2008
- Publication on *Prishtina International Fire Airport Department*, 2008
- School of Civil Protection, *Risk and Emergency Management*, 2001
- UNDP, *Kosovo Internal Security Sector Review*, 2006

Ligjet

- Ligji për mbrojtjen nga zjarri
- Ligji për shëndetësinë
- Ligji për Këshillin e Sigurisë së Kosovës
- Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

Intervistat me focus grupet

- Intervistë me Adem Statovci, Shef i Departamentit të Zjarrfikësve, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës,
- Intervistë me Adem Tusha, Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor
- Intervistë Agim Bylykbashin, Drejtor i Sektorit të Emergjencave në Komunën e Lipjanit
- Intervistë me Avdi Paçarda , Drejtor i Sektorit të Emergjencave në Komunën e Prishtinës

- Intervistë me Basri Lenjani Drejtor i Qendrës Klinike Emergjente të Prishtinës
- Intervistë me Bislim Zyrapi, Drejtor i DME
- Intervistë Fazli Avdullahu , Departamenti për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Gjilanit
- Intervistë me Feride Hyseni, Sekretare e Përgjithshme në Kryqin e Kuq të Kosovës
- Intervistë me Halil Blakaj, Udhëheqës i Qendrës Emergjente Rajonale në Prizren 112
- Intervistë me Muharrem Beka, Udhëheqës i Sindikatë së Zjarrfikësve
- Intervistë me Hazir Deliaj, Ushtrues detyre i udhëheqësit të Zjarrfikësve në Prizren
- Intervistë me Muzafer Luma, Drejtor i Agjensionit Kosovar të Pyjeve
- Intervistë me Naim Behluli, Këshillëtar Politik I Ministrit të Pushtetit Lokal
- Intervistë me Nazmi Hasi, Ushtrues detyre I Drejtorit të Institutit Seizmologjik të Kosovës
- Intervistë me Nazmi Pantina, Sektori i Emergjencave në Komunën e Vushtrrisë
- Intervistë me Nehat BASHA, Drejtor i Departamenti për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Prizrenit
- Intervistë me Nehari Shporta, Udhëheqës i Ndhmës së Parë në Prizren
- Intervistë me Shefqet Aliu, Zv. Drejtor I Sektorit të Emergjencës në Komunën e Mitrovicës
- Intervistë me Xhabir Çunaku , Drejtor i Sektorit të Emergjencës në Komunën e Obiliqit,

Tjera

- <http://ëëë.assembly-kosova.org>
- <http://ëëë.emsc-csem.org>
- <http://mksf-ks.org>
- <http://ëëë.mpb-ks.org>